

Gjergj Zhepi

# TREGIMET e KRUJES



BIBLIOTEKA E RINISË

GJERGJ ZHEJI

TREGIMET

E  
KRUJËS

~~4483~~  
3554

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

*Kjo vepër mori çmimin e dytë në konkursin e  
25-vjetorit të themelimit të P.P.SH.*

Piktor: Hysen Devolli

Tirazhi 8000 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-65

---

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1967

## AUTOBUZI I SKËNDERBEUT

**U**dhëtimi nga Tirana deri në Krujë nuk zgjat më shumë se një orë, por mjafton për të të lënë një mbresë të gjallë nga ngjyrat e një peizazhi të larmishëm, ku dora e njeriut kryen këmbime të çuditshme. Një ndjenjë e ngrohtë malli dhe krenarie, një kënaqësi dhe hare të kapillon trupërisht e shpirtërisht, kur autobuzi shket në rrugën e asfaltuar, nën hien e plepave, dhe pastaj nis të ngjitet. Poshtë — fusha të pamata, ku vreshtat e të mbjetllat të habitin me saktësinë e radhëve të tyre; më tej, kodra që kanë qëruar kurrizet nga ferrat e gëmushat dhe janë kthyer në toka buke; lart-malet e ashpra e të moçme me taracat e reja të mbjella me patate dhe vetulloret e bardha të ullinjve. Dhe kudo njerëz, shumë njerëz. Klaksoni i autobuzit nuk rresht tërë rrugës. Nganjëherë ke përshtypjen se kanë zbritur fshatrat rreth dhe kanë dalë të shëtisin. Por nuk është ashtu: ata janë

duke punuar. Takojmë kooperativistë me vëgla në krah që shkojnë në arë; më tutje, fëmijë me çanta të hedhura krahaqafë; pastaj detyrohemë të ngadalsojmë shpejtësinë për të lenë të kalojë një kope prej qindra kokë dhensh; më tutje na del përpara një varg traktorësh që tërheqin pas maqineri të çuditshme bujqësore; në dy tre vende hasim me punëtorë që meremetojnë udhën apo dhe me të tjera që gërmojnë anës një hendek për të futur linjën e re telefonike; një rresht fshatarësh me armë në krah përshëndet autobuzin e Skënderbeut: janë zboristë në stërvitje; takojmë burra, gra, pleq, fëmijë, fshatarë, punëtorë, ushtarë, kamiona, vetura, qerre me buaj, karroca me kuaj, biçikleta... Më pëlqen t'i mendoj rrugët si arteret e venat në trupin e atdheut. E në është kështu, në këta damarë, kurrë gjaku i Shqipërisë sonë nuk ka lëvizur me një gjallëri dhe vrull si ky që kam para syve. Kudo që të gjarpërojnë këto rrugë, në jug a në veri, në bjeshkët me pisha a fushat me lule, anës së detit me valë apo të qepura buzë greminash graniti, kudo e kurdo, natën a ditën, ato janë plot zhurmë, me zëra njerëzish dhe maqinash çudibërëse, ato nuk flenë kurrë, ato janë të palodhura, ato janë rrugët punëtore të atdheut.

Vetëm kur lamë pas Fushë-Krujën, ku njeriu sheh qartë se si lind një qytet, lamë në krah të djathtë shtëpitë njëkatëshe e kopshitet qark shkollës dymbëdhjetëvjeçare, vetëm atëhere unë nisa të mendoj për nxënësit krutanë, të cilët të nesërmen do t'i kisha përpëra. Nuk kam, domosdo, atë kureshtje të përzier me zhdurim e ndrojtje, të një mësuesi të ri që hyn e jep mësim për herë të parë në një klasë. Megjithatë, prapë është diçka e re. Sepse, sado vjet të kesh punuar si mësues, në shkollat gjen kurdoherë diçka të re, diçka të panjohur. Ato vetë janë të reja, nuk plaken kurrë. Nuk i lënë nxënësit tëmplaken, zërat e tyre të qeshur dhe të çkujdesur në oborr, ëndrat dhe këngët e tyre përherë të lulëzuara, gjëzimet dhe fitoret e tyre të vogla, që ua mbushin zemrën me kënaqësi kaq të madhe e të paharruar...

Në të kthyer të bërrylit të rrugës, mbas gurores, Kruja na doli përpëra e mbërthyer pas malit. Më të djathtë nxijnë muret e rrënuara të kështjellës së Kastriotit, në të majtë zbardhin shtëpitë e fshehura midis ullinjve bojëhiri. Në pranverë, të gjitha këto pemë që shohim qark, tërë këto shpate e kodra të mbuluara me lloj-lloj drurësh, vishen me gjethë të reja dhe atëhere, që këndej, Kruja të

duket si e kredhur në një re të gjelbër e të pamatë, që shtrihet në rrëzë të malit. Por tani është shkurt. Jashtë bën ftohtë dhe xhamat e autobuzit vishen nga avulli.

Kur zbresim në Krujë, një copëherë kryet na mbetet lart, duke parë malin ngjyrë plumbi, që duket sikur rri pezull mbi qytetin e vogël; **copa** të bardha resh çthurer fije-fije, duke u kapur e duke u cjerri në thepat e mprehtë, që, këndej poshtë, duken si thika vigane; bregu shkëmbor e ngjyrë vjollce i kështjellës, kështjella vetë dhe nulla e sahatit duken në këtë sfond si të gjalla, të banuara e jo shenja të një lavdie të perënduar; shtëpitë e Krujës, me dritare të shumta e ndërtimë piktoreske, me rrëthime guri e kopshte plot ullinj, pjergulla dhe qiparisa, duken sikur kanë ngritur kokën dhe vështrojnë të gjitha këtu, në këtë copëz sheshi, ku lartohet monumenti i Skënderbeut majë kali; rrugicat tekanjoze e të shtruara me kalldrëm vinë nga të gjitha anët e, si shtretër përrunjsh nervozë malorë, bashkohen këtu, përparrë shtëpisë së kulturës, ku ka ndalur autobuzi.

Kam dy shokë me vete: një piktor dhe një kompozitor.

Piktorit tani i kanë mbetur sytë te retë e shpupurishura skërkave; i duket sikur ka

përpara fragmente pikturash me male mje-gullorë e ngjyra legjendare; kompozitorit të-rë kjo i ngjan si një simfoni heroike e gdhëndur në shkëmb. Unë hesht; nuk di të shprehem. Por kam të drejtë të mendoj se në male të tilla, në një peizash kaq kreshnik, njerëzit nuk mund të jenë veçse trima.

Për këta njerëz është shkruar ky libër.

Krujë, 1966

## KONVIKTORËT

**K**ishim dhjetë ditë në konvikt. Edhe ata u mësuan me ne, edhe ne u mësuam me ata. Në të vërtetë kjo ndodhi shpejt, thua jse në dy tri ditët e para. Sepse nuk është vësh-tirë të miqësohesh me njerëz me të cilët banon e fle nën një pullaz, kalon kohën e lirë me ta, i shikon kur pregetitin mësimet, kur hanë, kur lozin, kur bëjnë gjimnastikën e mën-gjezit, kur nisen për në shkollë, kur mbli-dhen në mbrëmje grupe-grupe e bisedojnë...

Konvikti nuk është i madh. Si ky ka-mjaft në qytetet tona të vogla krahinore. Kam parë edhe atë të Lezhës. I ngjajnë mjaft njeri tjegrit. Kur hyn në to, të duket sikur shëh po ata konviktori. Janë fshatarë nga koopera-tivat e ndryshme, më të shumtën me bursë, që vinë të vazhdojnë mësimet. Vinë aty dhe formojnë një familje të madhe, duke u lidhur midis tyre si vëllezër. Midis konviktit të Kru-

jës e atij të Lezhës ka edhe një ngjasim tjetër: të dy ngrihen në vende prej nga duket krejt qyteti me një pamje që ta ngop syrin. Por, megjithatë, nga konviki i Krujës pamja është më e gjerë. Në mëngjez herët, kur ajri është ende i kthjellët, pa avuj, duken godinat dhe bulevardi i Tiranës, pista e Rinasit, shquajnë shtëpitë e Durrësit dhe anijet e portit, duket Kepi i Rodonit, deti që llamburit si një pasqyrë e pafund; rreth e qark fushat e gjelbëra, kodrat e veshura, brigjet e pyjet e errta, lumejt e bardhë, njollat e shkëlqyera të rezevvuarëve të kanaleve vaditës, arat katrörëkatrorë, fshatrat e shpërndarë, rrugët e zeza automobilistike, oxhaqet e fabrikave në Vorë, Fushë-Krujë e gjetkë. Nganjëherë të duket se ke përpara një hartë të madhe të punuar në relief, por një hartë të gjallë. Natën ky peizazh merr bukuri tjetër, stoliset me mijëra drita që shkëlqejnë më shumë nga yjet e qieillit; janë dritat e forta të Tiranës, që rrezëllojnë si një diell; dritat e Durrësit të mbledhura tufë si një vilë xixash; dritat e plajës, të shpërndara togje-togje nëpër tërë hapësirën nga një dorë bujare; dritat e automobilave, që lëvizin poshtë e lart e të ngjajnë si xixëllonja fantastike. . .

Në mbrëmje, mbas buke, një tufë konviktorësh ishin mbledhur qark stufës dhe po bisedonin. Zjarri brambullonte. Ndënja midis tyre.

— Përse bisedonit? — i pyeta

— Pjetri, — u hodh e foli Rezari, — po mburret për Laçin!

— Nuk mburrem, shoku mësues, — ja priti Pjetri. — Po them të vërtetën. Ato janë gjëra që shihen me sy. Oxhaku i fabrikës, i lartë tetëdhjetë metra, fabrika e madhe sa një qytet, ndërtesat e bukura me tri-katër kate, si në Tiranë, dhe shkolla me tri kate . . . A keni qenë në shkollën e Laçit, shoku mësues? Aty afër e kam shtëpinë edhe unë. . . Në Laç ka ardhur dhe Kolë Jakova, ai i «Herojve të Vigit». . . Po trenin a e keni parë? . . .

Dhe Pjetër Nikaj — është në klasën e pestë — nuk resht së lëvduari qytetin e tij të vogël. Është biri i një mekaniku. Ka ardhur në konvikt vetëm se e ka patur t'ëmën sëmurë. I ati nuk kish ku ta linte, ndaj e futi në konvikt. Tani eëma ka dalë nga spitali. Pjetri mund të kthehet përsëri në shtëpi, por nuk do: i është lutur të atit ta lerë të mbarojë këtu vitin shkollor.

— Po përse, — hidhet dhe e pyet Gëzim

Alla, një djalë nga fshati Luz, — fabrika e Fushë-Krujës si të duket ty?... Unë atje kam vëllanë. Kur vjen në shtëpi, ai më tregon gjëra që të lënë gojëhapur...

Biseda është ndezur kështu rreth vepgrave industriale dhe... problemeve të ndryshme ekonomike, që këta fëmijë i shtrojnë e i zgjidhin sipas mendjes së tyre. Flasin të gjithë, sepse linjat e tensionit të lartë, oxhaqet e fabrikave, shinat e trenit, janë bërë sende të zakonshme për syrin e tyre. Duke i dëgjuar, bindesh për forcën e madhe që ka industrializimi ynë për të përbysur mentalitetet e ndryshkura, varfërinë dhe ndrydhjen shekullore.

Vetëm njeri nuk flet. Rri e dëgjon i heshtur, i menduar, me kryet mënjanuar mbi sup. Është Hamiti, nxënësi që kam në klasën e tetë. Është nga Zgërdheshi, një fshat që ka një kështjellë të famëshme, kështjellen e Arbanit. Ai dëgjon banorët e rinj të legjendave të reja, të legjendave industriale, dhe nuk guxon të flasë. Është i heshtur si rrënojet e kështjellës së fshatit të tij. Dua t'i them që të flasë edhe ai, se ato legjenda të reja janë edhe të atij, se që Kruja e Zgërdheshi, pa është sot Laçi e Fushë-Kruja, se që trimëria, pa erdhën sot

puna e lirë dhe mrekullitë e djersës punëtore...

Në konviktin e Krujës mund të gjesh edhe nxënës nga Tirana, apo nga ndonjë qytet tjeter.

— Shumë i sjellshëm, — i thashë drejtorit të konviktit për një maturant.

— Tani, ashtu është, — m'u përgjegj ai.

— Pse tani?

— Sepse, kur e dërguan prindët nga Tirana, ishte më i çthururi. Kisha gjetur belanë me të.

U habita. Por atëhere ai nisi të më flasë edhe për raste të tjera. U njoja kështu me shumë konviktorë. I shtyrë nga kureshtja, në fillim futesha në mes të tyre, në kopshtin e konviktit, apo në sallën e studimit, apo kur hanin bukë, dhe vëreja ata për të cilët më kish folur drejtori; pastaj bëja si bëja, në shkollë apo në konvikt, kërkoja të bisedoja. Kësisoj mësova disa nga aventurat e atyre që e kishin bërë drejtorin të dërsinte. Që të keni dhe ju një ide, do t'ju flas për njerin prej

tyre, për Rezarin, për shembull, një djalosh gjashtëmbëdhjetë vjeçar, leshverdhë, truphofflë, hosten i gjatë, tepër i lëvizshëm, si ngjalë. Vjen nga Tirana dhe është bir inxhenjeri. Këto që do të tregoj m'i tha vetë. Domosdo, jo apo më njoju, por aty nga fundi i vitit shkollor.

— Ishte gusht, — nisi të më rrëfejë. — Bënte vapë. Djali i dajës kishte ardhur mysafir te ne. Ishte më trazovaç nga unë! Po atëhere ishim të vegjël, shoku mësues, e nuk dinim ç'bënim. — Unë tund kokën në shenjë miratimi, megjithëqë ai edhe tani nuk është burrë. — Një mëngjez, — vazhdon Rezari, — Diku më tha:

«Shkojmë të lahem i në Durrës?»

«Shkojmë!»

Në stacion kishte shumë njerëz, po hypëm në tren dhe gjetëm vend për t'u ulur. Kur u nis treni, faturinua hyri në vagon. Ne u ngritëm dhe, fësht, dolëm. Hymë në një vagon tjetër. Po aty ai na zuri.

«Biletat!», na tha.

Ne ulëm kokën e ngritëm supet. Ai s'u ndje. Thamë se shpëtuam. Dhe vërtet, faturinua u largua, por, kur qëndroi treni në Kashar, ai na kapi për veshi dhe na zbriti.

«Po tani?», thashë unë.

«Fugo!», më tha Diku.

Hypëm shpejt në një vagon tjetër. Këtë radhë ishim stërvitur dhe sytë i mbanim te xhamat e dyerve duke përgjuar. Arritëm kështu deri në Shkozet. Atje zbritëm. Më tepër nga kënaqësia që ua kishim hedhur faturinove se sa nga deti që kaltëronte para nesh, u nisëm me vrap për në plazh, duke qeshuri si të marrë...

U lamë, luajtëm e, aty nga ora dymbëdhjetë, erdhëm përsëri në Shkozet.

Vagoni ishte plot, njerëzit rrinin shtrënguar. Kaloi tuneli dhe po i afroheshim Sukthit, kur faturinua, ai i mëngjezit, na kapi.

«Prapë?!», tha.

«Na fal!», iu lut Diku duke e holluar zërin sikur po qante.

Më të arritur në Sukth, ai na zbriti, por ne me vrap dhe hypëm në një vagon tjetër. Së paku kështu na u duk, por, kur hymë benda, vumë re që ishte po ai. Deshëm të lar gohemi. Disa nga pasagjerët na njohën.

«Rrugaçët!», tha dikush.

«S'kanë faj këta, fajin e kanë prindët që i lëshojnë azat!», u hodh e tha një plak.

«Kanë gjetur belanë dhe faturinot!»

Kthyen kokën edhe të tjerë për të na parë. Cangaca, tërë vagoni nuk bisedonte veçse pér ne. Deshëm të largohemi, por nja dy djem të mëdhenj na prenë udhën. Ne kundërshtuam. Ata nuk e prishën gjakun. Atë çast ja behu faturinua.

«E mori djalli!», thashë me vete.

Por faturinua nuk u nxeh aspak. Na kapi pér veshi dhe na tërroqi jashtë vagonit. Pas nesh vinin pasagjerë kureshtarë. Faturinua na pruri përpara nevojtores së vagonit, hapi derën dhe na mbylli brenda deri në Tiranë.

Mbase nuk duhej të zgjatesha kaq shumë me Rezarin, por kjo ka një arësyё të fortë. Në konvikt, ashtu si në çdo shkollë, ka nxënës që vinë me të meta të mëdha, të llastuar, tekanjozë, fëmijë të «vështirë». Megjithatë, në mes të shokëve, në mjedisin e shëndoshë e të pastër që i rrethon, me ata ndodh ajo që ka ndodhur me Rezarin. Kur të thonë sot që ai më parë nuk linte dy gurë bashkë, bënte këtë dhe atë, nuk të besohet. Vërtet Rezari vazhdon të jetë përsëri i gjallë e i lëvizshëm, por krejt ndryshe. Tani është i pjekur, është më i përbajtur dhe ka nisur ta vrasë mendjen pér gjëra më të vyera. Në klasë, unë e kam një nga nxënësit më të mirë.

\* \* \*

Nganjëherë në konvikt vinë prindët apo të afërmit.

Një pasdite konviktorët ishin në studim. Në oborr hyri një malësore, veshur me kostumin e bardhë, qendisur me fill të kuq, me thekë kuq e zi, me përparëse apo, si i thonë ato, stërvec, të punuar në avlëmend, e plot ngjyra. Një tufë flokësh të thinjur mbi ballë i dilnin nga shamia. Hyri në oborr dhe u drejtua vetë, e sigurtë, në shkallët që të shpien në koridor. Me sa dukej, nuk ishte hera e parë që vinte.

Në koridor vuri veshin për të përgjuar një çast, pastaj drejt e në derën e parë, sikur t'i kish thënë njeri që atje ishte i biri.

Kur u hap dera, konviktorët ngriten kokën. Një copëherë u panë në heshtje. Pastaj malësorja tha me zë të lartë:

— Marshalla!... Bukur, për besë!...

Konviktorët ja dhanë gazit. Genci, që ishte kujdestar, i ra tryezës për t'i qetësuar.

— Po ku e kam at Frrokun tem?... Po aj këtu asht?...

Frroku ishte në katën e dytë, në sallën tjetër. Vajtën e thirrën. Por, për nja dhjetë

3554

minuta, as poshtë as lart nuk përqëndrohe-shin dot në mësim. Kishin dalë të gjithë nëpër dritare dhe shikonin në oborr Frrokun dhe të jëmën, që diç i kish dhënë djalit për të ngrënë. Tani, ulur të dy në një stol, bisedonin, bisedonin e sytë u shkëlqenin nga malli...

Të përmalluar shkëlqenin në dritare edhe sytë e konviktorëve.

Një ditë binte shi. Rastisa në koridorin e poshtëm, kur në oborr u dëgjuan këmbë të rënda. Ishte një malësor shtathedhur e shpatullgjerë. Ekte në shi, kokëlart. Kur u afrua, nga ftyra m'u duk gati fëmijë, jo më shumë se katërbëdhjetë vjeç djalë. Opingat me lëkurë lope e me lak i qenë fëlliqur me baltë. Edhe tirqet gjer në pulpa. Kishte ardhur nga Cudhini, një fshat përtej malit, i vetëm, me kalë, për të blerë në Krujë një plaçkë. Rrugës, kafsha i qe rrëzuar, por ai e kish ngritur dhe tani, para se të nisej përsëri për fshat, ish hedhur një vrap të shikonte vëllanë.

Hyri në koridor, i hodhi një sy raftit me libra, u pa në pasqyrën e madhe dhe vuri një grimë buzën në gaz; ngriti kokën e pa shkallën që çonte në katin e dytë, pastaj zgjati qafën për të vënë re në dhomë, ku studjonin konviktorët. Shikonte dhe heshtëte: shikonte

dhe, me sa dukej, diç bluante. Pastaj m'u kthyе mua:

— Tash po vi dhe unë vitin tjetër, shok. Ashtu e kemi pasë punën. Po u rregulluem. Vëllai na u kthyе nga ushtria.

Fytyra ishte fëminore por zëri dhe lë-vizjet e tij qenë ato të një burri të pjekur.

Kur foli e ngriti zërin. Një kokë u zgjat nga dera e sallës. Pas pak, ndërsa malësori bisedonte ende me mua, një konviktor doli me sy të skuqur nga leximi. Ishte i vëllai.

U rrokën dhe i rrahën shpatullat njeri tjetrit, si të mëdhenj. Unë u largova. Ata u hoqën në një qoshe të koridorit.

## G U R O R J A

### 1

Ndriçim Ubani éshtë nga Kruja. Unë e kam në klasë. Rri në bankën e fundit, se éshtë më i gjati. Kur e sheh për herë të parë, të duket si ndonjë nga ata përsëritësit, që presin e përcjellin nxënës dhe s'e prishin gjakun kurrrë. Por nuk éshtë ashtu. Ndriçimi ka moshën e shokëve dhe vetëm me trupin e zhvilluar ua kalon të tjerëve; krahërorin dhe shpatullat i ka si ato të një mundësi; duart eshtake dhe të ashpra të kujtojnë punëtorët e mjeshtive më të vështira. Tërë ky zhvillim nuk mbetet më mister kur mëson se Ndriçimi ka dy pushime verore që punon në gurore së bashku me të atin. Në shtëpi janë një tufë fëmijë — plot shtatë, katër djem e tri vajza, kokë më kokë, nga tre gjer shtatëmbëdhjetë vjeç. Më i madhi éshtë Ndriçimi. Dy nga fëmijtë, Pë-

llumbi dhe Seria, janë në Tiranë me bursë, djali në Shkollën e Rezervave të Përshëm, kurse Seria në Liceun Artistik. E ëma punon si tezgjaioste në artizanat.

Në klasë Ndriçimin e duan të gjithë dhe ja dëgjojnë fjalën. Jo nga frika e duarve të mëdha, që, kur i mbledh grusht, duken si çekanë farke, por ngaqë e ka zemrën flori. I qeshur, shakaxhi, i çiltër dhe i ndershëm, Ndriçimi është gati të lerë kokën për shokët. Përleshja e drejtëpërdrejtë me punën, nga ana tjetër, u ka dhënë fjalëve të tij një pjekuri jo të rëndomtë; nuk ngutet kurrë të gjykojë, i peshon mirë punët, ngjarjet e pastaj flet. Kjo i ka bërë shokët që ta zgjedhin edhe këtë vit sekretar të rinisë së klasës.

Në një mbledhje, të cilën e drejtonte Ndriçimi, kam ndodhur dhe unë. Midis të tjerave, shqyrtohej edhe sjellja e papëlqyer e Agronit, birit të një agronomi, i cili kishte bërë zhurmë në mësim dhe i qe përgjegjur keq mësuesit. Në fillim Ndriçimi, me fjalë të pakë, por të menduara, tregoi se sa e shëmtuar kish qenë sjellja e Agronit për të gjithë kolektivin. Pastaj u ngrit Rezari dhe kërkoi që t'i jepej fjala Agronit.

— Nuk kam ç'të them, — nisi ky dhe

befas u skuq i téri. — Bëra gabim. Megjithëse atë ditë nuk bëra vetëm unë zhurmë.

— C'do tē thuash me këtë? — e pyeti Ndriçimi. — Për kë e ke fjalën?

Agroni ktheu kokën pas, sikur donte tē gjente bashkëfajtorin.

— Nuk e di, — vazhdoi pastaj. — Atë ditë nuk bëra vetëm unë zhurmë.

Fatmiri ngriti dorën. Tha se Agroni do tē bënte mirë tē mos kërkonte qimen te tē tjerrët, por tē shikonte trarin e vet. Le ta thoshte troç atë që kish bërë, tē pranonte gabimin e tē mos kërkonte t'i bënte dredha plumbit, ashtu si e kishte zakon.

Agroni u nxeh:

— Përse, — u hodh e pyeti, — si e kam zakon unë?

— Ta thashë, — iu gjegj Fatmiri. — Je mësuar tē hedhësh gurin e tē fshehësh dorën. Nuk është hera e parë.

— Atë e bën ti.

— Aspak! Unë po tē flas troç.

— Të njohin tē gjithë se kush je.

— Ca më mirë. Kështu e dinë tē gjithë që unë nuk e kam zakon gënjeshtren dhe tē fshehurit prapa gishtit.

Kjo «tē fshehurit prapa gishtit» i bëri tē

tjerët të qeshin. Fatmiri kish përherë një të folur plot figura, por atë ditë biseda e tij shkëlqente. Të qeshurit e shokëve, e nxehu edhe më shumë Agronin thatim, që nuk e përmbajti dot veten, ngriti zërin dhe e fyejti Fatmirin.

Në klasë, papritmas u prenë të qeshurat dhe pllakosi një heshtje varri. Agroni rrrotulloi sytë nëpër banka dhe u ul me vështrim të turbullt e të ngulur përpara.

Ndriçimi, në katedër, kur dëgjoi fjalën e rëndë të Agronit, u ngrit në këmbë. Një çast heshti dhe ai, pastaj, me zë të prerë, tha:

— Ne nuk mund të vazhdojmë më tutje mbledhjen, pa vënë në vend nderin e klasës e pa zhdukur në çast këtë turp. Agroni e di se ç'duhet të bëjë.

Agroni heshti, bile e ktheu kokën nga dritarja.

— Ne po presim, — tha Ndriçimi.

Kaloi kështu një copëherë. Në klasë kish rënë një hije trishtimi. Më në fund, fajtori u çua në këmbë. Ngriti kokën si me përtesë e sikur do të pendohej nga çasti në çast e do të ulej prapë. Por nuk ndodhi ashtu.

— I kërkoj ndjesë Fatmirit, — tha me

një fije zëri dhe faqet iu bënë flakë të kuqe.  
— Thashë një fjälë që nuk duhej ta thosha.  
Ju kërkoj ndjesë edhe juve.

Klasa mori frymë lirisht si e çliruar nga  
një barrë e rëndë, mbytëse. Ndriçimit iu çel  
fytyra.

Që prej asaj dite, ai fitoi shumë edhe në  
sytë e mi. Por, befas, nisi të mungojë shpesh  
e më shpesh, gjersa më në fund u largua  
fare nga shkolla.

## 2

Në dhomë qenë vetëm dy shtretër. I  
sëmuri tjetër, një fshatar nga Bilaj, dremiste.  
Ndriçimi e kishte afruar stolin dhe bisedonte  
thuajse kokë më kokë me të atin, fytyra e të  
cilit — zakonisht e kuqërrëmtë dhe e pjekur  
nga dielli — tani qe e zverdhur dhe me gro-  
pat e syve të nxira. Kur fliste, ndërpritej  
shpesh për të mbushur krahërorin me frymë.  
Dhimbjet në stomak e mundonin dhe e dety-  
ronin të ndryshonte herë pas here qëndrimin  
në shtrat.

— Nuk është gjë për mua, babë, — i  
thoshte i biri. — Ti e di që unë edhe gjatë ve-  
rës e realizoja normën.

— Nuk e kam për atë... Ti duhet të vazhdosh shkollën...

— Edhe ashtu e vazhdoj.

— Do të lodhesh. Do të sëmuresh. Duhet të kujdesesh për shëndetin.

— S'më gjen gjë mua, babë, — tha djalili dhe vuri buzën në gaz. — Ti mos u mërzit. Tı shiko vetëm të shërohesh. Shtëpisë nuk do t'i mungojë asgjë.

— Atë e di, Ndriçim. Po ti do të më loddhesh.

— Unë kam qejf të punoj, babë. Ti e di këtë.

I ati zgjati dorën dhe shtrëngoi supin e të birit. Edhe tani që ishte sëmurë, merrgën e së shoqes dhe me të hollat që ai merrte nga sigurimet shoqërore, familja mund të mbahej në këmbë. Për të sëmurin nuk do të shpenzonin asgjë, mbasi, si kujdo, mjekimi do t'i bëhej falas. Megjithatë, Ndriçimi hyri në punë në gurore. Donte që vëllezërve e motrave të mos u mungonte as edhe gjëja më e vogël.

Tani, në mbrëmje, mblidhet me ta, i këshillon, i përkëdhel, luan, u kontrollon detyrat dhe pret gjersa të bien me radhë të flenë. Me motrën e vogël, me Teftën trevjeçare,

bën veçan. Ajo i del përpara në oborr, kur ai kthehet nga puna, dhe i hidhet në qafë. Ai e hypën kaluar mbi supe dhe hyn me të duke kënduar, ndërsa ajo qesh nga gëzimi dhe tund këmbët e vogla. Kur shkojnë të fletë të vegjëlit, ai rri një grimë me nënën dhe bisedon. Ajo ja ngul sytë — vështrimi i saj shpreh mallëngjim e krenari bashkë — dëgjon fjalët e tij të pjekura dhe zemra i bëhet mal. I duket sikur i biri është rritur e bërë burrë brenda një jave.

Megjithatë, kur bie në shtrat, Ndriçimin nuk e zë gjumi menjëherë. Syhapur, rri e mendohet. Mendon shkollën, klasën, tremujorin që po kalon. Mendon të atin në spital, në Tiranë, ku e kanë çuar për operim, dhe thotë me vete se patjetër duhet të vejë ta shikojë. Në letrën e fundit i kish folur përtë gjitha të rejat e shtëpisë, por është ndryshe kur ja thua me gojë. Pastaj i kujtohet përsëri shkolla, klasa, shokët, mësuesit...

Me ata në mendje, e zë gjumi.

gurore u vënë zjarr minave dhe gjëmimin e tyre ushtima e sjell rrotull nëpër malet e Krujës, nxënësve u qesh fytyra dhe sytë u shkëlqejnë.

— Minat e Ndriçimit! — thonë.

Me mendje e përfytyrojnë shokun tek ndez fitilat dhe tek largohet pastaj me vrap. Minat pëlcasin, shqyejnë barkun e gurtë të malit, i vërvitin coprat e shpellave përpjetë dhe mbushin grykat e maleve me gjëmimin e tyre të fortë.

— Bum!... Bum!

Ndriçimi është bërë tanë më i shtrenjtë për ta, më i fuqishëm, më i pjekur. Në veprën e tij ata shikojnë edhe veten, matin veten. Krenaria u përkëdhel sedrën e ndjehen më të burrëuar, të aftë edhe ata për të djersitë punë.

Një mëngjez kisha ngritur Dhimitraqin të lexonte ditarin e tij. Në ditar ai thoshte se, një ditë më parë, kishte takuar Ndriçimin në bibliotekën e shtëpisë së kulturës. Kishte biseduar gjatë me të. I kishte thënë se, në klasë, kur dëgjojnë shpërthimin e minave, gjithëve u shkon mendja te ai. Kurse Ndriçimi i kishte rrëfyer se sa herë që pu-shonte një grimë për të fshirë djersën, me

varenë e rëndë mbështetur mbi shkëmb, ngrinte sytë dhe shikonte shkollën që, andej poshtë, dukej e vogël; ai mundohej të gjente dritaren e klasës. Megjithatë, thoshte Dhimitraqi, ai ishte i qeshur dhe plot besim në vete. I kishte thënë se do të bënte si do të bënte e shkollës nuk do t'i ndahej.

Ditari i Dhimitraqit ndezi në klasë bisëdën.

— Edhe unë e kam takuar — u hodh e foli Fa'miri. — Punon tamam si punëtorët e tjerë. Për shkollën e ka marrë malli shumë.

— Unë them, — u ngrit e foli Xhumaja, që i kishte zënë vendin Ndriçimit në byronë e klasës, — unë them që ta thérresim edhe Ndriçimin në mbrëmjen e vitit të ri.

Në klasë u dëgjuan zëra miratimi. Të gjithë dëshironin ta kishin Ndriçimin midis tyre. Por Fatmiri u ngrit prapë. Ishte mbasë shoku më i ngushtë i Ndriçimit, megjithëse me trup nuk i vinte as te supi.

— Unë, — tha, — mendoj se ne duhet të përpinqemi që Ndriçimi të mos e humbasë klasën.

— Çfarë të bëjmë?

— Unë them se mund ta ndihmojmë duke

i vajtur në shtëpi për t'i çuar mësimet që zhvillojmë në shkollë. Le ta marrin përsipër nja dy tre veta e të zotohen përpara klasës. Unë, për veten time, jam gati.

Fjalët e Fatmirit u pritën me gjëzim. Bashkë me të u zotuan edhe dy të tjera, Dhimitraqi dhe Xhumaja. Ata do të shkonin me radhë, herë njeri herë tjetri, ta ndihmonin që të mos shkëputej nga mësimet, të kishte mundësi të pregete për t'u paraqitur në provimet e maturës si i jashtëm.

Pas këtij vendimi, vazhduam mësimin me zemër të lehtësuar. Atë ditë gjëmimin e minave e pritëm me zhurim të madh. Na dukej që me ato krisma do të dëgjonim edhe zérin e Ndriçimit, do ta dëgjonim të brohoriste i gjuar për vendimin tonë, për dashurinë e shokëve që nuk e harronin.

#### 4

Por nuk ish nevoja që shokët t'i shkonin në shtëpi. Nuk zgjati më shumë se një javë, dhe një mbrëmje e pashë Ndriçimin në klasë. Ishte regjistruar në shkollën e natës dhe po më vështronte me buzë në gaz. Nuk ishte ulur

në bankën e fundit, siç bënte kur vinte ditën, por në bankën e parë. Mbas mësimit, e pyeta nëse lodhej.

— Një farë soji, — m'u përgjegj dhe ngriti supet.

— Po babai si u bë?

— Më mirë është, shoku mësues. E kanë bërë operacion e tani ka filluar të ngrihet nga pak.

Qe hequr ca në fytyrë, por ishte bërë më i sigurtë në fjalë e në sjellje; dielli e kish nxirë, duart i qenë ashpërsuar dhe ai tani bën-te çmos që t'i fshihte nga unë. Përleshej ditën me gurin, për orë të tëra godiste me varé popla, krepa e shkëmbej por kish mbetur, megjithatë, një nxënës si gjithë të tjerët.

— Nëqoftëse ke vështirësi në mësime, — i thashë, — më thuaj mua, u thuaj shokëve. Ata janë gati të të ndihmojnë.

— E di, shoku mësues. Falem nderit.

— Në fillim do ta kesh pak vështirë, por ti ke vullnet e me vullnet çdo gjë kalohet.

E vura re që u skuq dhe më erdhi mirë. Kish mbetur i thjeshtë, i pastër në zemër, ashtu siç e kisha njojur në shkollën e ditës.

— Unë do të përpinqem, shoku mësues.

Biseduam kështu një copëherë. Ai deshi të dinte për klasën, për mësimet, për nxënës të ndryshëm dhe, kurdoherë që dëgjonte një fjalë të mirë, sytë i shkëlqenin. Kur u ndamë, unë i zgjata dorën, shtrëngova pëllëmbën e tij të ashpër dhe i rashë në sup. Mbase nuk e priste një gjë të tillë, ndaj m'u duk sikur u hutua.

Tani me Ndriçimin shikohesha shpesh. E pyesja dhe në mësim e kurdoherë e gjeja të pregetitur. Nganjëherë, është e vërtetë, e ndjente veten të lodhur, sidomos orët e fundit, dhe atëhere i koteshin sytë. Megjithatë, po të lemë mënjanë këto çaste, kurrë nuk më ish dukur më i freskët, më i gjallë dhe më i qeshur. Një mbrëmje dhashë një temë hartimi: «Një ditë në qendrën time të punës». Ndriçimi u kërrus mbi fletore dhe brenda dy orëve shkroi plot katër faqe. Me siguri, është hartimi më i mirë që ai ka shkruar gjer atëhere dhe, mbase, është pikërisht ky hartim që po më bën dhe mua t'ju flas përtë. Hartimet janë pasqyra të ndjenjave të zemrës së nxënësve, por ai hartim ishte vetë zemra e Ndriçim Ubanit.

Frym erë. Bën ftohtë. «Shkurti shkurtont urët», — thonë. Rrezet e diellit janë pa ngrohtësi. Orët e para, në të ftohtë, punçhet vështirë. Pastaj trupi mësohet e nuk do t'ja dijë as nga era, as nga gurët që t'i ngrijnë duart, as nga hekuri i qysqisë, që, kur e shtërngon, të duket sikur ke në duar copa të forta akulli. Trupi të nxehet, sepse, të ngresh varenë e rëndë apo poplat e coprat e shkëmbit, do djersë.

Ndriçimi i ka kthyer shpinën erës dhe shtrëngon me të dy duart qysqinë. Ganiu e godet me varë. Ganiu tanë është mësuesi i tij. Është një burrë thatim, por i fortë çelik. Kur punon, e lidh kryet me shami: një nyje mbi ballë e një pas zverkut. Një bisht cigareje nuk i shqitet nga cepi i buzëve edhe kur është i zënë me punë, — qoftë duke goditur me varë, qoftë duke hetuar shtresat e damarët e shkëmbijve, qoftë duke ndezur minat. Cigaren më tepër e kafshon se sa e thith. Fjalët i ka të pakta, ato më të domosdoshmet. Të tjerat nënkuptohen.

Ndriçimi mban qysqinë, por mendjen nuk e heq dot nga kamioni. Nuk bëhej shu-

më që kishin filluar nga puna, kur kish dëgjuar një kor zërash që e kishte thërritur. E kishte lënë punën dhe kish vrapuar në rrugë të shikonte. Kishte parë duke kaluar kamionin e Bardhit, ku kishin hipur tërë shokët e klasës. Atje ishte dhe mësuesi i kimisë.

— Ndriçim! Ndriçim!

Ndriçimi kishte përshëndetur me dorë dhe zemra i kishte rrahur.

— Ku shkoni kështu? — kishte pyetur duke e ngritur zërin. — Ku shkoni kështu?

Nga kamioni, një tok zërash ja kishte kthyer se po shkonin në Zall, në fabrikën e cimentos.

Tani që mbante qysqinë, ndërsa Ganiu godiste me varë, i mendonte shokët në fabrikën e cimentos. Ai kish qenë dy herë atje dhe i kishte parasysh godinat e mëdha, oxhaqet, maqineritë madhështore. Të punoje në një fabrikë të atillë, duhej të ishte kënaqësi e madhe. Ganiu e kishte këshilluar që, kur të përfundonte fabrika, të shkonte e të punonte atje. S'e kishte keq Ganiu. Në atë fabrikë, pjesa më e madhe e punëtorëve kishin për të qenë krutanë. Fati i krutanit paskish qenë i lidhur me gurin, me shkëmbin. Një herë e një kohë, në shkëmbij e

gurë kishin luftuar; kishin nxjerrë gurë nga malet pér tē ndërtuar kullat e kështjellat trimë. Dhe kishin luftuar si burrat. Kurse tani po jetonin duke punuar me gurin. Atje poshtë digjen ditë e natë furrat e gëlqeres. Kruja u jep lëndë tē parë, gurë e gëlqere, kaq e kaq ndërtimeve në atdhe. Ai i kishte parë kamionat që ngarkoheshin e që mbanin targa tē ndryshme, thuajse nga tërë vendi. Tani Kruja do tē bëhej e dëgjuar edhe pér çimenton, tha-sët do tē mbanin emrin e qytetit tē tij tē lindjes. Po pér tē punuar në atë fabrikë duhet shkollë, se atyre maqinave nuk ua mëson sa çel e mbyll synë tē fshehtat, ashtu siç ndodh me varenë, me qysqinë apo me shkëmbinjtë e gurores.

— Do tē bjerë shi, — tha Ganiu duke ngritur kokën lart.

Kur binte shi, puna vështirësohej edhe më tepër, gjersa ndërpritej fare. Dhe nuk ka gjë më tē mërzitëshme se sa tē rrish duar-kryq në mes tē gurores, tē shikosh shiun që bie mbi gurë, mbi veglat e punës, mbi varetë e qysqitë e trasha.

Po afronte dreka. Foletë ishin gati tē gjitha. Kishin hapur plot tetë. Punëtorët po i mbushnin. Kjo, padyshim, ishte puna më deli-

kate. Duhej kujdes në vendosjen e llokumeve të dinamitit, në lidhjen e fitilit, në futjen e kapsullës, në mbushjen e folesë me gurë... Pikërisht kur po kryhej kjo punë kaq e vësh-tirë dhe e rëndësishme, sepse një vatër e vendosur keq, shpie dëm gjithë punën e ditës, ja dha shiu. Në fillim nisi të cirkojë, por kuptohej se, pas pak, do të shtrëngonte. Retë qenë mbledhur mbi kokë të tyre, të zeza, të rënda.

— Shpejt, — tha Ganiu, — t'ja lagim shiut! — Dhe vuri buzën në gaz me shakanë e tij.

Të gjithë venin e vinin për t'i dalë shiut përpara. Sa të ndiznin fitilat kishin hall, se pastaj dinamiti e bënte punën e vetë.

— Gati?

— Gati!

Shiu shtrëngoi.

Ndezën fitilat. U larguan të gjithë. Për t'u mbrojtur nga shiu, u strukën ku mundën dhe po prisin.

Befas, Remziu, një nga minatorët, i vendosur roje në maje të kodrës, tundi flamurin e kuq duke thirrur:

— Kamioni! Kamioni!

Ganiu nxori kokën.

— Ta marrë djalli! — tha dhe e flaku tutje bishtin e cigares.

— Ç'është? — pyetën të tjerët pranë tij.

Nga ngutja, nga shiu, kishin harruar të nxirrnin një njeri me flamur të kuq, siç e kishin rregull, nga ana tjetër e rrugës. Remziu vazhdonte të thërriste nga kodra dhe flamurin e tundte me shqetësim të madh. Qe kthyer nga kamioni e orvatej që ta shikonin. Pas një grime u dëgjua zhurma e maqinës; me sa duket nuk e kishin parë shenjën e Remziut, se sa për zërin e tij, nga shiu, nuk kishin se si ta dëgjonin.

Fitilat digjeshin. Të kaloje me vrap copën e rrugës për t'i dalë maqinës përpëra, do të thoshte të rrezikoje kokën.

Ganiu s'priti. Doli nga strehimi dhe ja dha vrapi. Por s'kish bërë as dhjetë hapa, kur u pengua në një tog gurësh; këmbët i shkanë dhe ai ra përmbyss.

Zhurma e maqinës afrohej. Tani duhej të ishte pas bërryli që të nxirrte përpëra minave. Ganiu nuk po ngrihej dot.

Fitilat digjeshin.

Dikush u vërsul përpëra. U bë erë! Ishte Ndriçimi. Copën e rrugës ku do të rrokulliseshin shpellat e gurët e shqyer nga minat, e kaloi pa marrë frymë fare.

Maqina u duk pas kthesës. Ishte kamioni

i Bardhit. Ndriçimi ngriti krahët lart dhe i tundi. Bardhi, shoferi, frenoi. Por edhe atje ishte zonë e rrezikshme.

Kur arriti Ndriçimi përpara maqinës, mina e parë shpërtheu.

— Térhiq pas! Térhiq pas! Këtu janë tri mina!

Shoferi manovroi pas.

Minat shpërthyen.

Kur qëndroi kamioni mbrapa kthesës, në rrugë u rrukullisën popla të mëdha dhe e zunë kalimin.

— Ç'fatkeqësi do të kishte ndodhur! — tha Bardhi dyllë në fytyrë.

Nga karroceria e mbuluar me mushama, ata që kishin hipur, zgjatën kokën. Ndriçimi i pa: ishin shokët që ktheheshin nga ekskursioni.

Shiu binte me rrëmbim mbi fytyrën e tij, e kish lagur dhe e kish bërë qull; ai di-haste me ngut e thellë nga të nxituarit, nga stërmundimi, nga tmeri i këluar. Por në zemër ndjente një lumturi të madhe.

Remziu, që kish zbritur nga kodra, e përqafdoi gati me lot në sy. Me të tjerët erdhi duke çaluar edhe Ganiu, që e shtrëngoi në krahëror. Bardhi atë çast mori vesh se kush i

kish shpëtuar. Doli nga maqina dhe i rroku djalit dorën. Nga kamioni zbritën të gjithë nxënësit. Në mes të shiut, ata e rrethuan Ndriçimin, shokun e tyre, e nuk dinin ç'të thoshin nga gëzimi e krenaria.

## 6

I ati i Ndriçimit u shërua, por nuk u kthye më në gurore, ku puna për të ishte e rëndë. Hyri në një ndërmarrje brenda në qytet. Tani i biri mund të kthehej në shkollën e ditës dhe vërtet ashtu ndodhi. Kthimi i Ndriçim Ubanit në klasë qe një festë e rrallë për të gjithë shokët e shoqet e tij.

— Puna është shkollë, — u thoshte Ndriçimi shokëve që e kishin rrethuar bankën e tij e s'dinin të largoheshin. — Dhe një shkollë e madhe që të mëson shumë gjëra, të cilat më parë njeriu as që mund t'i marrë me mend!

Në klasë, çdo ditë, në orën e caktuar, ne ndërpresim mësimin kur buçasin minat e gurores. Dhe sa herë që i dëgjojmë ato, një gëzim e krenari pushton zemrat e nxënësve që kthejnë kokën nga Ndriçimi. Ato gjëmime u ngjajnë si zëra të një bote të madhe e të bukur, si grishje të fuqishme të botës së punës, që shoku i tyre e ka njojur...

## KRESHNIKU

**K**ur dolëm nga ara me misër, ramë në bregun e rrëpirë të lumit të mbuluar me shelgje dhe gëmusha të mëdha e të larta ferrash, që s'të linin t'i afroheshe ujit.

Për mua ishte hera e dytë që shkoja për peshkim. Kurse Hyseni ishte usta i vjetër. Në historikun e tij të lavdishëm, ai kishte afro një kuintal peshk, të zënë poshtë e lart nëpër lumejt dhe liqejt e Shqipërisë. Më linte me gojë hapur kur niste të fliste me hollësira për ujrat e këtij lumi apo të atij tjetrit, duke më përshkruar me zjarr dhe entuziazëm bollëkun e peshqve dhe madhësinë e tyre... I kishin thënë se në lumin e Gjoles kishte ngjala, ndaj tani kishim vendosur ta provonim. Flitej se ngjalat e lumit të Gjoles ishin të trasha sa llëra e krahut.

Kur shkitëm në shpatin ranor të lumit, me rrezik të përfundonim në fund të ujit të turbullt, Hyseni, për të më dhënë zemër,

më përmendi edhe një herë ngjalat e trasha sa llëra e krahut.

Një javë përpara kishte rënë shi; një përmbytje e vërtetë kish qenë. Gjurmët e ujit të rrëmbyeshëm, me fijet e barit, degët e thyera, leckat e pisllëqet e shumta, dukeshin shumë lart mbi kokat tona, në brigjet e çrrëgullta e të çuditshme të lumit. Bile edhe në majë të shelgut, rrëzë të cilit kishim qëndruar, kishin mbetur tufa kashte dhe copra letrash si çerdhe të prishura laraskash...

Zura vend në një trung lisi. E kish prurë lumi dhe kish ngecur gjysmë i mbështetur në breg e gjysmë i kredhur në ujë. Nxora masuret me fildispanja, vura karremin në majë të grepit, e rrrotullova fillin mbi kokë dhe e vërvita tutje. Plumçi ma tërhoqi nga dora dhe e fundosi në një pellg të thellë.

— Të lumtë! — më lëvdoi Hyseni gjithë qejf. — Tani shtrije fillin por mos tërhiq!... Ashtu! Shumë mirë e ke!...

Ndërkaq, për vete të tij, rregulloi kallamin me gjithë makinetën e vogël dhe nisi të gjuajë me flutur...

Hoqa këmishën dhe e mbështolla si çallmë në kokë. Dielli digje. Ca miza me shkëlqime të neveritëshme mavi, se nga mblidheshin

aty, në breg të lumit, dhe s'të linin të qetë...  
Orët kalonin.

Me sytë ngulur mbi sipërfaqen e turbullt  
të ujit, diellin mbi kokë, me shushurimën  
monotone të lumit, mua m'u rënduan qepa-  
llat e mezi po i bëja ballë gjumit...

As peshqit, as ngjalat nuk po dukeshin  
kund. Hyseni vazhdonte të hidhte e të mblidh-  
te grepin me flutur. U çngëtha e shkunda ve-  
ten. Dukej qartë se kisha nisur ta humbisja  
durimin. Ja ndërrova disa herë vëndin fillit.  
Hyseni më këshilloi të mos e humbisja gjak-  
ftohtësinë, se ngjalat ashtu e kanë, ruhen shu-  
më para se të ngasin grepin, bile, edhe kur e  
ngasin, e prekin lehtë, sa që, po të mos e  
kesh mendjen, as që e ndjen fare... Më  
spiegoi pastaj huqet e peshqve... Mësova  
kështu se qefulli e godet grepin me turi, sa të  
duket sikur të godet njeri me çekiq në gishtë-  
rinxhë e dorës; krapi e godet grepin si i ur-  
tur dhe ikën tutje; mustaku e prek një herë  
pastaj ikën, pas një grime kthehet prapë dhe  
atëhere e nduk; mlyshi është dinak, nganjë-  
herë i ngul dhëmbët fildispanjës e kërkon ta  
këpusë, ndërsa blini — oh blinat e Valbonës!  
— blini...

Befas, nga bregu përballë, u dëgjua një

zhurmë... Ishin zëra fëmijësh dhe trokëllima thundra kafshësh...

Ngritëm kokën të dy, edhe unë edhe Hyseni. Nja tri lopë dhe pesë a gjashtë viça u varën poshtë, në bregun përballë, duke dalë nga gëmusha ferrash dhe shelgjishtesh. Viçat iknin me bisht përpjetë. Pas tyre, plot potere, rendnin ca fëmijë — kish dhe nga ata që nuk mund të ishin më shumë se pesë vjeç — me shkopinj e ca kapele të çuditshme në kokë. I fundit fare u duk, hipur majë një kali të bardhë, një çunak dhjetëvjeçar. Kali ishte pa shalë dhe kalorësi mbahej pas lelevë, por me një qëndrim aq të bukur e madhështor e me një siguri aq të madhe në atë të tatëpjetë të thepisur e të rrezikshme në të kaloruar, sa që ne i harruam peshqit dhe po vërenim gojëhapur pamjen që kishim përpara.

Lopët e viçat u përhapën bregut, mbësh-tetën buzët e gjera mbi sipërfaqen e ujit e nisën të pinë, duke tundur bishtin plot këna-qësi. Qark tyre, fëmijtë vazhduan lodrën duke ndjekur njeri tjetrin me shkopinjtë, që i përdornin si shpata apo heshta... Lopët hera herës kthenin kokën të bezdisura... Vetëm kalorësi majë kalit ishte i heshtur dhe madhështor: me një dorë në ijë, me tjetrën lë-

shuar mbi lelet e kalit, ai shikonte ujët e lumi-  
mit si i menduar, ndërsa kafsha pinte e qetë,  
me rrufitje të zgjatura...

Për një çast m'u duk se, befas, një çfaqje  
e bukur, plot ngjyra dhe freski, nisi të zhvi-  
llohej përpara syve tanë...

Në fillim, fëmijtë nuk na vunë re, por pas-  
taj lanë lodrën e potershme dhe u radhitën  
në bregun ranor të anës tjetër, si varg rosash  
e patash, dhe na i ngulën sytë plot kureshtje.  
Kjo nuk zgjati veçse një grimë, se pastaj u  
larguan përsëri. Por pikërisht atëhere, kalorë-  
si i vogël majë atit të bardhë, e ngau kaf-  
shën më përkëndej. Tundi dorën dhe na foli:

— Gjah i mbarë, or shokë! — tha.

Zëri i tij ish i njomë, por ai mundohej  
ta ntrashte. Nga ana tjetër, si shenjë pjekurie  
e burrerie të përsosur, mundohej të rrudhë  
ballin. Tani që e kishim më afër, shquanim  
më mirë ftyrën e tij vezake, me hundën e  
shtypur dhe flokët e zinj, që i binin mbi ve-  
shë dhe baluke mbi ballë. Na u duk më i vo-  
gël, më i imët. Mbase kjo përshtypje na për-  
ftohej për shkak të kalit të lartë e trupmadh  
që bënte kontrast me trupin thatim e të pakët  
të kalorësit, këmbët e zbathura të të cilit, të  
ngjeshura fort pas trupit të kafshës, nuk arri-  
nin as në bark të kalit.

Hyseni e pyeti për peshqit e ngjalat e lumenit. Fshatari i vogël rrudhi një herë buzët, i zgjati përpara sikur do të puthte njeri, pastaj u përgjegj:

— Si t'ju them, or burra, — na e ktheu:  
— edhe ka, edhe s'ka...

— Si kështu?

— Ja, për shembull, atje ku jeni ju, për besë, nuk ka veçse bretkosa...

— Ashtu? — ja bëri Hyseni gjysmë i habitur e gjysmë i cënuar në sedër. — Po pse, ku ka?

— Poshtë, në pellgjet e thellë... Atje zamë peshk na...

— Me grep?

— Jo, or burrë, — u gjegj kalorësi, — me grep duhet të rrish gjithë ditën e lume!... Koshi të ngop! Koshi ta mbush fëlteren!... Me kosha zamë na kënde!

Kishte të drejtë. Ne po bënim lart nga dy orë në atë vend, midis mizave që na bezdisnin pa reshtur, e megjithatë asnjë peshk nuk kish marrë mundimin të na prekte grepin. Duke dëgjuar fjalët e kalorësit për koshat që të ngopnin e të mbushnin tiganin plot, m'u duk fildispanja që mbaja në dorë, si ndonjë fill peri me të cilin kisha lidhur ndonjë lodër

nga ato të fëmijëve e tani po e tërhiqja nëpër ujë...

— Veç kësaj, është shokë, nga dreqin paskeni kalue andej, midis ferrave e gjembave të dynjasë?

Hyseni u kapërdi. Unë ktheva kokën e pashë bregun e lumit nga kishim zbritur. M'u duk lëmsh i tmershëm drizash, ferrash e shelgjesh të egjér... Atje ishim gërvishur e çjerrë në rroba e nëpër krahë...

— Hidhuni nga kjo anë, — tha çunaku.

— Si të hidhemi? — pyeti Hyseni duke mbledhur fillin me makinetë.

— Po vij unë e ju marr me kalë.

Pa pritur që ne t'i thoshim gjë tjetër, e futi kalin në ujë.

— Mos éshtë thellë aty, në atë pellg?

— Jo, hej burrë! — ja bëri trimi i vogël.

— Këtë lumë e njoh me pëllambë, sikur të ishte shpia ime...

I pari hipi Hyseni. Përpara kalorësi, në vithe ai. Pastaj më erdhi radha mua. Kur pata përpara kokën e çunakut, një kokë të vogël, mbi shpatulla të njoma, mendova një çast ta përgëzoja, duke i thënë ndonjë fjalë të mirë, por e bëra gjuhën zap me kohë, mbasi isha i sigurtë se, ta trajtoje si fëmijë, do të

ishte fyerja më e madhe për të. Kur zbrita në breg, u hodh edhe ai nga kali dhe atëhere Hyseni i dha dorën, bëri toka, duke e falën-deruar. Ashtu bëra dhe unë. Pastaj Hyseni e pyeti se si e quanin.

— Gjetë ma thonë emnit, — e m'u duk se mburrej me kumbimin e emrit të tij. — Gjetë Mhilli!

Pa e zgjatur më tej u hodh e na pyeti ne. Deshi të dijë emrin tonë, nga vinim, ç'e mirë na kishte hedhur ndër ato anë, me ç'punë merreshim, në ishim të martuar, bile edhe në kishim fëmijë...

Kur dëgjoi që vinim nga Tirana, na hodi një vështrim të shpejtë, sikur donte të bindej se ishte ashtu siç thoshim ne. Mbase — ku ta dish? — i dukej e habitëshme, e pasueshme, fëminore, që dy burra nga Tirana, bile njeri edhe me mustaqe e syza majë hundës, me kalamaj në shtëpi, të vinin aty, të cirreshin nëpër ferra e gjëmbaça, të hidh-nin grepin nëpër pellgje, ku kishte vetëm bretkosa, e të pritnin si guakë se mos kushti gjendej ndonjë peshk budalla dhe u kafshonte karremin... Por s'e bëri veten. Vështrimi i tij qe i mprehtë, i mençur, hetonjës, por tepër i shpejtë.

Tani që e kishim përpara, dukej qartë që sytë e tij të zinj kishin shkëlqimin e pastër fëminor, megjithëse ai vrënjeni ballin, kurse pantallonat e shkurtra prej doku e këmbët e zbathura e tregonin me të tëra fëmijë. Në kanotierën bojë qielli kishte shkruar me të kuq numrin nëndë, atë të qëndërsulmonjësit.

— Këtu asht kufini, — na spiegoi. — Ju tash jeni në zonën e katunit Bilaj, kurse nga ana tjetër e lumi asht katuni Hasanaj...

Hyseni deshi të bëjë shaka. Tregoi me dorë fëmijtë e tjerë me shpata druri e kapele lettrash në kokë e tha:

— Kurse këta duhet të janë kufitarët!  
Gjeta kërveshi buzët dhe i zgjati përpara.

— Ata janë kalamaj, hej burrë! — tha duke ngritur krahun. — Kalamajt ashtu e kanë. Atyre u flet goja para mendjes. Marrin nji kallam e u duket shpatë, ja hypin nji shkopi e u duket vetja si Gjeto Basho Muja majë gjokut!

Qeshëm të tre, ne, burrat. Pastaj Gjetë Mhilli, me lëvizje të rënda burri të pjekur, na ftoi për në fshat, për një kafe e një cigare duhan, në shtëpinë e tij. Bile do t'i bëhej qejfi të rrnim dhe për drekë, se peshqit, tha,

s'kishin ku të iknin, në Gjole kishim për t'i gjetur prapë. Hyseni e falënderoi dhe, duke i rënë në krah, i foli për trimërinë dhe bujari në e atyre anëve. Unë sosa falënderimin e nisur nga Hyseni. Por Gjeta nguli këmbë.

— Shpat' e trimit, — tha, — dhe tryeza e zemërbardhit, motër e vëlla janë! Ne, nga anët tonë, or burra, kështu jemi: trima e zemërbardhë! Dikur, siç thotë gjyshi, kemi qenë edhe të vorfën, por kjo e keqe na u hoq qafet njiherë e përgjithmonë... Se s'mahet shpia me miell hua, as me faleminerës... Sot djersitim e i mushim hamarët plot...

Ne tundëm kokën në shenjë miratimi. I thamë se koha e skamjes nuk kthehej më, se për këtë qenë vrarë e kishin derdhur gjakun bijt e bijat më të mirë të popullit. Gjeta na e mori fjalën nga goja.

— Ma mirë i kuq nji herë, se sa i zi gjithëherë!... — tha dhe sytë i vetëtinë.

Kjo fjalë e urtë shkëlqeu në gojën e tij, si një gur i çmuar rrezellor. Ai e kuptoi këtë dhe iu bë qejfi.

— Kështu thotë gjyshi, — vazhdoi. — Partizanëve, thotë, m'iu lumtë gryka e pushkës!

Nuk ishte hera e parë që përmendte gjy-

shin. Në mendjen time, si padashje, gjyshi i Gjetës kish marrë trajtë e një kreshniku hiperbolik. Një gjë e tillë duhej të kish ndodhur edhe me Hysenin, që i harroi ngjalat. Pyetëm për gjyshin. Gjeta i vogël vuri buzën në gaz; me siguri, më shumë se atë gjysh, ai nuk donte asnjeri tjetër...

— E kam plak, — tha, — e tash kohët e fundit s'po sheh mirë as nga sytë!.. Por zemra i kënon gjithmonë, zemra e lavra!

— Këndon me lahutë?

— Kangëtar ma të fortë nuk keni për të gjetë, or shokë e burra, t'i kërkoni këto ara e fusha kand e kand! Lavra e tij ta çmend zemrën! Zani i tij — barot në gjak! Kanga kreshnike e gjyshit të ban me kenë trim e bir trimi!...

Lopët, viçat dhe, mbas tyre, fëmijtë e tjerë, ishin larguar nga lumi. Kishim mbetur vetëm ne: unë, Hyseni dhe Gjetë Mhilli me këngët kreshnike të gjyshit. Nuk dinte si të na e spiegonte bukurinë, shkëlqimin dhe zjarrin e këngëve të lahutës së gjyshit. Na foli për kreshnikë hipur në shpinë të atllarëve, me shala maxharesha e frena treqind pullash; na foli për tridhjetë agallarët e Jutbinës që, «kur kanë ba ujë gjokve me u dhanë, kurrnji pikë

me rredhë te poshtë s'p'e lanë»; na foli për gjokun me jdanxhi të Gjeto Basho Mujit, për vetë Gjeto Basho Mujin që, kur «ngjeshi shpatën e mejdani» dhe msyni krajlin «e veshur me lëkurë arushe», «dy konopë përpjetë gjokun e ka çue» dhe ja ka këputë kokën armikut faqesi, si të priste një këpujë bostani... Po s'mbaroi me kaq se «tre gjarpinj në bark ia kish gjetë» krajlit, Mujo bubullima...

— Kur kënon për Gjeto Basho Mujin, — tregon kreshniku i vogël, — gjyshit i duket se kënon për mue, se dhe mue Gjeto ma ka vue emnin... Kështu thotë... Por unë e di se ata kreshnikë sot kanë metë veç në përralla! Sot ka kreshnikë të rinj!

Ujët e turbull të Gjoles shushurinte në këmbët tonë. Dielli digje në qiell dhe e kishët mbushur ajrin plot shkëlqim. Ne kishim mbetur me fildispanjat e kallamat në dorë, si njerëz që s'dinë ç'të bëjnë.

Gjeta e fërshëlleu kalit, që, i bindur, iu afrua dhe qëndroi pranë tij, duke i bërë hie me t'u pin e madh.

— Në shpi nuk dashkeni me ardhë, — tha kalorësi i vogël, — e mue po më vjen shumë keq...

Hyseni diç murmuriti.

— Ejani atëhere, — vazhdoi Gjeta, — t'ju çoj në nji vend ku ka hem peshq, hem njala...

Ai ecte përpara, ne pas. Kali na ndiqte çap pas çapi si manar. Iu ngjitëm bregut dhe dolëm lart, në një arë të mbjellë me lulëdielli, që e kishin korrur e mbledhur kapica. Tutje gumëzhinte një maqinë — maqina për shirjen e lulëdiellit — na spiegoi Gjeta. Ecën një copë herë anës lulëdiellit, gjer sa ramë në një arë të mbjellë me misër.

Kallamat e misrit ngriheshin të lartë; gjethet shpatore ishin të gjelbëra, sikur nuk donin t'ja dinin nga dielli i fortë; kallëpet e misrit, të mëdhenj si kunguj byreku, kishin shpërthyer nëpër sqetulla të kallameve...

— Misër i bukur! — thamë me një gojë unë dhe Hyseni.

Gjeta na dëgjoi.

— Sytë ju lumshin, hej burrat e dheut!  
— na e priti. — Gjyshi thotë se kooperativa asht zemra e tokës, ajo ban çudina si kjo... Ky misër asht i dyti, asht për silazh, por asht ba ma i bukur se misri i parë... E kët e kan ba veç kreshnikët e kooperativës, kreshnikët e rinj!

Ne kthyem kokën dhe pamë një copë herë

trimërinë e gjelbër të kreshnikëve të rinj...

— Po ti, Gjetë, — u hodh Hyseni pastaj dhe e pyeti, — çfarë do të bëhesh kur të rritesh?

Gjetë Mhilli u përgjegj flakë më flakë. Gufoi gjoksin e tha:

— Traktorist po due m'u ba! Si kreshnikët e SMT-së!

U varëm poshtë nëpër bregun e lumit. Gjeta ecte pérherë pérpara. Nga pas, sikur po e tërhiqte njeri pér kapistre, vinte kali. Gjeta na njoju me vendet rrith e qark. Na tregoi ku qenë pellgjet, ku duhej të rrinim, ku të pritnim peshk e ku ngjala dhe pastaj u hoq mënjanë pér të na lënë vënd ne.

As unë as Hyseni nuk donim të ndaheshim kaq shpejt nga Gjetë Mhilli. Mua nuk më bënin duart të çpështillja lodrën time, fil-dispanjën, e ta hidhja në lumë; por edhe Hyseni nuk kish më ato lëvizje të shkathëta e të shpejta në mbërthimin e kallamit, në rregullimin e makinetës, ashtu siç i kisha vënë re herë të tjera...

— Tash, or burra, po ju la, — tha Gjeta, — më presin shokët...

— Ku do të shkosh, Gjetë? — pyeti Hyseni.

— Te stalljerët... ata po ndihmojnë kët javë... — Tha këto dhe erdhi u tok me ne. Pastaj iu afrua kalit dhe iu var në qafë. Kali nuk u tund nga vendi. Gjeta hapi këmbët dhe i ngriti në shpinë të kafshës, u dha një shtytje dhe u hodh në majë të kalit.

Kali u nis në çast. Gjeta ktheu kokën, na përshëndeti me dorë dhe pastaj u mbajt me të dy duart për lele të kalit. Kafsha ngjitej në breg, ndërsa kalorësi i vogël, me trupin shtrirë pak përpara, qëndronte i sigurtë, sikur të kish lindur majë kalit... Kur arriti sipër mbi breg, ktheu kokën përsëri nga ne, tundi dorën një herë e i dha kalit përpara... Ngau kalin dhe ja tha këngës, si gjyshi i tij kreshnik.

**Dehen lavra e çiftelia,  
ka dhetë herë kërcet alltia!**

Ne ngritëm kokën dhe pamë shtegun nga u largua ai, duke dëgjuar zërin e tij, gjersa u shua e nuk u ndje më...

Ujët shushurinte. Fillin e grepit e mbaja të tendosur, por mendjen e kisha te Gjeta. Më dukej sikur e shikoja majë kalit duke bëdhur arave të kooperativës, midis kreshnikëve që e bënин misrin hamullor të rritej aq, që mbushnin në maqinën shirëse thasët e panu-

mërt me lulledielli; midis kreshnikëve që kishin kryer çudinë e madhe duke e nxjerrë nga skamja fshatin dhe duke e kredhur në jetën kreshnike të ditëve që po kalonte... Më kot e kish pyetur Hyseni se ç'do të bëhej kur të rritej: ai ishte që tani një kreshnik i ri, një bujk kreshnik i kooperativës...

Fildispanja lëvizi. Peshku po godiste. Qenë goditje të forta, të vazhdueshme... Më dukej sikur nuk po prekte karremin, por gishtérinjtë e mi...

— C'është? — më pyeti Hyseni kur pa se tendosa trupin përpara.

— Po e nget, po e nget! — thashë me zë të ulët, sikur po rrëfeja ndonjë të fshehtë.  
— Dhe kafshon fort...

Hysenit i lëvizën mustaqet lart dhe, nën syza, sytë i nxorën xixa.


— S'janë dokudo, — tha gjysmë me shaka, gjysmë me tërë mend, — janë peshq kreshnikësh dhe këta...

Gjetë Mhilli majë kali, pioneri i vogël i Bilajt, **kushedi nga bridhët tani me èndrat** trime dhe zemrën e tij kreshnike...

## P A R K U

### 1

Meremja mendohet në shtëpi dhe nuk di nga t'ja mbajë. Të gjitha ato që kish dëgjuar atë pasdite, ishin të drejta. Ajo ishte gati të bënte be e rrufe se i pëlqenin tërë ato projekte. Mu në të hyrë të qytetit, parku i rinisë do t'i thoshte cilitdo vizitor, që vinte të shikonte Krujën shekullore, se ai vend ish i gjallë, me një rini të qeshur, me një jetë, të re që shpërthente plot ngjyra në ato gërxhe e skërrka. Nëqoftëse atje, majë shkëmbit, gërmadhat e kalasë ishin dëshmi e së kaluarës; parku i rinisë, mu në hyrje, do të ishte dëshmi e së sotmes dhe e së ardhmes. Dhe kish qenë një gjë me të vërtet e bukur e kuptimplotë, siç kish thënë në mbledhje vetë i deleguari, që, pikërisht vitin e pesëqindvjetorit të vdekjes së Skënderbeut, të rinjtë kishin dashur ta festojnë, veç të tjerave, edhe duke e zbuluar



kësisoj selinë e kryetrimit. Meremja e kish ndjerë gjakun t'i gufone në zemër nga këto fjalë. Ishin të gjithë atje. Qenë ulur në sheshin e pjerrët e të gjelbër midis selvive, ndërsa i deleguari kish qëndruar në këmbë, poshtë, për t'i patur të gjithë përballë. Ajo e do Krujën, se e ka vendin e lindjes; se atje po rritet e po piqet, se atje ka shtëpinë, ka shokët e shoqet, se atje — si thotë dhe vjersha — ka qeshur e ka qarë. E shikonte Krujën e saj të zbukuruar, me rrugë të shtruara me plloça, me kopshte, me shkallë guri të skalitur, që lidhin rrugët, me ndërtesa të reja, themelat e të cilave kishin nisur t'i hidhnin, me hotelin turistik në sheshin mbi monumentin, me dritat elektrike me forma karakteristike në qoshetë rrugëve, me vargun e dyqaneve në pazarin e vjetër, të rindërtuar ashtu siç kish qenë para se të digjej nga armiqjtë gjatë luftës, me... Meremja nuk e di as vetë se ç'ndjenja krenarie dhe entuziazmi e trazojnë në zemër, kur mendon të gjitha këto. Dhe në çaste të tillë është gati të rrëmbejë kazmën e të mos e lëshojë nga dora, derisa parku të marrë fund.

Megjithatë, tani ka rënë në mendime. E mundojnë varret.

Të punoje për të ndërtuar parkun, ku, veç

fushës së volibollit e basketballit, do të ngrihej dhe një kënd lojrash të ndryshme për më të vegjëlit, me shilarsa, shkallë për të rrëshqitur, pista për të vrapuar e të tjera, ishte një punë fort e bukur për të rinxjtë e shkollës. Për këtë Meremja qe e bindur. Vërtet atje kish qenë më parë një teqe, por po bëheshin vite që teqja me gjithë varret qe shpërndarur andej. Kryegjyshata e kishte vendosur poshtë, në Fushë-Krujë. Tani ai vend kish mbetur një shesh i braktisur dhe gropat e varreve të shpërndarura i kishin mbuluar ferrat. Po ku ta dish që në atë copë sheshi të mos ketë varre të tjera?

Kruja është mbushur me varre. Varre në Krastë, varre në Abazaj, varre në dyzet teqetë, varre në kopshtet e shtëpive, varre në mes të pazarit... Dhe këto varre, në disa lagje, kishin zënë vendet më të bukura, ndërsa shtëpitë e të gjallëve qenë struktur ku të mundnin, sikur të druheshin mos zemëronin të vdekurit.

«Dyzet teqe!... — mendon Meremja. — Dy dervishë të vdekur në varre gjysmë të rrënuara, një mbishkrim turqisht mbi një rrasë të nxirë, një shtëpizë e vogël aty pranë për dervishët e gjallë e jo keq nga shëndeti,

dy selvi, pemë e pjergulla për raki qark, të gjitha këto, rrrethojoj me një mur të lartë e do të kesh «vendin e shenjtë». Në të vërtetë, ata të vdekur nuk ishin aspak «të shenjtë». Mirë e kish thënë i deleguari: ata kishin qenë «komisarët» e sulltanëve!

«Po ec e thuaja të gjitha këto gjyshit! Ai mendon ndryshe. Edhe pak më mbyti kur i thashë se të nesërmen do të shkoja të punoja dhe unë në parkun e të rinjve. Ai vend, thotë, është i shenjtë e, kush vë dorë në të, e pëson! Ja, prit kur t'i zerë gjynahu! Nuk do të ndahen dot pa kurban, jo!»

— Po ai vend nuk është më teqe, mor gjysh.

— Ka qenë, — thotë gjyshi. — Kjo mjaf-ton për ta shenjtëruar!

— Po atje ka kohë që s'ka varre. Vetë xha Llani i ka hequr...

Xha Llani është i kryegjyshatës.

— Eshrat, — thotë gjyshi, — eshrat ka hequr, por shpirti i të vdekurve është atje, në tërë atë truall që shkelni ju, në tërë atë gjelbërimin që shpërthen qark... Mjerë ata që guxojnë!

«Dhe gjyshi di të ta mbushë mendjen. Ai i ka jetuar vetë mrekullitë e «vendeve të

shenja»: ato që rrëfen, të lënë gojëhapur dhe pa gjumë natën. Janë histori të llahtarshme të vdekurish, që ngrihen kokudhë nga varri dhe kërkojnë hakmarrje. . . Ç'është e vërteta, thotë Meremja, kur hyra në oborrin e asaj ish-teqeje, ndjeva një shtrëngim në zemër dhe gjunjët m'u prenë. Po, domosdo, s'e dhashë vreten. Po të tjerët? Kushedi. Por kush mund të thotë se ç'ka njeriu në zemër? Vërtet as çanin kokë për asgjë, vërtet qeshnin e bënin shaka, vërtet ata që u ngritën e folën — të gjithë maturantë, se atyre u pat rënë në mendje kjo punë — thanë se mezi prisnin të fillonin nga puna, por: «Ehehe, — thotë gjyshi, — në shtëpitë e tyre kushedi se ç'sherr kërcet!» — E mirë, ja u bëkan sherre po të rintjtë, ama, i janë përveshur punës e nesër do të shkojnë dhe të tjerë. Po kësaj ç'i thua, babagjysh?»

## 2

Meremja shkon te Sabai. Nënën e Sabait ajo e ka hallë. Hallë Tixhja i ngjan në fytyrë e në trup vëllait të saj, të jatit të Meremes, që ka vdekur këtu e dy vjet të shkuara. Megjithatë, me ç'mban mend Meremja, babai që ndryshe, ishte i butë me fëmijtë, kurse halla ka dorë dhe është helm nga goja. Sabai e

ka provuar kaq herë dorën e saj. Jo vetëm Sabai, edhe motra e madhe, Kumria, të cilën, para katër muajsh, e kanë mbyllur. E lanë të bënte vetëm shtatëvjeçaren, pastaj i hodhën çarçafin e zi. Meremes nganjëherë i vjen çudi, s'i besohet që Kumria duron e mbyllur në shtëpi, ajo që është aq e qeshur, aq e shkathët dhe aq këngëtare. Rri e gjora kërrusur mbi gjergjef dhe këndon. Këndon me mall. Hallë Tixhja s'ja duron as këngët, sidomos kur kuption që, në ato fjalë dhe melodi, e bija vë zemrën e saj. Dhe këngët e Kumries të tillë janë: flasin përherë për zemra të ndrydhura që digjen nga malli, për diell, ajër, jetë... Megjithatë, Kumria s'e mbyll gojën dhe shtëpia gjëmon nga këngët, sikur ato të jenë të vetmet armë që i kanë mbetur.

Nganjëherë Meremes i shkon dicka në mendje, që e bën t'i rrëqethet mishtë. Ja, edhe ajo po kryen të shtatën. Pastaj ç'do të bëjë? E sheh veten të mbyllur si Kumria dhe një nyje i bëhet në grykë, në krahëror i mblidhet një lëmsh që i zë frymën. Në shkollë, midis shokëve dhe shoqeve, duke dëgjuar mësimet dhe duke lexuar librat, ajo bëhet më e fortë, më guximtare dhe i duket se me atë, Mermen, asnjeri nuk do të kuturisë të bëjë atë

që kanë bërë me Kumrien. Megjithatë, kur kthehet në shtëpi, kur sheh gjyshin, kur shkon te halla dhe sheh Kumrien, i ngjan sikur të gjitha përpjekjet e saj janë të kota. Atëherë ka frikë të mendojë dhe vendos të mos çajë kokën, të jetojë pa e menduar mbylljen e saj në shtëpi, ashtu si njerëzit jetojnë pa e menduar vdekjen.

Burri i hallës dikur ka qenë një tregëtar i vogël, si gjyshi i Meremes, bile gjyshi ja pat bërë krushqinë. Tani është magazinier në Fushë-Krujë. Megjithëse ai e ngre zërin sa që e dëgjojnë edhe komshinjtë, në shtëpi urdhëron hallë Tixhja.

— Qyqja, — i thotë halla Meremes, — edhe të vdekurit s'po i lini rehat! Po keni për ta gjetë nga Allahu!

Meremja, përballë saj, nuk flet. Hesht edhe Sabai që kushedi për të satën herë i dëgjon ato fjalë. Ai vetëm e pyet:

— Po në shkollë, moj nonë?

Hallë Tixhja shkundet e gjitha aty kurre, sikur ta ketë zënë gjarpëri.

— Hiç të mos shkosh! As ti, as Meremja!... Teqja është teqe... Ju s'e dini, por keni për ta parë kur të hapet dheu e t'i përpijë njerzit të gjallë!

Dikur Sabai trëmbej, kurse tani besimet e

kota të nënës e bëjnë për të qeshur. Por e mban veten. I hedh një vështrim të shpejtë Meremes, që i ka zgurdulluar sytë e dëgjon si e trëmbur çfryrjet e mallkimet e hallës.

— Po si t'ja bëjmë atëhere?

— Të rrini në shtëpi.

— Po gjer kur?

— Gjersa të mbarojë kjo punë... Le që s'ka pér të mbaruar dot...

— Po si t'u themi në shkollë, moj hallë?

— pyet Meremja.

— T'u themi që s'na lënë në shtëpi? — vazhdon pyetjen Sabai me djallëzi.

Halla brof përpjetë nga inati.

— Qepe gojën murtajë! — i ciret të birit.

— Se, po e kapa mashën, t'i nxiva mishrat!...

Atë çast, nga dhoma lart, vjen zëri i Kumries që këndon. Halla ulërin:

— Plaç dhe ti!... Kumrie, moj!

Kumria e lë këngën përgjysmë.

— Na shurdhove gjithë ditën!... Ju ka plasur delli i ballit, nuk keni pikë turpi, as ti as ajo!...

Sido që të jetë, vendimi u muar. Meremja dhe Sabai nuk do të shkojnë në shkollë, do të bëhen të sëmurë, sa kohë që do të vazhdojë puna në park.

Kur u ngrit pér t'u larguar nga shtëpia e hallës, ishte errur. Sabai po milte dhinë. Në kopsht, deri te porta e jashtme, Meremen e përçolli Kumria. Kur po u afroheshin dy ullinjve, kjo e zuri pér krahu.

— Pash zotin, Mereme, — i tha dhe ftyra iu skuq, si t'i kish marrë flakë, — është atje?

Meremja mbajti këmbët.

— Si s'është? — iu përgjegj. — Maturan-tët e filluan këtë punë!...

— Ule zërin, — ja preu Kumria dhe ktheu kryet nga shtëpia.

— E ke parë ti?

— Si s'e kam parë!

— Ty të flas, — vazhdoi Kumria, — se të kam si motër të vogël... Vetëm, shtifsh nonën...

— Mos u bën budallaqe, — ja ktheu Meremja që e kuptoi se ç'kërkonte ajo me atë be.

Në gjysmëerrësirën e mbrëmjes, ftyra e hollë e Kumries, e skuqur nga turpi dhe zori, dukej e bukur. Sytë i shkëlqenin nga malli i dashurisë.

— Të ka thënë, — pyeti me zë të këputur, — të ka thënë gjë pér mua?

Meremja vuri buzën në gaz e u skuq edhe ajo. Uli sytë e ngriti supet. Kumria e kuptoi që tjetra nuk kish ç't'i përgjigjej.

Të nesërmen, Meremja u shti e sëmurë.

Në fillim, ndënji në shtrat, sikur donte të bindte veten që vërtet ishte sëmurë. Vetëm se, duke ndënjur shtrirë, mendimet e sulmonin pareshtur dhe s'e linin të qetë. Atëhere u ngrit. Nëna kishte vajtur në punë, në punishten e rrobaqepësisë. Në shtëpi kish mbeetur vetëm ajo me gjyshin: Le që edhe sikur të ishte nëna, ç'do t'i thoshte vallë? Nëna nuk ndihej në shtëpi. Ajo lidhte duart në pëqi dhe heshtëte. Që kur kish vdekur babai, ajo e kishte humbur. Në fillim, kur vëllanë e Meremes e kishin marrë ushtar, gjyshi nuk deshi ta lerë të dalë në punë. «Kemi ullinjtë, thoshte, dy dhi i kemi, rrush sa për rakinë e vitit kemi, të shtojmë pulat e nuk kemi keq për asgjë». Por e uli zërin, kur pa që ashtu nuk mund të vazhdohej më. Tani nëna kish pesë muaj që punonte dhe mbante shtëpinë. Është e vërtetë se ishte çelur ca, qe bërë më e hedhur, por prapë nuk guxonë të dilte përpara vjehrrit.

Meremja nisi të rregullojë shtëpinë. Fshiu, lau, por, megjithatë, mendimet nuk i lar-

goheshin. I kujtohej shkolla, mendonte shokët e shoqet në klasë. Atë ditë kishin dhe lexim, mësimi që i pëlqente më shumë. Duke sjellë ndër mend ftyrën e mësueses, iu kujtuan dhe fjalët e saj. E kishte zakon ajo, për çdo gjë të vjetruar, të thoshte «mesjetë e vogël». Kështu do të thoshte tani edhe për Mëremen. Dhe do të kishte të drejtë. Ashtu ishte ajo. E gjithë shtëpia e saj ashtu ishte. Edhe e Sabait. Një «mesjetë e vogël» me ca rrënjenj ullinj, me dy kokë dhi, dhe me ca pulë, me raki e me vajza të mbyllura, me hallë Tixhera dhe gjyshër që ulërijnë e të zënë frymën, me fëmijë që kanë frikë të jetojnë... .

Punët e shtëpisë u mbaruan, por vargu i mendimeve nuk kishte fund. Librave nuk iu afrua. U hidhte nga një vështrim vjedhurazi, me bisht të syrit, por nuk i prekte. I dukej se nuk kishte të drejtë t'i merrte në dorë, t'i shfletonte e t'i lexonte. Gjersa ish mbyllur ashtu në shtëpi, do të thoshte se nuk u kishte besuar librave, por përrallave të gjyshit e të hallë Tixhes. Nuk mjafton të marrësh nota të mira në mësimë, të përpinqesh për dhjeta e nënda, e rëndësishme është që mësimet të dish t'i bësh gjakun e zemrës sate. Ndryshe, çdo gjë është e kotë dhe shëmbet si një kështjellë prej

letre. Ç'kish bërë ajo me të vërtetë? Qe mbyllur në shtëpi para se ta mbyllnin të tjerët, qe mbyllur vetë, me duart e saj. Kumrien, së pakut, e kishin mbyllur. Dhe, duke mbyllur derën e shtëpisë, ajo Meremja, kish mbyllur edhe librat. Tani po e kuptonte dhe habitej se ç'lidhje paskësh pasur midis jetës së saj dhe parkut! Duke shëmbur vjetërsirat për të ngri-  
tur parkun, ajo do të shëmbte rrezikun që i kanosej rinisë së saj për t'u burgosur e zbehur midis katër mureve, ajo do të shëmbte «mes-  
jetën e vogël» të gjyshit dhe britmat e hallë Tixhes, shpirtndrojtjen e nënës dhe paragjy-  
kimet e krimbura që po i sëmurnin shpirtin...  
Duke punuar për parkun, përkundrazi, ajo do  
të fuste jetën e re në zemrën e saj, do të hapte  
dritaret dhe do ta linte diellin të hynte lirisht  
në shtëpi, do t'i zgjidhte duart e nënës të li-  
dhura në pëqi dhe do t'i bënte sytë e saj të  
qeshnin...

Librat ishin në çantë, në dhomën e zjarrit, të varura në mur. Ajo u vërsul drejt tyre si e uritur. I nxori, i hapi, shpërfleti disa, por nuk duroi dot më: në mes të këtij vrulli, u shkreh në vaj.

Kur perëndoi dielli, Meremja doli nga shtëpia, i ra shkurt, nëpër rrugica, dhe trokiti në portën e hallë Tixhes. Sabai nuk ishte në shtëpi.

— Ku ka shkuar? — e pyeti Meremja Kumrien.

— Në park, të punojë si gjithë shokët. Nëna është bërë tym e flakë, — u përgjegj ajo e zuri fytyrën me duar për të fshehur një buzëqeshje të djallëzuar.

Kur hynë në shtëpi, hallë Tixhja thirri nga dhoma e zjarrit:

— Kush është, Kumrie?

— Meremja, nonë.

— Thashë mos ishte ai lugati, se mu në kopsht, atje te fiku kam për t'ja ba varrin! .

Kumria i hodhi një vështrim të shpejtë Meremes, dhe asaj i mjaftoi kjo për të hetuar në sytë e kushërirës një gaz e kënaqësi, që i kishin dhënë fytyrës së saj të zbetë një shkëlqim të çuditshëm.

— Po ti, — e pyeti hallë Tixhja Mermen, kur kjo i erdhi përpara, — po ti nuk shkove?

— Jo, — u përgjegj Meremja.

— Ti bëfsh hajér! Të lumtë! — dhe hallë Tixhja zgjati krahët drejt saj. — Ti po, ma bëre qejfin, jo ai imi! Eja te halla! — Vajza uli kokën dhe halla e puthi në ballë.

Meremes iu duk sikur buzët e hallë Tixhes i dogjën lëkurën, sikur i lanë atje një shenjë të shëmtuar. Ngriti dorën dhe e fshiu.

— Kurse imi, — vazhdoi hallë Tixhja, — as pyeti fare, po u nis e iku të tërbojë!... Ishallah këputet ndonjë tjegull dhe ma lë në vend imansëzin!

— Mos mallko ashtu, nonë, — u hodh e tha Kumria.

— Mbylle gojën ti! Se dhe ti e ke fajin.

— E po ai djalë është! Vajzat e shkreta, po, i mbyllin dhe ua nxijnë ditët, por djemtë s'ka ndodhur ndonjëherë që t'i mbyllin... Veç në e bëfsh ti e para!

Hallë Tixhja kërciti dhëmbët dhe zgjati dorën drejt mashës, por Kumria, më e shpejtë, fryu nga dera.

— Kuçkë! — shau hallë Tixhja. — Kur do të vijë ai sahat, xhanëm, që të të bëj def nga shtëpia, të të heq qafe e mos të ta shoh më bojën?!

Kur u qetësua ca halla, Meremja e pyeti

me hollësi për Sabanë. Mësoi atëhere që ai, në mëngjez, si pérherë e pa pyetur për asnjeri, kishte vajtur në shkollë dhe, mbasdite, orën e caktuar, prapë pa pyetur për asnjeri, qe nisur për në park.

Meremja dëgjonte dhe i vinte turp nga vetja, kur mendonte që Sabai ja kish hedhur. Kjo donte të thoshte se në atë «mesjetë të vogël», nga të rinxjtë, vetëm ajo qe treguar frikaçë, sepse edhe Kumria kish nisur ta ngrinte zërin. Duke dëgjuar hallë Tixhen, ajo mendonte, nga ana tjeter, se asnje nga ato që kish patur frikë se do të ndodhnin, nuk po ndodhët. Hallë Tixhja do të ulërinte e do të çirej ca ditë, mbase do t'i jepte ndonjë flakurimë Sabant, mund ta mbyllte për ca orë edhe në nevojtore, do ta zinte për gërshtash edhe Kumrien, por pastaj çdo gjë kishte për të ndjekur rrugën e vet.

5

Natën nuk e zuri gjumi. Dëgjonte frymë-marrjen e nënës dhe mendohej. Një herë tha se do kish qenë mirë sikur nëna të zgjohet dhe ta shikonte të bijën që nuk flinte dot. Do

të merakosej, e gjora nënë, dhe do ta pyeste se ç'e mundonte ashtu. «Mos je sëmurë?», do t'i thoshte. «Jo, nuk jam sëmurë». «Përse nuk fle atëhere?» «Sepse kam një brengë të madhe në zemër!» Nëna do të ngrihej nga dysheku e do t'i shkonte pranë. Ajo e dinte se nuk mund të ish punë mësimesh, sepse e bija qe mësuar t'i sillte në shtëpi vetëm nota të mira. Kështu kish qenë që në klasë të parë fillore. «I thuaj nënës ç'ke?» Meremja atëhere do t'i rrëfehej. Nëna do t'i përkëdhelte flokët e do ta qetësonte. Po si do ta qetësonte? Gjatë tërë atyre ditëve, ajo nuk e kishte hapur gojën fare. E kish parë të bijën me një vështrim të mekur, e pa vullnet, me duart lidhur në pëqi, po nuk e kishte hapur gojën. Meremja zien e tëra: «Folë, nënë, folë! Mos më vështro ashtu. Thuaji gjyshit se bija jote e urren «mesjetën e vogël», atë mesjetë që të ka ndrydhur ty, të ka fishkur para kohe, të ka vjedhur fjalët, të ka vjedhur guximin e tani po të vjedh edhe bijën. Folë, nënë, folë!»

Por nëna flë.

Orët kalojnë.

Meremja më është fund vendos që të nesërmen të marrë çantën e të shkojë në shkolë, ndërsa pasdite, në park. Le ta rrahë gjyshi,

le ta vrasë po të dojë. Ajo nuk jeton dot pa shkollën, pa ecur përpara, krah për krah me shokët... Po të pranojë sot të heqë dorë nga shkolla e nga parku, nesër duhet të pranojë që të heqë dorë edhe ngajeta.

Megjithatë, të nesërmen në mëngjes nuk shkoi në shkollë. Në fillim tha se kish kohë; pastaj ora e parë filloi dhe ajo vendosi me vete që të shkonte orën e dytë... Por orët kalonin dhe ajo e kuptoi se po gënjenjete veten. E kaplloi një shqetësim e nervozizëm, sa që zunë t'i dridheshin gjymtyrët.

Mbathi këpucët. Bëri për të dalë. Do të shkonte te hallë Tixhja, të shikonte se ç'bëhej andej.

Porta e kopshtit u hap. Hyri gjyshi. Kish sjellë një peshk me vete.

- Ku shkon kështu? — e pyeti.
- Te hallë Tixhja.
- Shko pastaj, — ja preu. — Na, merr këtë peshk dhe pastroje.

Duke pastruar peshkun, Meremja mallkoi veten. I dukej sikur nuk vlente asgjë, posa që kish frikë të çfaqte haptazi mendimin e saj, posa që gënjenjete veten për t'i bërë bisht detyrës...

Macja, e ndjellur nga era e peshkut, erdhi

dhe iu përqall. Ajo e flaku tutje. I cukte ner-  
vat zëri i saj i zvarritur dhe si me të qarë,  
fërkimet e saj të buta dhe servile, që i kuj-  
tonin shpirtin brumë dhe vullnetin e sëmurë,  
të një skllaveje... Ajo kish nevojë për she-  
mbuj të tjerë, për zemra të forta, për vull-  
nete të çelikta, që nuk janë mësuar të lypin lë-  
moshë, por e rrëmbejnë me forcë atë që u  
përket...

E pastroi peshkun, e lau dhe e shpuri në  
dhomën e zjarrit.

Çanta ishte në mur.

Asaj i hipi gjaku në kokë.

Turret, rrëmben çantën dhe del në oborr.

Nga brenda, zëri i gjyshit gjëmoi:

— Ku do të shkosh, te halla?

— Jo, — përgjigjet qetë-qetë e mbesa, —  
në shkollë!

Kur doli gjyshi në oborr, ashtu në çorape,  
siç rrinte në minder, Meremja ishte në portën  
e jashtme.

— Mereme! — thirri ai. — Mereme!

— Ç'do, gjysh?

— Kthehu!

— Përse të kthehem?

— Kthehu, të them!

— Mjaft ndënja këtu, — tha vajza dhe

fytyra iu skuq nga inati, — mjaft ndënja mbyllur këtu! Është turp!

— Atë e di unë! Unë nuk të lë të bësh si Sabai.

— Unë do të bëj si bëjnë të gjitha shqet. Rrihmë, më vdis në dru, po deshe: unë nuk rri dot pa shkollë.

Plaku e pa që me të egër nuk do të nxirrte gjë mbanë, ndaj e ktheu ndryshe:

— Mirë, — i tha, — në shkollë shko. Por atje, t'i kemi fjalët të prera: nuk do të vësh këmbë!

«Atje» ishte parku.

— Dëgjon ç'të them?

Vajza ja nguli sytë në heshtje një copë herë.

Kur u kthyte nga shkolla, gjyshi nuk i foli me gojë. E shikonte shtrembër, në heshtje. Meremja, e forcuar në zemër nga fitorja e parë që kish korrur në mëngjes, ish e vendosur të sulmonte më tutje... Dhe ishte e sigurtë se edhe këtë radhë do të triumfonte...

Pasdite trokiti porta e jashtme, Gjyshi ishte në kopsht duke prashitur qepët. Shkoi ai vetë për ta hapur.

Duke përshëndetur tërë gaz, në oborr

hynë, njeri pas tjetrit, plot tridhjetë djem e vajza, shokë e shoqe të Meremes.

— Kemi ardhur të marrim Meremen, gjysh.

Plaku e kuptoi si qe puna, por për një çast e humbi.

Pastaj deshi t'i gënjejë e t'u thotë se Meremja ishte sëmurë, kur, atë çast, e mbesa doli duke qeshur nga shtëpia.

— Po ikim, gjysh!

Gjyshi deshi t'i thotë mbesës që të shkëputej nga shoqet, por kopshti qe mbushur plot dhe djemtë e vajzat ishin tërë gjallëri e s'të linin radhë të flisje; i vinin rrötull plakut dhe e trullosojn fare me ato që i thoshin.

— Për Meremen mos u bën merak, gjysh! Do të punojmë bashkë, — i tha një vajzë syzezë, me dy quka në faqe.

— Mirë u pafshim, gjyshi i Meremes!

— Nesër do të vimë prapë!

— Mirë u pafshim, gjyshi i Meremes!


Dhe me gjallëri e zhurmë, ashtu siç kishin ardhur, ashtu edhe u larguan.

Meremja fluturonte nga gëzimi.

## K O N K U R S I

**S**alla e vogël e kinemasë së Fushë-Krujës ka gjetur belanë: nuk ka ku t'i fusë tërë këta spektatorë të vegjël. E jo vetëm të vegjël. Nga Kruja ne kemi ardhur plot dy kamiona, përveç autobuzit, ndërsa nga dymbëdhjetëvjeçarja e Fushë-Krujës kanë ardhur qindra nxënës... Të ishte ndonjë karikaturist, do ta kishte lehtë për të paraqitur hallin e kinemasë së vogël: do të vizatonte një ndërtesë përdhese, nga ato që fshatrave përdoren si salla leximi a vatra kulture, të mbushur plot e përplot me njerëz, aq sa muret i janë fryrë e zgjeruar, sikur të ishin prej llastiku, ndërsa në çati, tjegullat kanë lëvizur e, në disa vende, janë flakur tutje nga çfryrja e brohoritjeve që shpërthejnë nga qindra gjokse spektatorësh... Domosdo, kjo është karikaturë dhe, si në çdo karikaturë, ka hiperbolizim. Megjithatë, për ç'i përket kinemasë së vogël, hiperbola nuk është shumë larg së vërtetës...

Brenda në sallë, përballe njera tjetrës, janë skuadrat e shkollave të Krujës e të Fushë-



Krujës. Luftojnë për të dalë në finale. Po zhvillohet një nga ndeshjet e konkursit të gjëzave letrare, ku janë përfshirë të gjitha shkollat e rrethit në fshatra apo qytete qofshin. Këto ndeshje ka muaj që kanë nisur. Në grupin e parë ka dalë në finale skuadra e fortë e Laçit, e cila ka një luftëtar kampion, mjeshëtër të përgjigjeve të shpejta. Me këtë skuadër do të ndeshet ajo që do të fitojë sot këtu, në këtë kinema të vogël.

— Katër pikë për Fushë-Krujën, dy për Krujën! — thotë drejtonjësi i ndeshjes duke i hapur krahët anash.

Fushëkrujasit në sallë s'përbahen dot. Krutanët bëjnë sikur as dëgjojnë, as shikojnë. gjë... .

— Pyetje e përbashkët. Vlen katër pikë.

Në sallë bie qetësia. Skuadrat mbajnë shënim pyetjen. Edhe në sallë, disa nga spektatorët po këtë punë bëjnë. Anëtarët e zhurisë, që janë katër veta, të ulur në një tryezë përkundrejt sallës, midis dy skuadrave, mundohen t'i japid ftyrrës një shprehje indiferente, neutrale; megjithatë, me bisht të syrit i hedhin vështrime skuadrës së tyre... .

Në skuadrën e Krujës ka gjallëri. Njeri nga anëtarët, Agimi, ka gjetur përgjigjen e

drejtë. Kokë më kokë me shokët, ai ua thotë atyre me zë të ulët. Para se të mbarojnë sekondat e afatit, Kruja dorëzon e para.

Një duartrokitje shpërthen në sallë. Janë krutanët që po hakmerren. Zhuria kërkon qetësi. Agimi lexon përgjigjen. Duhej gjetur titulli i një poezie, prej nga ish shkëputur një varg i vetëm. Ai e lexon me zë të lartë.

— Përgjigje e saktë, — thërret drejtongjësi.

Salla gjëmon përsëri. Tani janë krutanët që s'përbahen dot. Duartrokitje. Brohoritje. «Kru-ja! Kru-ja!»

— Gjendja e pikave: gjashtë për Krujën, katër për Fushë-Krujën!

Agimi kthehet në vend. Megjithatë, duartrokitjet vazhdojnë. «Jepi, Agim!» — thërret dikush. «Shpartalloji, Agim!» — ja bën një tjetër. «Çap mos i lerë të bëjnë!» Të duket nganjëherë sikur je në futboll.

Agimi është i imët në shtat, me një qafë të hollë, kokë të madhe dhe me një palë sy të rrumbullakët. Kuptohet qartë se forca e tij nuk qëndron as në shtat e as në muskuj, por gjetkë. Dhe shokët e dinë, sepse janë të rrallë ata që kanë lexuar më shumë libra dhe dinë të recitojnë me ndjenjë si Agim Deta.

Megjithatë, dy muaj më parë, e kishin përjashtuar nga skuadra. Atëhere u tmeruan të gjithë. Të largoje Agimin, donte të thoshte t'i hiqje skuadrës zemrën, ose, siç thoshin disa, qëndërsulmonjësin. Por rregullat janë rregulla. Vërtet Agimi ishte i shkëlqyeshëm në gjuhë e lexim, por, këtu e dy muaj më parë, kishte rënë në dy lëndë: në gjeometri dhe kimi. E një nxënës i tillë, nuk mund të merrte pjesë në aktivitete dhe, ca më pak, të përfaqqësonte shkollën.

Ato ditë kishin qenë me të vërtetë të vështira për të. Gjer atëhere i kish ndarë lëndët, sipas kokës së tij, në ato që «i vlenin» dhe në të tilla që «s'i vlenin» talentit të tij poetik... Por ajo që i kish ndodhur në konkurs i kish hapur sytë e i kish dhënë të kuptojë se, pa shkencën, nuk do të bënte dot përpara as edhe talenti i tij poetik! «Dhe vërtet, — u thoshte tani të tjerëve, — ç'poet është ai, si mund të thotë se kuption kohën, njezit e shekullit XX dhe është shprehës i botës së tyre shpirtërore, kur për vete është injorant në punë të shkencës, kur, mbështetës, ka frikë e nuk di të rregullojë as sigurecat e dritës në shtëpi?» Këtë gjë, domosdo, e kuptoai tani. Dhe iu desh të djersijë boll. Më parë gdhihej duke lexuar

roman pas romani, poet pas poeti, kurse tani nisi të gdhihet duke studjuar mësimet e gjeometrisë e të kimisë që i kishte kapërcyer, duke zhvilluar problema dhe ushtrime.

— Gjashtë për Krujën, gjashtë për Fushë-Krujën!

Salla buçiti përsëri. Të pesë anëtarëve të skuadrës së Fushë-Krujës u qeshi fytyra. Kanë të drejtë dhe, duke e parë punën me asnjanësi, duhet të them se edhe ata meritojnë të fitojnë. Janë të shkathët, të dhënë me mish e me shpirt pas lojës. Për njerën prej tyre, bile, për atë leshverdhën e vogël, me tuta e përparëse të zezë, që e quajnë Jolanda, thonë se është ngritur nga shtrati për të mos munguar në ndeshje.

Tani ka ardhur koha e recitimeve.

Recitimet e nxënësve nganjëherë janë të cuditshme. Ka një palë asish, e janë më të shumtët, që ulërijnë, sepse, sipas tyre, reciton mirë ai që ka gabzherrin më të fortë. Me një poezi dy strofash, këta janë në gjendje të ngrejnjë në këmbë një mëhallë... Në fytyrë skuqen, në fyt u dalin damarët, kakërdhokët e syve rrezik t'u pëlcasin, ndërsa duart venë e vinë poshtë e lart, sikur po bëjnë gjimnastikë... Një palë tjetër i jep çdo poezie një

melodi elegjiake, shpirtkëputëse, e atëhere të duket sikur vargjet lotojnë dhe krejt poezia nuk është veçse një sfungar i qullur që nxënësi e shkon në fytyrë të të tjerëve për t'i bërë me zor të qajnë... Ka një palë tjetër që nis me zë të ulët, sa të duket sikur po flasin me vete, pastaj, befas, kot fare, shpërthejnë në një ulërimë rrëqethëse që, sidomos po të vuash pak edhe nga zemra të le në vend, sikur të të kenë qëlluar me plumb në lule të ballit... Më në furd, ka një palë që e thotë vjershën me një zë të shplarë, pa jetë, pa ngjyrë, me përtesë, sikur po lexon një listë të gjatë gjellësh pa shije... Si rregull, të gjithë këta, nuk kuptojnë ato që thonë. Por në kinemanë e Fushë-Krujës nuk ndodhi kështu.

Recitimin, për Fushë-Krujën, e nisi Jolanda. Poezia e saj fliste për një partizane të vogël, që vritet duke luftuar kundër armiqëve. Shokët e quanin «Ofeli» dhe e donin shumë... Zëri i Jolandës, i qetë, i ëmbël, nis të rrëfejë për partizanen e vogël me krenari e dhëmbje. Kur e dëgjon, të duket sikur ajo nuk po reciton, por po rrëfen një ngjarje të jetuar, sikur nuk po e thotë poezinë, por po e krijon vetë, aty për aty... Spektatorët mbajnë frymën. Në mendje të tyre kalon partizania

trupimët e leshverdhë; e dëgjojnë zërin e saj tek këndon; e shikojnë tek arnon rrabet e shokëve, e vërejnë tek ecën zbathur, me këmbët e bardha në baltë, në mes të shiut, duke sulmuar armikun; e shikojnë sypërlotur, të vrarë, me plagët e kuqe në krahëror... Kur mbaron poezia, të gjithëve u duket se Ofelia trime dhe e paharruar, ka qenë aty ato çaste, në atë sallë të vogël të Fushë-Krujës, dhe ua ka mbushur zemrën plot dritë...

Për Krujën doli Agimi. Zbret nga malet e reciton për to. «Përse mendohen këto male?», pyet poema dhe ai e hedh këtë varg midis spektatorëve si pjesë të një enigme, të cilën merr përsipër ta zgjidhë aty, para tyre. Zbret nga malet dhe vjen t'u spiegojë njerëzve të fushës se ç'janë kreshtat e skërkat, shpatet e brinjët, majat me re dhe pyjet legjendare, ç'duan të thonë ato me urtësinë tyre, përse janë kreñare dhe të pamposhtura, përse malësorët me tirqe të bardha e xhoke të zeza nuk e kanë hequr pushkën kurrë nga dora... Shoh sytë e mëdhenj të Agimit që shkrepëtijnë nga zjarri, shoh krahërorin e tij të pakët që shqetësohet si det me shkumë, shoh krahërorin e tij që dridhet i téri nga vrulli i ndjenjave dhe më ngjan sikur ai vetë është mishërimi i asaj po-

eme, i asaj që duan të thonë ato vargje, i asaj që ato vargje nuk e thonë dot, por zemrat tonë, të mpleksura midis tingujve e figurave, e ndjejnë thellë... Dridhet Agimi, dri-dhemë edhe ne e brofim në këmbë kur ai mbaron!

Salla e kinemasë është shumë e yogël për brohoritjet që shpërthejnë atje brenda. Drejtonjësi ngre duart. Kërkon qetësi. Zhuria ka dhënë vendimin.

— Recitimet kanë qenë të mrekullueshme, — thotë drejtonjësi, disi i mallëngjyer.

— Pika të barabarta! Dhjetë Fushë-Kruja, dhjetë Kruja!

Ndeshja qe mbërthyer në barazim dhe ky ekuilibër nuk donte të prishej. Spektatorët u nxehën. U hidhnin vështrime qortonjëse skuadrave të tyre. Disa u bënин shënja edhe me duar, por se ç'donin t'u thoshin, askush nuk e merrte vesh. Të tjerë nisën të dyshojnë për hilera, se mos vallë u pëshpériste njeri përgjigjet. Domosdo, dyshime të kota, sepse zhuria s'është kot atje, i ka çapëlyer sytë dhe s'lë t'i shpëtojë as miza...

Nis kështu pjesa e dytë e ndeshjes, pjesa më elektrizonjëse. Skuadrat do t'i drejtojnë pyetje njera tjetrës duke rrëmbyer apo humbur pikë.

Sulmon e para Fushë-Kruja. Duan të dinë — shiko ku u vete mendja! — se sa vjeç ishte Çajupi kur i vdiq i biri!

Në skuadrën krutane jepet alarmi. Mbli-dhen kokë më kokë. Japin e marrin me gishta. Koha kalon. Nga inati, djersiten.

— Nuk e dimë, — përgjigjet më në fund Agimi.

Fushëkrujasit, në sallë, hidhen përpjetë. Por ky gjëzim është i shkurtër; sepse edhe pyetjes së krutanëve, kundërshtarët nuk i përgjigjen dot. Gjendja kthehet përsëri në barazim. Edhe dy pyetje për skuadër kanë mbetur, ndaj fitorja do të caktohet nga ato.

Sulmon Fushë-Kruja. Këtë radhë ka marrë një varg e kërkon të gjendet titulli i poe-zisë dhe domethënia e saj.

Pa mbaruar mirë pyetja, Pullumbi, në skuadrën krutane, ngre dorën. «Ndal!» — e qortojnë shokët dhe s'e lenë të përgjigjet menjëherë. Ai u thotë shokëve përgjigjen. Agimi ngre supet. Të tjerët heshtin. Por Pullumbi është i sigurtë dhe s'e ndalon dot njeri. Bën një hap përpara dhe shkrep me zë të lartë përgjigjen.

Pullumbin e kam në klasë. Sa herë që më

del pérpara, më kujtohet ditari tij. Është i çuditshëm në të. Ish një kohë kur, sa herë ngrija nxënës pér të lexuar ditarin, do të dëgjoja historira të trilluara pér ndihmën që ata u kishin dhënë një ditë më parë njerëzve të pafuqishëm, veçan pleqve dhe plakave. Kështu, ditarët erdhën e u mbushën me xhaxho e me xhaxhesha, të cilëve ua merrte era kapelen apo u binte shkopi nga dora dhe nxënësit e mi, engjëj të vërtetë, rendnin turraprap t'i ndihmonin... Këtë kish shkruar edhe Pullumbi një ditë. Unë nuk durova më. I thashë, por fola edhe pér të tjerët, që në shkrime, ditar, hartim apo çfardo send tjetër qoftë, duhet të ishin të sinqertë, të flisnin kurdoherë me zëmër në dorë... .

Që prej asaj dite, Pullumbi shquan në ditare, di t'i zgjedhë ngjarjet, t'i tregojë me bukuri të madhe e, në mënyrë të veçantë, me shumë humor. Sipas mendimit tim, nuk do të kalojë shumë dhe ju do t'i lexoni shkrimet e tij në «Hosteni». Nuk më harrohet, pér shembull, se ç'kish shkruar një ditë, sa që, ende sot, më vjen pér të qeshur. Shkruante pak a shumë kështu:

«Dje isha sëmurë, ndaj nuk erdha në shkollë. Mbeta vetëm me gjyshen dhe me

vëllanë e vogël, Kikun, që s'i ka mbushur as gjashtë muajt, por që mua më njeh e më do fort. Isha shtrirë e po dremitja, kur ai nisi të qajë. Me vrap erdhi gjyshja. U përkul mbi djep për ta qetësuar. I dha shishen me qumësht. Ai s'e qasi. Vazhdonte të qante dhe, me gojën hapur si çorape, ulërinte sa tundej shtëpia!

— Qyqja, — tha gjyshja, — ç'ka çuni kështu??

E mori në duar, por ai hiç. E ktheu përmbyss, i ra në banike, por ai më keq!

— Qyqja, — tha prapë gjyshja dhe vajti mori një llokume e ja vuri në gojë. Por kot. Kiku ulërinte sa që të shurdhonte. Ku e kishte gjithë atë zë, xhanëm!

Gjyshja e mori dhe e nxori jashtë në kopsht. Ai më keq!

— Ç'ka çuni? — nxori kokën majë muri komshia.

Erdhi dhe ajo. Ishte më plakë se gjyshja dhe dinte marifete të tjera. I futi në gojë gishtin e saj të shtrembër, por ai tundi kokën dhe e largoi gojën.

— Qyqja! Qyqja!

— Të thërrasim hallë Tixhen! Asaj i vjen doresh për fëmijtë e lehonat!

Erdhi hallë Tixhja e, bashkë me të, edhe dy plaka të tjera që u ndodhën në rrugë. Erdhën, e panë Kikun, e dëgjuan me vëmendje ulërimën e tij dhe, më në fund, hallë Tixhja tha:

— E kanë marrë sysh!

Shpejt, morën një gotë, e mbushën me ujë dhe hodhën brenda një thëngjill të ndezur. Ndërsa thëngjilli shuhej në gotë, ato plaka, me çagune të kthyera si majë opinge, u mblodhën kokë më kokë mbi djepin e Kikut. Pritën një copë herë kështu, por kot! Njera prej tyre, s'e pashë mirë se cila, tha:

— Magji!.. Për Shëmemilin, magji!..

Të tmeruara, plakat u larguan në çast nga djepi, sikur Kiku të ishte ndonjë minë e rrezikëshme, që mund të shpërthente.

— Ta çojmë te hoxhë Brahimi!

Gjyshja e rrëmbeu Kikun në duar.

Ajo para, ato plakat pas, doli jashtë, por, sapo arriti në portën e kopshtit, hyri nëna. Ishte larguar nga puna e kish ardhur, si zakonisht, t'i jepte gji Kikut. Kur pa fëmijën që qante dhe ato plaka qark, u llahtaros.

Gjyshja, me lot në sy, i tha se si kishin nisur ulërimat. Pastaj, duke u hëngur se kush

të fliste më parë, ato plakat i folën për sy  
të keq, për magji, për hoxhë Brahimin, për  
nuska, për thëngjill në ujë, për krypë në  
zjarr, pér... .

Befas, Kiku pushoi.

Nëna e kishte zgjidhur nga pelenat dhe  
tani ato plaka po e shikonin qartë shkakun e  
ulërimave të tij... Kiku qe fëlliçur!»

— Përgjigje e saktë! — thirri drejt-  
njësi.

Pullumbi kish patur të drejtë. Kruja fi-  
toi dy pikë.

Në sallë, krutanët duartrokitën, por të  
matur, sepse nuk donin të mbeteshin me gisht  
në gojë një minutë më pas... Por një minutë  
më pas u duk qartë se nga anonte fitorja.  
Përpara pyetjes së Krujës, kundërshtarët  
mbeten të heshtur.

— Kruja katërmbydhjetë, Fushë-Kruja  
gjashtë!

— Forca Kruja! — thirri dikush.

Salla gjëmoi: «Kruja! Kruja... »

U desh të ngrihej zhuria në këmbë që  
të vendosej qetësia e të vazhdonte ndeshja.  
Por tashmë loja kishte humbur çdo të pa-  
pritur.

Kur zhuria shpalli fitonjëse skuadrën e Krujës, krutanët në sallë nuk dinin ç'të bënin.

E mjera kinema e vogël e Fushë-Krujës se ç'hoqi!

Ndeshja tjetër do të zhvillohet në Laç.  
Kush do të fitojë vallë?

## SHKOLLA E NATEŚ

### I

Unë e dija, im atë ishte i mirë, por ai tmerohej nga thashethemet. Ato e mundonin, s'e linin të qetë, e shtynin të kontrollonte orelçast ato që bënte vetë dhe ato që bënин njerëzit e shtëpisë së tij... Kështu ishte rritur ai. Edhe nëna. Ajo, bile, ishte më keq. Po të dëgjoje atë, njeriu ishte skllav i këtyre thashethemeve e kudo që të shkonte ato s'i ndaheshin, i shkonin si hije nga pas. Në qytetin tonë të vogël, në jetën tonë krahinore dikur të mbyllur, këto thashetheme zinin vendin e moralit... Tani kanë ndryshuar shumë gjëra e shumë të tjera po ndryshojnë. Koha e bëri të sajën. Megjithatë, thashethemet sorianllaten ende sot si shaka të zgjebosura rru-gicave të shtërëmbëra e të errta...

Kjo që ju rrëfej, ka të bëjë me jetën tonë. Ka ndodhur këtu e disa vjet më parë. Nuk është ndonjë heroizëm, përkundrazi, kështu



si unë do të kish vepruar cilado vajzë. Bile mjaft të tjera janë treguar shumë më të shkathta, shumë më trimëresha. Sepse para-gjykimet, kudo që të çfaqen, duhen shkulur ngajeta jonë, ashtu si shkulen e flaken tutje dhëmballët e krimbura...

## II

**N**ë punishte, maqinat e qepjes bëjnë zhurmë të madhe. Kur, në mes të kësaj potreje, shikon të shpërndara kudo, mbi dyshemë, mbi tryeza të punës, mbi stola e karrige, në dollape e mbi dollape copat e stofave ngjyra-ngjyra, mund të mendosh se atje brenda nuk ka kurrfarë rregulli e se çdo gjë është lesheli. Vetëm se nuk është aspak ashtu. Po të rrish një copë herë, bindesh se në tërë këtë «rrëmujë» ka një rregull të rreptë dhe secila punëtore kryen punën që i përket.

Kështu dhe Maja.

Ajo ka dy vjet që punon këtu. Që kur mbaroi shtatëvjeçaren. Hyri si nxënëse, kurse tani i kanë dhënë gërshëren. Ajo mat çdo gjë me metrin që e mban varur në qafë, e pastaj i fut gërshëren. Punon dhe nuk ndihet. Bisedon shumë pak me shoqet, ndërmjet të cilave ka nga ato që s'reshtin gjithë ditën. Po të mos e njohësh mirë, kur

e sheh ashtu të heshtur, të mbyllur, mund të duket e ftohtë, disi krenare, po s'është e vërtetë.

Maqinat qepëse të shurdhojnë. Ajo e Rukies ka një zë të trashë që i mbulon të gjitha; kurse ajo e Lavdies kërcet me një zë të hollë e të duket sikur është ndonjë dhelpër e ndjekur që kërkon të shpëtojë; maqina e Fatimesë është thuajse e heshtur: zëri i saj, kur gjithë të tjerat mbeten, spikat me një krëkëllimë të lodhur... Maja i njeh këto zhurma. I dëgjon tek pret këmishët dhe i duket sikur shoqet në maqinë po i thonë diçka...

Tefta po bëhet gati të largohet. Është vërsnike me Majën. Dikur kanë qenë në një klasë. Tani ajo vazhdon shkollën e natës, ndaj del më parë nga puna.

— Si lum ti, Teftë, — i thotë Maja.

Tefta ka një palë sy të zinj që i shkëlqejnë përherë. Është e mbushur në trup dhe e qeshur në fytyrë.

— Përse nuk vjen dhe ti, Maja?

— E si të bëj?

— Ashtu si bëjnë të gjithë njerëzit.

Maja tund kokën. Gërs hetat i rrahin supet.

— E ke lehtë ti, — ja kthen shoqes, — se ke vëllanë në shtëpi. Kurse unë...

— Ç'hyn në punë vëllai këtu? Femra duhet të ketë besim në forcat e saj dhe respekt për veten, — thotë Tefta. Sytë i shkëlqejnë edhe më shumë nga kënaqësia që i kish ardhur rasti t'i përdorte këto fjalë të dëgjuara në një mbledhje. — Të isha unë në vendin tënd, nuk do të matesha kaq shumë...

Maja dëgjon dhe hesht.

### III

**M**ë duken ndryshe. Krejt ndryshe. I shikoj dhe them me vete: «Është e mundur, valillë, që prindët e mi të kenë mbetur të tillë, kur çdo gjë rrëth e qark po këmbehet përditë e më shumë?» Janë vrëjtur në fytyrë që të dy. Nëna është bërë nevrike...

Motra e madhe ka lindur vajzë. Është vajza e tretë e kjo u ngjan atyre si një fatkeqësi e pashembullt. «Tri vajza!» thotë nëna. «Tri plagë!»

Babai hesht. Vetëm hesht. Ai i do të vegjëlit, djem a vajza qofshin. Ai vetë nuk ka patur veçse vajza. Ne jemi tri motra. Unë jam më e vogla. Por ai na ka dashur të gjithave. Kur ishim të vogla, kishte qejf të na vishte të trijave njëlloj. Ne i hidheshim qark.

Këndonim e brohoritnim dhe e ndjenim veten të lumtura kur dora e tij na përkëdhelte... Nganjëherë më duket se fatkeqësia ime nisi kur u rrita dhe atëhere më mbushen sytë me lot... Por nuk dua të mendoj kështu. Bëj gabim të mendoj kështu. Tefta do të më quante frikaçë po ta dinte se ç'mendime të sëmura më vinë në kokë...

«Tri vajza — tri plagë!»

Jo, nuk ke të drejtë, nënë! Si është e mundur që ti, grua vetë, të flasësh kaq rëndë për mbesat e tua, për vajzat e tua, për veten tënde?...

#### IV

**N**ë shtëpi nuk e di asnje. Këtë fshehtësi, Maja e Tefta e ruajnë me fanatizëm edhe nga shoqet e punës. Kjo i ka lidhur më shumë. Vetëm përgjegjësja e di, që i ka rregulluar turnet në mënyrë të tillë, që Maja të shkojë në shkollë tri herë në javë e kjo të mos bjerë në sy të prindëve të saj.

— Sonte do të më pyesi mua, — thotë Maja.

— Mos u trëmb.

— Nuk trëmbem, por, prapë, s'e kam

të lehtë. Kam dy vjet pa vajtur në shkollë.

— Tani u bëre e vjetër. Ke tri javë që vete rregullisht.

— Tri javë!... Sa shpejt kaluan! Nganjëherë kam frikë se mos e marrin vesh në shtëpi... Kur kthehem, e vërej me kujdes fytyrën e nënës dhe të babait. Kur e kuptoj që ende s'dinë gjë, rri e qetë. Megjithatë, kësh-  
tu nuk kalohet.

— Thuajua atëhere. Ti nuk po bën ndonjë turp.

— Ke të drejtë ti, por nuk u druhem edhe aq britmave dhe qortimeve se sa rrezikut mos më pengojnë, sepse atëhere merr fund çdo gjë...

Tefta nxehet.

— Si flet kështu? — i thotë. — Ti, sido që të ndodhë, duhet të ngulësh këmbë...

Maja e dëgjon një çast në heshtje. Fjalët e Teftës ia forcojnë zemrën dhe atëhere e merr veten.

— Më jep librat, — i thotë shoqes.

Tefta i jep librat. Maja nuk i çon librat në shtëpi. Ato ja mban shoqja. Kjo, domosdo, ja bën të vështirë preqatitjen, por rrugë tjetër nuk ka.

## V

**U**bë një muaj që vazhdoj në shkollën e natës. Tefta është dy klasë më lart nga urë, por në klasën time kam zënë plot shokë e shoqë të tjera. Kur kthehem në shtëpi, vërtet librat i le te Tefta, por me vete marr të rejat që kam mësuar, mësimet e dëgjuara...

Megjithatë, shpesh më kapillon trishtimi. Vërtet nuk është turp ajo që po bëj, përkundrazi, por vetëm fshehtësia me të cilën de-tyrohem ta mbroj këtë që bëj, më rëndon në zemër dhe më këput fillin e gjëzimit. Të bësh diçka, qoftë dhe të mirë e të ndershme, fshehurazi nga prindët, më duket shumë e rëndë... Nganjëherë, sidomos pasi kam biseduar me Teftën, vendos që t'u flas haptazi e të mbroj me mish e me shpirt të drejtën time. Por pastaj tërhiqem: frika se mos ata gjejnë mënyrën për të më penguar, më tmeron.

## VI

**N**ë klub ajri është i rëndë. Tymi i duhanit qëndron pezull mbi kokët e klientëve. Sot ka shumë lëvizje. Është ditë pazari. Por, sido që të jetë, tryeza ndanë dritares, është kur-

doherë e zënë nga po ata pleq. Vinë në mën-gjez herët, ikin në drekë; kthehen mbasdite është, kur erret, largohen. Dhe janë të përpikët, si fëmijtë në shkollë.

I ati i Majës është ulur me ta. Shpesh, mbas-diteve, kur s'ka punë, ai vjen e bën mu-habet me pleqtë. Dhe biseda e tyre është e çudi-tëshme. Nganjëherë të duket se mbi atë try-ezë, ata sjellin e përsjellin tërë kujtimet e tyre të largëta, renditin njerëz të gjallë e të vdekur dhe nisin t'i përshkruajnë; herë tje-tër ringjallin luftra e beteja në të cilat kanë marrë vetë pjesë; shtrojnë pjata dhe enë me gjellë e embëlsira të ndryshme e nisin t'i përshkruajnë se si gatuhen; pas gjellëve, domosdo, flasin për dhëmbjet që kanë në stomak... Jo rrallë, fjala bie edhe për të rinjtë: ankohen që s'u ngjajnë pikë për pikë atyre, pleqve, dhe që shumë zakone të vjetra i kanë lënë... Megjithatë, xha Ceni nuk lë njeri të flasë keq për të rinjtë: ai është shërbyes në shkollë dhe u mplak me djem e vajza rreth e rrötull.

Të jatit të Majës i pëlqen ta dëgjojë xha Cenin. Kur flet, plakut i skuqen faqet dhe atëhere duket më i ri. Mbahet i veshur pastër. I ka hequr benevrekët dhe ka vënë pantar-

llona e xhaketë kadifeje, por qeleshen e bardhë s'e ka hequr nga koka.

Biseda rrrokulliset mbi syprinën e tryezës midis pleqve, sa më një anë sa në anën tjetër.

— Djemtë, po, — thotë xha Mustafai, një plak mbi të tetëdhjetat, me një palë mustaqe të bardha që i varen si copa rrecka nën hundën e madhe. — Djemtë, po, pa gocave s'ka ç'u duhet shkolla e tepërt!

Xha Ceni hidhet e kundërshton. Faqet i skuqen. I thotë tjetrit se si goca, si djali, një janë sot. Xha Mustafai kërvesh buzët. Po t'i japë të drejtë xha Cenit, duhet të mohojë tërë jetën e tij, e këtë s'e bën dot. Xha Ceni vazhdon t'u spiegojë shokëve se si sot, të rinjtë, s'bëjnë dot pa shkollën.

— Ja, — thotë ai, — edhe Maja e Xhepit shkon në shkollë, megjithëse gjithë ditën lodhet në punë. Apo jo Xhep?

I ati i Majës zverdhet, i thahet pështyma dhe ka përshtypjen se po i merren mentë. I duket sikur tymi i duhanit, që rri pezull nën tavan, befas ka hyrë në trutë e tij e nuk e lë të mendohet. Pleqtë kthejnë kokën për ta vërejtur.

— Ashtu është, — përgjigjet duke e përmbarjtar veten me mund në sytë e të tjerëve.  
— Vetë e kam dërguar...

## VII.

**E**ndjej veten të dërmuar. Tefta thotë se jam dobësuar, fytyra më është zverdhur. Kam të drejtë. U lodha. Nuk duroj dot më. Nuk di nga t'ja mbaj. Im atë ka dy ditë që s'më flet me gojë. U kthyesh parmbërëmë dhe ra fjeti pa vënë kafshatë në gojë. M'u drodh zemra dhe në çast m'u duk sikur një zë më tha se ai dinte gjithshka... Prita, të nesërmen që të më thoshte diçka, të më qortonte, të më godiste... Së paku kështu do të kishte një spiegim ankthi që më shtyp në krahëror... Por ai hesht, më hedh kalimthi një vështrim të ftohtë dhe hesht... Ç'fsheh vallë ajo heshtje e tij e akullt?

Nëna nuk di gjë. Për këtë jam e sigurtë. Edhe asaj i ka rënë në sy fytyra e brengosur dhe heshtja e babait, por ajo i spiegon të gjitha ndryshe, thotë se ai është sëmurë. Po mua ma ndjen zemra që nuk është ashtu... Sido që të jetë, unë jam e vendosur... Kush mbron një të drejtë, nuk duhet të ketë frikë nga përbuzja e hidhur dheurrejtja e ftohtë edhe e njerëzve të tij më të shtrenjtë.

## VIII.

C'kérkon hallë Tixhja këtu?

— Si ç'kérkon?

— Po e gjej shpesh e më shpesh në shtëpi time! Të kam thënë: atë plakë nuk e shoh dot me sy!..

— Sa i çuditshëm bëhesh dhe ti... .

— Vëru vesh fjalëve që them. Me hallë Tixhen mos më përzje! — dhe i ati i Majës përplas në tryezë grushtin. S'e ka bërë kurrë një gjë të tillë. Në shtëpi i janë bindur të gjithë, pa qenë nevoja që të ngrejë zërin, ndaj e shoqja e humbet për një çast. Ai çiret: — E dëgjon ç'të them?

— Që nesër, — ngutet të përgjigjet gruaja, — që nesër do t'i them të mos vijë më!

— As këmbët në prak mos më verë!

Për një copëherë, në dhomë bëhet një heshtje e rëndë. Mbi oxhak dëgjohet tik-taku monoton i orës së vjetër. I ati i Majës ulet në minder. E shoqja vjen rrrotull, kot, nëpër dhomë.

— Majën e martoj vetë, — thotë më në fund burri. — S'kam nevojë për... për... — deshi të thotë një fjalë të ndyrë për hallë Tixhen, po, me sa duket, nuk e gjeti dot atë që kërkonte, ndaj e këputi fjalën në mes.

Gruaja gjuajti rastin:

— Mirë, — tha, — si të duash bëj. Po mos harro se u rrit... dhe me ato që po na shohin sytë...

— Pse, ç'po të shohin sytë ty?

E shoqja vuri duart në ijë dhe, duke tundur kokën:

— Ato që po na shohin sytë, — ja ktheu, — larg nga ne qofshin! Se të ka në dorë sot fëmija e ta bën turpin mu në prak...

— Hallë Tixhja t'i thotë këto?

— Ç'ke me të ti? Asaj...

— Asaj, — u hodh e ja mori nga goja fjalën i shoqi, — asaj iu pre rrisku: s'rron dot më duke shitur e duke blerë çupat e botës!

— Po pse, ti ç'ke ndër mend ta bësh Maja? Me moshën që ka, çupa s'kënaqet më me përralla... Unë, — jo, dëgjomë gjer në fund, — unë kam kohë që po e vras mendjen...

— E pastaj?

— E pastaj, thua? Ja si qëndron puna...

Dera e jashtme kërciti.

— Erdhi Maja! — tha burri.

E shoqja e mbylli gojën, por ishte e vendosur që tërë natën të mos bënte gjë tjetër, veçse të bindëte të shoqin.

## IX

**B**abai e di! Babai e di! Sot e mora vesh nga xha Ceni se babai i di të gjitha! Po nëna?... Me siguri ajo ende nuk di gjë, se, të qe ndryshe, nuk do ta kishte mbajtur gojën kyçur... Por sido që të vendosin, tani është shumë vonë të më kthejnë nga rruga që kam nisur. Tani kam mësuar diçka të madhe, që nuk e dija më parë: femra duhet të ketë respekt për veten e saj.

## X

**V**etëm orën e dytë të mësimit, ajo ndjeu uri. Nuk kishte patur kohë të hidhej një vrap në shtëpi e të hante një kafshatë bukë. Kishin patur mbledhje në punë dhe, që nga mbledhja, kishte vajtur drejt e në shkollë.

Tek dëgjonte mësuesin e historisë që spiegonte, mendja i largohej vetë nga klasa dhe i endej rrugëve të qytetit, gjersa qëndronte në shtëpi. As ajo nuk e kuptonte, por ishte e shqetësuar e sikur kishte një parandjenjë të keqe. Një ditë më parë e ëma i kish folur e bërtitur, sa që vetëm dorë nuk i vuri. E kjo për hiçgjë, për një çikërrimë. Po dukej

qartë që nëna ishte e nevrikosur. Edhe me babanë, ashtu nevrike kish nisur të sillej. Maja i kish ndjerë pasdite që po haheshin me fjalë, por se për çfarë, nuk e kish hetuar dot.

Mësuesi vazhdonte të spiegonte.

— Maja e hoqi mendjen nga shtëpia. Vendosi ta spiegojë shqetësimin e saj me urinë që e kishte marrë. Por të largohej orën tjetër nuk donte, se kishte algjebër.

Kur ra zilja e pushimit, pas orës së dytë të mësimit, Majës erdhën e i thanë se dikush kërkonte të takohej me të.

Në çast, faqet iu bënë të kuqe si flaka e zjarrit.

Kur hodhi sytë në fund të koridorit, gjunjët iu prenë dhe ngriu në vend: i ati, në këmbë, i kish kthyer shpinën e po bisedonte me xha Cenin.

Një hop vajza qëndroi mbështetur pas shtalkës së derës. Mendoi në herë të kthehej përsëri në klasë, por në çast e flaku tutje këtë mendim dhe i erdhi turp nga vetja. Ngriti kokën dhe u nis. Mundohej t'i jepte hapit një ritëm të sigurtë e të mos tradhëtonte në sy të të jatit asnjë ndjenjë të zemrës së saj të shqetësuar.

Kur ndjeu hapat e vajzës, i ati ktheu

kokën. Maja vuri re se ai diç mbante në dorë, të mbështjellë me gazetë. Ja nguli sytë në fytyrë, por gjysmë errësira e koridorit nuk të linte të dalloje asgjë.

— Eja, Maja, — foli i ati.

Maja shkriu e tëra. Zëri i babait qe i butë, i ëmbël dhe vajzës iu duk sikur kish vite pa e dëgjuar atë zë.

— Ke ikur pa ngrënë, — tha babai.  
— Merre, — dhe i dha ushqimin e mble-dhur në gazetë.

— Baba... — tha Maja dhe ndjeu se sytë iu mbushën.

Por i ati e zuri për krahu dhe nuk e la të vazhdonte.

— E di, — i tha. — E di prej kohësh...  
Ndënjën në një stol. Maja nisi të hajë. Duart i dridheshin ende.

— Po nëna? — pyeti.

I ati e vështroi dhe nuk u përgjegj.

— Po nëna, baba?

— Bisedojmë në shtëpi.

Maja hante dhe heshtëte. Heshtëte dhe mendohej. Pranë saj, i ati e vrente. Heshtëte dhe ai. Heshtëte dhe mendohej. Në fillim deshi ta pyeste përse nuk ja kish treguar edhe atij, të jatit, që në fillim, por pastaj rrudhi ballin e nisi të dënojë

veten. E dënonte veten që e kish tmeruar aq shumë të bijën, i tērbuar nga llahtara e thashethemeve, sa që ajo, megjithëse e madhe e, si thoshte e shoqja, gati pēr nuse, të mos guxonte t'i hapej të jatit a së jëmës, por të kryente me frikë edhe një punë, pēr të cilën duhej lëvduar.

Maja hante. Gërshtet e zeza në shpinë i shëndritnin. I ati e shikonte në heshtje e dukej sikur i kërkonte ndjesë.

## KËNETA

*Kooperativistëve të Fushë-Krujës*

### I.

**D**randa ngriti mesin dhe fshiu djersën e ballit. Hodhi sytë përpara në fushën e pamatë të mbjellë me misër. Kooperativistët qenë shpërndarë ca këtu, ca atje. Brigada atë ditë kish nisur vjeljen e misrit në një nga arat më të mira, arë pjellore, që ta shpërbente mundin e djersën duke t'i mbushur hambarët plot. Se dhe arat janë si njerëzit. Kanë huqet e tyre, herë sëmuren, herë janë, të shëndosha, herë binden e i nënshtrohen vullnetit të fshatarit e atëhere, si nikoqire të mira, rrinë të pastra, nuk qasin ferra, gram apo bar të keq, por vetëm vështrojnë të kryejnë punën që u është ngarkuar dhe vinë e e bëjnë kallinë e grurit të rëndë, kokërmadh, ndërsa kallëpet e



misrit të mëdhej si kunguj; herë tjetër janë të prapa, bëjnë ç'bëjnë dhe mbulohen me gë-musha ferrishtash, mbledhin gurë, thahen e çahen si nga inati e, në fund, të duken anemike, të vrejtura, verdhacuke e krejt pa jetë... Por ara që ka përpara Dranda, s'është nga ato. Ajo i ka të rralla shoqet, e ka rritur misrin sa dy bojë njeriu të lartë, aq sa gruaja s'i dallon dot tërë shokët e brigadës. Megjithatë, këtu e ca vjet më parë, kjo arë ishte një kënetë e keqe, mbushur me ujë amull, fole mushkonjash e ushunjëzash, plot ferra, shavar e xunkth. Dranda e mbante mend mirë, se e kishte tharë vetë me duart e saj... Vitin e ardhëshëm, këtë arë pjellore që shtrihet për hektarë të tërë, do ta mbill-nin oriz. Dhe të gjithë ishin të bindur se kishin për të dalë faqebardhë.

Dita ishte e nxeh të, siç janë në këto anë ditët e para të shtatorit. Brigada e kish nisur punën që me natë, thuajse në errësirë. Misri duhej korrur, vjelur, zhveshur dhe grumbulluar pa humbur kohë në koçekët e kooperativës. Shirat mund të fillonin nga një javë në tjetrën dhe, po ta zinin misrin në arë, dëmi do të ishte i madh. Megjithatë, qelli dukej i kthjellët e dielli shkëlqente si në gusht.

— U lodhe, Drande? — i foli Filja, që punonte në të djathtë të saj. Ishte një grua me trup të hollë e shtatgjatë dhe rrobat e bardha e të qëndisura në krahëror dhe në mëngë i kishin hie.

Dranda e uli shtamën dhe fshiu buzët. Nuk ishte lodhur. Mendja i punonte vetëm në një vend atë ditë. Kishte që në mëngjez ashtu, që kurse ish bindur se dyshimet e një dite më parë kishin qenë të vërteta. Nuk e dinte në e kish vënë re edhe Selimi. Sidoqoftë, puna dukej sheshit. Tani e kishin kuptuar edhe të tjerë. Së bijës nuk i kish thënë gjë dhe po priste t'i fliste ajo e para. Shabani ishte djalë i mirë, Dranda do të pranonte me gjithë qejf ta bënte dhëndër. Megjithatë, shqetësimi si nënë e brente përbrenda. Nganjëherë kishte frikë se mos Shabani tallej me Dilen, i premtonte një barrë të mira, e bënte fatkeqe dhe e braktiste... E trembur nga këto mëndime, Dranda drejtonte mesin dhe hidhte sytë tutje për të parë të bijën, në anën tjetër të arës... I ngulte sytë ashtu një copëherë, gjersa shquante trupin e saj. Shabanin pastaj e gjente lehtë: ishte kurdoherë diku aty pranë saj...

Filja e shikonte Drandën me sy të hum-

bura tutje, vinte buzën në gaz dhe vazhdonte punën. E kish kuptuar shqetësimin e shoges.

— Marshalla, ç'misër! — thotë Filja.

Dranda vazhdon të korrë. Kiza bie mbi kallamin e misrit që dridhet i téri me një zhurmë letre dhe pastaj shëmbet përdhe...

I kujtohet si u martua ajo vetë, e ëma e Diles, aty në kënetë, vite më parë... Misri i prerë renditet varg përdhe. Filja e mbledh, e ngre në këmbë e e bën kapule. Pas tyre, ara e korrur mbushet me demete, që duken si kasolle të vogla...

## II.

**M**idis kallamishtes, duke mbajtur zhalonin atje ku i tha gjeometri, Selim Tanushi ktheu e pa kënetën e zezë që shtrihej në këmbë të tij. Sipërfaqja e ujit amull, e fëlliqur, me erë të rëndë, dukej si lëkura e një kafshe gjigande të ngordhur, që ka nisur të qelbëzohet e të ripet vende-vende. Xunkthi dhe shavari ngrinin kryet, kallamishtet e larta nxinin bregun në anën tjetër, ndërsa bretkosat të shurdhonin ditë e natë. Rreth e qark nëpër, kodër, kasollet e fshatarëve, kashtenxira e frengjishtëmbera, shikonin me trishtim

moçalin poshtë tyre... Kur i vështroje ashtu, tē varfëra, tē drobitura, si tē sëmura, e kuptoje se ato kasolle e ata njerëz kishin shekuj që po lëngonin buzë atij moçali, që i kish brejtur, i kish cfilitur e u kish thëthitur tërë fuqinë me urinë e me ethet e malarjes...

Hera herës moçali tërbohej dhe, si një përbindësh i zi, thëthinte në ujërat e qelbura ndonjë fëmijë që shkujdesur luante buzë tij... Kur nisnin ta kërkonin, e gjenin në sipërfaqen e zezë, penguar në ndonjë kaçube shavarë, me barkun tē fryrë, nga ujët dhe splina e malarikut...

Gjeometri i kish treguar, kur rrinin e shplodheshin në ndonjë hije, se tërë ai ujë i sëmurë, do tē kullonte duke kaluar nëpër kanal, dhe se ajo tokë do tē bëhej më pjellorja e kooperativës. Ishte tuaf njeri gjeometri dhe kishte një marifet: numrat e shifrat që mbanë shënim në bllok, dinte t'i khente në ara tē mbjella me lloj-lloj kulture... Duke dëgjuar atë, Selimit i dukej sikur shikonte përparrë syve arat e mbjella me grurë... Kallintë e gjelbër valëzonin nga era... Fshatarët humbisnin në mes arës së verdhë, kombajna punonte ditë e natë dhe kokrrat e grurit, tē verdha si floriri, mbushnin thasët e panu-

mërt... Fjalët e gjeometrit qenë vërtet të çuditëshme! Ato të gjallëroheshin në mendje dhe atëhere fantazia jepte e merrte duke zbuluar vendin, ndërsa zemra të bëhej mal...

Tek dëgjonte fjalët e gjeometrit, Selim Tanushit i mbusheshin sytë me lot nga mallëngjimi dhe i vinte të ngrihej e ta rrokte në grykë teknikun që po i zbulonte me aq siguri e dashuri të ardhmen e ndritur të fshatit.

— Kur të kridheni në bollëk, — i thosh gjeometri, — atëhere dasmave do ta tundni këndeje! Po atëhere më kujtoni edhe mua ndonjëherë... Apo jo, Selim? — dhe queshte.

Selimi ja kthente:

— Përse nuk rri këtu me ne, mor Niko? Të gjejmë dhe një nuse të mirë e të të bëjmë tonin, vëllanë tonë?

E kishte me tërë mend që fliste ashtu, nuk bënte shaka. Me njerëz të mirë si Nikua, punëtorë e të qeshur përherë, Selim Tanushi qe i sigurtë se s'kish mrekulli që të mos bëhej.

— Vërtet kërkon të më gjesh nuse, mor Selim trimi?

— Dhe nusen më të mirë, për besë!

— Më të mirën, mos gënje! Më të mirën

e ke ruajtur për vete... Se dhe ti beqar je!  
Apo jo? — Dhe hidhte kokën pas e qesh-  
te me një gaz të çiltër, të kumbueshëm që  
të kënaqte kur e dëgjoje.

Selimi heshtëte. Mendonte në ato çaste Drandën. Ajo ishte ëndra e tij rinore. Dhe, për të, shpesh i dilte gjumi natën. Me të kish lënë fjalë që përpara se të shkonte ushtar, por tani që ish kthyer vërente se nuk ish punë e lehtë. Ajo e donte gjithmonë dhe, me sy të përlotur, ja kish pohuar sërish. Selim Tánushi sjell ndër mend atë mbrëmje. Sytë e saj shkëlqenin në errësirë.

— Nuk do të më lenë, Selim, — i kish thënë. — Ti je fe tjetër...

— Ç'hyn feja këtu?

— Për mua e për ty nuk hyn... Por gjyshi thotë...

— Mos dëgjo ç'thotë gjyshi, Drande, — ja kish prerë fjalën Selimi. — Dëgjo ç'të thotë zemra dhe flaki tutje marrëzitë... Ne jemi të rinj...

Dranda kishte ulur sytë e menduar, e heshtur, sikur përgjonte zërat e natës...

### III.

**T**ek ty i ka sytë, Dile!

Diles i vjen inat që shoqet e ngacmojnë. Nganjëherë i duket sikur fajin për të gjitha e ka ajo vetë, po, kur mendohet mirë, i gjithë faji i mbetet atij. Me bisht të syrit vëren Shabanin që, njëzet hapa larg saj, punon pa e ngritur mesin duke vjelë misrin. Megjithatë, goja s'i pushon! Ku i di gjithë ato këngë, xhanëm! E nis në krye me këngë trimërie, pastaj ja kthen me një palë këngë «të buta», plot nënkuptime, që i bëjnë faqet e Diles të kuqen si qershia; më në fund, nis këngë nga ato të radios, që Dila i dëgjon shpesh në shtëpi, orën e muzikës së kërkuar... Dhe, veç kësaj, është krejt i papërmbajtur: t'i ngul sytë si gozhda në mes të shokëve e shoqeve e nuk do t'ja dijë fare që të tjerët i vënë re të gjitha; të hedh fjalë e çika, që të tjerët i bëjnë të shqyhen në gaz, ndërsa ti nuk di nga t'ja mbash; të del përpara ngado që vete, ditë a natë qoftë, dhe, mbi të gjitha, ajo çiftelia e tij s'të ndahet asnje çast... Tingujt e saj Dila i dëgjon kur është në fushë, kur niset në arë, kur pushojnë një grimë, kur mblichen në sallën e vatrës së kulturës, kur pe-

rëndon dielli, kur ajo mbështet kryet në jastëk, kur flë... Jo, ai e ka fajin. Për faj të tij po bëhen gazi i botës. Të gjithë e kanë marrë vesh që Shabani ja ka vënë synë — edhe në shtëpi do ta kenë kuptuar, megjithëse thonë se të fundit që i marrin vesh këto punë, janë kurdoherë babai dhe nëna... Kështu kish lexuar dikur në një libër... Për këtë e ka marrë inat Shabanin tanë. Sa herë që është vetëm dhe mendohet, vendos që radhën e parë që do t'i dalë përpara, t'i vrëjë ballin dhe të kthejë kokën mënjanë me shpërfillje, t'i tregohet e ftohtë, t'i... Megjithatë, sa herë që ai i del përpara dhe me çiftelinë në dorë këndon:

«Moj e mira, del në atë hie,  
Fol me atë gojë, ç'ka dreqin kie?»

ajo e harron vendimin që ka marrë dhe sytë i qeshin, buzët i dridhen dhe zemra i rreh në krahëror si një harabel i vogël në kafaz, që përpinqet të shpëtojë duke plapuritur krahët...

#### IV.

Kur hyri brenda i ati, Dranda e kuptoi menjëherë se ai diç kish. Në errësirën e kasholles, kandili dritëpakë nuk i zbulonte dot

krejt fytyrat e njerëzve, por Dranda vërente të bardhët e syve të të atit, mollëzat e tij të irnosura dhe zemra i dridhej. Ai nuk deshi as të hajë. Gjyshi, ndanë vatrës, kollitej dhe pështynte në hirin e ftohur.

— Çfarë ke kështu, Tom? — e pyeti më në fund plaku.

Pranë Tomit kish ndënjur Dranda. E ëma ishte në anën tjetër, e heshtur, e trëmbur. Po hanin këmbëkryq në sofrën e vogël.

— Ja ç'kam! — shpërtheu Tomi dhe ngriti krahun e goditi me kurrizin e dorës fytyrën e së bijës. Dranda u rrëzua mënjanë, ndërsa gjaku i vërshoi nga hunda. I nxehur, Tomi nuk u përbajt dot më. — Na, — i tha së bijës, duke e goditur përsëri, — na dhe këtë! . . .

E shoqja u ngrit në këmbë.

— Çfarë ke kështu, or burrë? — pyeti ajo, por nuk guxoi ta prekte të bijën për ta hequr nga duart e të shoqit.

Gjyshi shikonte dhe heshtëte. Tani edhe kolla nuk e ngacmonte më.

— Çfarë kam, thua? — ulëriti Tomi. — Ja, kam këtë që, në shtëpi time, ime bijë nuk e merr kurrë Selim Tanushin se, mos më thënçin Tom Marku, mu këtu në vatër ja

bëj varrin!... — Dhe, si çfreu këto, i nxehur, rrëmbeu mashën, por e shoqja u hodh në mes dhe ai e flaku mashën tutje, duke sharë fatin që i kish dhënë atë vajzë në shtëpi për t'i nxirë faqen tërë fisit.

Nga lëvizjet e vrullshme, flaka e zbetë e kandilit, varur në një gozhdë në oxhak, u shua. Në errësirë dëgjoheshin frymëmarrja e rëndë dhe nervoze e Tomit, dënesat e mbytura të Drandes...

Nga këneta e zezë vinte poterja shurdhonjëse e zhabave...

## V.

**D**ila ecte dhe dëgjonte kokëulur fjalët e Shabanit. Rrugës nuk kish dritë, por herë këtu, herë poshtë, në shtëpitë e reja të kooperativistëve, ndriçonin llambat elektrike, ndaj dhe dy të rinxjtë kishin marrë shtegun midis arave, ku, në errësirë, dëgjoheshin bulkthet e natës dhe tingujt e largët që përhapeshin nga radiot... Duke iu afruar vajzës, Shabani zgjati dorën për ta zënë nga krahu. Bishti i çiftelisë që shtërngonte nën sqetull, e goditi Dilen në sup.

— Si s'e le një herë këtë çifteli! — tha

ajo e u largua një grimë.

Shabani vuri buzën në gaz.

— Këtë e kam patur me vete edhe në Tiranë, — i tha vajzës. — Në konvikt, në mbrëmje, dilja në dritare dhe i bija në errësirë... Shokët më dëgjonin dhe heshtnin... Mua më kujtohej fshati, më kujtoheshe ti...

Dila qeshi me shejtanllék...

— Të kujtohesha unë?! — pyeti si e habitur. — Po unë nuk di t'i bie çiftelisë! Thua j më mirë që të kujtohej xha Fani. Ai, po, ai e qan çiftelinë!

Shabanit i pëlqente kur Dila bënte sikur nuk kuptonte dhe lodronte me fjalë. Dhe në ato çaste ai, që zakonisht ish aq i hedhur, i guximshëm në fjalë, vinte e bëhej tuc dhe i ngatërhohej gjuha. Por atë mbrëmje ish i sigurtë.

— Çiftelia, — nisi t'i spiegojë vajzës, — më kujtonte pérherë fshatin... Më dukej sikur ju shikoja ju të gjithë duke punuar, duke kënduar, duke qeshur... Kur binte shi dhe ujët kullonte nëpër xhamat, mua më kujtoheshit ju nëpër shtëpi, me dritën elektrike në tavan, në dhomat e reja, duke ndënjur ndanë zjarrit, duke biseduar pér këtë e pér atë... Por më shumë nga të gjithë më kuj-

toheshe ti... Më dukej se do të të gjeja të bukur si të lashë...

— E si më gjete?

— Më të bukur nga ç'të lashë!

Vajza rrudhi buzët.

— Dile, — tha djali dhe befas zëri i mori një ngjyrë të lehtë trishtimi, —për kater vjet rresht, vetëm për ty ka kënduar çiftelia ime!

Vajza shpërtheu në të qeshura... Në errësirë, sytë e saj të mëdhenj e të mënçur shkëlqenin... Shabani hetoi në gazin e saj fillin e hollë të qesëndisë, por nuk i erdhi keq.

— Oj e mira ime, — i tha dhe i shtrëngoi dorën.

Kishin qenë në shtëpinë e kulturës, ku, për të festuar martesën e një shoku të tyre, të rintjtë qenë mbledhur dhe kishin kënduar e dëfryer një copë herë. Nusja e re vinte nga larg, nga Suka e Tepelenës. Me dhëndërin qe njojur në fabrikën e cimentos, në Fushë-Krujë, dhe, një javë më parë, kishin bërë dasmën. Por gjatë gjithë mbrëmjes, Shabani nuk kish patur kujdes tjetër, veç si e si të bënte që, kur të iknin, të mbetej vetëm me Dilen. Tani, që me të në krah, endej arave të mbjella, zemra i këndonte me ëmbëlsi e zjarr, si me tinguj të magjishëm çiftelie...

## VI.

**M**otopompa gumëzhinte tërë ditën. Me gjithatë, në kanal ujët arrinte gjer në gju. Selim Tanushi, zbatbur, djerit, ka hyrë ndër të parët në ujë. Lopata ngjitet pas llucës dhe duhet forcë për ta flakur tutje. Ndaj, në kanal, kanë zbritur burrat më të fortë të fshatit. Me Selim Tanushin janë edhe dhjetë të tjerë. Edhe ata, të dërsitur, të lodhur, por jo të mposhtur. Janë të vendosur, si gjithë fshati, ta shporrin një herë e mirë kënetën nga arat, nga vatrat, nga jeta e tyre...

Por Selim Tanushin nuk e mundon lumi i kanalit. Ai ka tri ditë që vë re një ndryshim të çuditshëm te Dranda. Ajo i largohet vështrimit të tij, skuqet e dridhet e gjitha kur sytë e tyre ndeshen dhe hiqet më-njanë e trëmbur... Diçka duhet të ketë ngjarë. Diçka e keqe, e hidhur, që po e mundon Selimin më tepër se ujët e kënetës...

Një ditë më parë, Selimi vendosi t'i flasë Tomës. Ai duhej të ish shkaku. Ja thoshte zemra Selimit se nuk gabohet duke menduar kështu. Ai ose gjyshi.

Rasti e kish prurë që në pushimin e drekës, Tom Marku të vijë e të ulet pranë Selimit. Si duket nuk e kish vënë re.

Selimi u kapërdi, la kafshitën në shesh, në shaminë e kuqe të hapur përpara, dhe u bë gati t'i flasë. Por atë çast Tom Marku ktheu kokën dhe e vuri re djaloshin. Në çast, sytë i kërcyen dhe nofullat iu shtrënguan. Selimi nuk i luajti qepallat. Për një hop u panë sy në sy dhe, pa i thënë asnje fjalë njeri tjetrit, të dy u muarr vesh se ç'mondonin: urrejtje e çfrenuar në një anë, vendosmëri për t'ja arritur qëllimit nga ana tjetër...

Poshtë tyre, ujët e zi të kënetës, që shkëlqente nga dielli i nxeh të, kish nisur të mposhtej...

## VII.

Kur hyri në shtëpi, në dritën e fortë të elektrikut, fytyra e saj e skuqur shkëlqeu: ishte e gjëzuar, e dehur, e lumtur... Dranda e kuptoi menjëherë si qe puna. Atë mall rino e lumturi të papërmabjatur në zemër e kish njohur dhe ajo në ditët e vashërisë së saj. Po atëhere një hare e gjëzim i tillë në sy të prindit do të ishte një punë e pacipë, në mos një guxim e kuturisje e rrezikëshme... Ndaj Dranda edhe brengat, edhe lumturinë e di-

tëve më të bukura të rinisë, i kish fshehur në sytë e shëndritshëm dhe në heshtjen lëndonjëse... Kurse për Dilen qe ndryshe. E, me gjithëse e bija u mundua një çast ta përbajë veten, kur pa sytë e nënës që e hetuan, gëzimi dhe lumturia e saj qenë kaq të mëdha, sa ato i shpërthyen nga tërë fytyra, nga tërë trupi, nga tërë fjalët dhe lëvizjet që bënte...

— Mirëmbërëma, gjysh! — thotë Dila e duket sikur këndon. — Mirëmbërëma, gjysh!  
— dhe e puth plakun në të dy faqet.

Çfarë ke kështu, lule e gjyshit?

Por Dila fluturon në dhomën tjetër, atje ku ka shtratin, raftin e rrobave dhe radion mbi tryezë.

Tingujt e radios mbushin shtëpinë. Gjëmon një melodi e qeshur, që duket sikur spërdridhet dhomë më dhomë e nuk qëndron askund... Prek rrudhat e gjyshit, që rri në minder dhe dëgjon në heshtje, i vjen rrotull Drandes që ka mbetur në mes të dhomës me duart lëshuar mbi përparësen ngjyra-ngjyra, i shkon një çast në shtrat vëllait të vogël të Diles, del jashtë nga dritaret, bashkë me rrezet e dritës, përkëdhel lëkurën qimezezë të qenit në oborr, që ngre kokën i habitur,

bredh nëpër rrugë midis arave dhe i del përpara Selim Tanushit, që po kthehet me bickletë nga mbledhja e kryesisë...

— Ç'është kështu? — pyet Selimi të shoqen kur hyn brenda.

Dranda vë buzën në gaz.

— Dila, — thotë, — ka vënë radion...

Selimi shikon të shoqen në sy. Pastaj zgjat dorën, i shtrëngon krahun gruas dhe vë buzën në gaz...

— Tani që vija, — i thotë, — e pashë dhe atë... Ekte nëpër errësirë dhe i binte çiftelisë...

### VIII.

Pikat e mëdha të shiut e bëjnë sipërfaqen e zezë të kënetës të flluckohet dhe të duket sikur ke përpara jo ujë, por një pellg me zift të zi që zien... Rëtë janë ulur dhe qark drita është mpakur.

Në fytyrën e Drandes rrëshqasin pikat e shiut dhe përzihen me lotët...

— Mos qaj, — i thotë Selimi.

Por vajzës, që i dridhet buza sikur të ketë ftohtë apo ethe, lotët i rrjedhin vetë...

— Mos qaj, — thotë Selimi dhe vrejt ballin.

Lotët e Drandes e nxehin, e bëjnë nevrik, dhe atëhere shtrëngon grushtet, sikur bëhet gati të godasë dikë.

— Kënetën, — thotë, — kënetën e kemi këtu, në krahëror... Brenda në zemrat tonë... Kënetë të zezë, pis, të mbushur me ujë të fëlliçur e të sëmurë për vite me radhë...

Dranda përmban dënesat dhe vë veshin për të dëgjuar. Ka ikur nga shtëpia, është takuar fshehurazi me Selimin dhe, plot shpresë, pret prej gojës së tij një fjalë të mirë, një fjalë shpëtimtare, që do t'i kthjetë llojë ditët e saj dhe, në qiellin e vrejtur të brengave, do të kthejë diellin e artë... Por fjalët e Selimit i duken të çuditshme, ajo nuk i kupton.

— Drande, — e pyet befas djali, — a më do ti mua?

Vajza ngre kokën. Shiu e rreh mbi molëzat, pikëmadh, i ftohtë, i bollshëm... Sytë e Drandes çapëlehen, vështrojnë me habi, hetojnë... Buza nuk i dridhet më. I ka ngrirë... Përse e pyet kështu Selimi?

— Duhet të jesh e fortë, — i spiegon djali, — e fortë si zjarri që ke në zemër... Eja me mua!..

Dranda nuk di ç'të thotë. Vë duart në grykë dhe është gati të shpërthejë përsëri në lot. Por djali i hedh dorën në qafë, e tërheq pas vetes. Ajo mbështet kryet në krahërin e bëshëm të fshatarit dhe pret...

— E mira ime! — thotë djali. — Eja me mua!

Shiu bie mbi dy të rinxjtë e përqafuar. Rrobat e tyre kullojnë. Por Dranda nuk qan më...

Pikat e shiut rrahin ujët e kënetës. Një zhurmë e turbullt vjen nga shtrati i zi. Duket sikur këneta grindet me veten, sikur rënkon e shqetësuar, e kapitur nga plagët që i kanë hapur fshatarët në krahëruar...

## IX.

**D**ielli i artë shëndrit në qiellin e kaltër. E korrur, ara duket edhe më e madhe, gati e pafund. Mbledhur togje-togje, kashta e misrit pret të bartet, të kalojë në maqinën e gri-rjes dhe të vendoset në silazh... Vjeshta e artë i mbushi dhe këtë vit hambarët e kooperativës. Fshatarët kanë nisur të bëjnë plane për punët që i presin...

Në arën e kënetës ka ardhur dhe gjyshi i Diles, bashkë me nipin e vogël. Me të, pas pak, bashkohet edhe një plak tjetër: është Tom Marku. I vogli shkëputet nga njeri gjysh dhe hidhet në prehrin e gjyshit tjetër...

Dranda është ulur të shplodhet një grimë. Sheh të dy pleqtë aty pranë dhe i vjen mirë që e duan njeritjetrin. I duket sikur ata, sa më shumë plaken, sa më shumë thinjen, aq më shumë i ngjajnë shoshoqit, sa që të duken si vellezër...

Tringëllin zilja e bicikletës së Selimit. I vogli e sheh i pari: shpëton nga duart e gjysh Tomës dhe i del të jatit përpara...

— Tani vjen kamioni, — i thotë së shoses Selimi. — Ku janë të tjerët?

Të tjerët janë shpërndarë në arë, duke i bashkuar në togje kapicat e kallamishtave, në mënyrë që kamioni t'i ketë më lehtë për t'i ngarkuar...

— Rri urtë, Arben! Mos e prek zilen, se do ta prishësh!

Arbeni largon një çast, dorën, por, kur prindët e humbasin vështrimin tutje, ai nis përsëri të zhvidhosë kapakun e ziles...

— Dila është ajo?

Dranda tund kokën.

Dila ka vënë një kapele të madhe kashte. Ja ka dhuruar Shabani. Të dy, pranë njeri tjetrit, bartin kallamishtet për ta grumbulluar togje-togje... Punojnë dhe qeshin, sikur po luajnë... Të dy janë të lumtur dhe u duket se, duke djersitur ato ditë shtatori në atë arë të madhe me misër, në atë arë që dikur kish qenë moçalishte, duke punuar nën rrezet e diellit që djeg, u shëmbëllejnë dy zogjve të qiellit, që fluturojnë poshtë e lart pa pushim e me ngut, për të ngritur folenë sa më parë, para se të zënë shirat e vjeshtës...

— — — — —

## BURRI I VOGEL

«Do të mbledhim kamomil» — thotë mësuesja kujdestare. Aksion është ky? Shpërndahesh fushës apo brigjeve dhe, duke kënduar tra-la la, si fëmijtë e kopshteve, këput lule kamomili dhe mbush qesen. Hera herës rend me vrap te mësuesja për t'i treguar se sa shumë ke mbledhur... Jo, mor shok, ky s'është aksion, ky është çilimillëk! Për kë duhet kamomili? Për fëmijtë? Bukur fare! Atëherë le të venë vetë fëmijët e ta mbledhin! Kështu po, kështu merret vesh, po mos ejani të më thoni se, të mbledhësh kamomil, hithër apo sherbele, është një aksion, njësoj si të shkosh me brigadën e të hapësh taraca në kodër! Asaj, po, asaj i them punë unë, jo shaka! Shkon njeriu, përvesh llërët, rrok kazmën apo shatën, shkul më parë shqopën dhe ferrat që kanë mbuluar tërë faqen e kodrës, pastaj, vap e vup, jepi për të hapur taracat. Agrominin apo gjeometrin e ke aty, te koka, dhe



të mat punën, të thotë se sa e ke plotësuar normën e ti, duke fshirë djersën — po djersë tamam, ama! — dëgjon e kënaqesh. Kurse këtu na mbledhin si çilimiqër e na ngarkojnë me nga një punë të vockël, sa për t'u marrë me diçka. Kështu, na mbajnë të gjithëve tok e na ruajnë, tani që mbaruan mësimet, të mos sorollatemi rrugëve, të mos na shkelë ndonjë automobil dhe të mos rrëzohemi nga ndonjë pemë a mur...

Kështu mendon Fatmiri, ndërsa klasa mblidhet në oborrin e shkollës, nga ku do të niset për të mbledhur kamomil.

Është i shkurtër me shtat, dërdënëk në trup dhe, në kokën e madhe, flokët, megjithëse mundohet t'i mbajë të kreher dhe vazhdimisht i lag me ujë, i ngrihen përpjetë si gjëmba iriqi. Në mësime është i mirë; nuk shquan, bile as kërkon të shquajë, se me sa duket, e quan si çilimillëk edhe përpjekjen për të dalë i pari i klasës. Vetëm se në përgjigje apo biseda të ndryshme është, pa dyshim, më i pjekur nga gjithë të tjerët. Gjer në klasën e gjashtë, ka qenë një nxënës, tmersisht i vështirë, nuk linte dy gurë bashkë. Kishin gjetur belanë mësuesit, sidomos mësueset e reja, të cilat shpesh fjalët e tij, të lëshuara pa kuj-

des, i merrnin me nënkuptime fye. Por unë e dija që ai, megjithëse e hiqte veten si burrë i pjekur, ishte fëmijë.

Me Fatmirin, me sa dukej, kish ndodhur një pjekje para kohe: ajo që të tjerëve u ndodh zakonisht në klasën e tetë, atij po i ndodhëtët në të gjashtën e të shtatën. Dhe që ish kështu, dukej qartë. Shokët e tij më të mirë ishin ata të klasave më të larta, mundësisht maturantët. Futej midis tyre dhe bisedonte me të rriturit, si të ish vërsnik me ta. Merrte pjesë në mbledhjet, në mbrëmjet e tyre të vallëzimit dhe, si kavaljer, ishte i pa-iodhur. Edhe librat i zgjidhët për moshë më të madhe. Kur përgjigjej në mësim, ishte e pamundur të mos thoshte diçka që të zbulonte leximet e tij.

Ditën e dytë, Fatmiri nuk vajti në shkollë. Mësuesja pyeti për të. Dikush i tha se do të ishte sëmurë. Ajo i vuri mungesë dhe u nis me nxënësit e tjerë. Atë ditë i çoi fëmijtë në lindje të shkëmbit të kalasë për të mbledhur hithra. Por pasdite, në dhomën e saj, ku banonte së bashku me një shoqe, e zgjoi nga gjumi i ërekës një e trokitur në derë. Tha se mos ishte ndonjë telegram nga Shkodra, ku kishte familjen, ndaj brofi në këmbë

Në derë qëndronte një grua e skuqur

dhe e djersitur nga dielli e të bariturit: nëna e Fatmirit.

— Nuk është në shtëpi? — pyeti e habitur mësuesja.

— Jo, — u përgjegj nëna. — Iku në mëngjez herët e nuk është kthyer ende!

Si tha këto, vuri dorën në faqe dhe tun-di kokën me dëshpërim.

Një copë të rrugës e bëri në këmbë, se kamioni i Bardhit, që kryente shërbimin urban midis Krujës e Fushë-Krujës, nisej më vonë. Të priste, nuk donte.

U dha këmbëve. Për t'i rënë shkurt, u var poshtë, zbriti nga pas shtëpisë së pionierit, duke kaluar nëpër monopatin midis ullijve, anës përroit, gjersa arriti afér shkollës tetë-vjeçare «Xak Pengili». Në oborr kishin nisi të mblidhen nxënës.

Pas pak, ktheu kokën e pa lart, në lagjen Perlataj, rrëzë malit, shtëpinë e tij që zbardhë.

Edhe pak, e do të dilte në rrugë. Po të kalonte ndonjë kamion, do t'i nxirrte krahun përpara e do ta ndalonte. Shoferat e njihnin, si bir shoferi që ishte, dhe kishin për ta marrë. Po sikur në ndonjë nga këta kamiona. për dreq, të ishte i ati? Këtë nuk e kishte

menduar më parë, ndaj tani iu prenë gjunjët.

Vendosi të fshihej pas dyqanit ku, zakonisht, kamioni i Bardhit bënte ndalesën e parë dhe aty të priste. Nëse në kamion nuk do të ishte i ati, do të hipte. Vërtet që do të vonohej ca, por s'kish ç'të bënte.

Tani qe ulur në karrocerinë e kamionit, duke u shtypur midis një plaku dhe një nusje të re.

— Ku po shkon kështu, mor shejtan?  
— e pyeti plaka përballë, që kishte pranë këmbëve një thes të mbushur me ca gjëra të forta. Fatmiri kish vënë kapelen prej kashte mbi gjunjë, të cilët po i mblidhte, se ja vriste thesi.

— Në aksion po shkoj. — u përgjegj djali dhe ktheu kokën nga ana tjetër, si për të thënë se me kaq biseda duhej të merrte fund.

Plaka heshti, por pranë plakës qe një ushtar me një fizarmonikë në krah, që i ra në sup, sikur ta kish mik të vjetër dhe i tha:

— Të lumtë, bre, burrë!... E shiko të dalësh sulmues!

— Sa për atë, — u ndje e foli prapë plaka, — s'duket të ketë vuxhut për sulmues ky! Janë të tjerë ata...

Fatmiri u nxeh.

— Pse, si janë ata? — u hodh e pyeti.

Plaka rregulloi thesin e ja pruri më pranë djalit, i cili e shtyu me inat.

— Ata, — tha plaka, — ata kanë ditë që po punojnë atje!...

Kamioni la pas kthesën e gurores.

Në kodrën përballë, në të majtë të rrugës, u dukën aksionistët. Të shpërndarë shpatit, po punonin për hapjen e taracave. Të gjithë kthyen kryet dhe i panë. Fatmiri e ndjeu me të vërtetë veten të vockël në sy të pasagjerëve, iu duk vetja si një përtac që ua ka hedhur shokëve dhe tani po del i fundit në punë.

Kamioni u var poshtë duke gjarpëruar nëpër kthesa, gjersa qëndroi te Kroj i Fokës.

Bardhi nxori kokën nga kabina.

— Do të zgresë njeri këtu? — pyeti. Iu përgjigj një tog zérash.

Vullnetarët e njohën që poshtë, në rrugë, kur Fatmiri u hodh nga kamioni. Të gjithë lanë punën e u kthyen nga ai, duke tundur kapelat, shamitë dhe e përshëndetën me zë të lartë mikun e tyre.

Fatmiri u ngashërye. Nga gëzimi, iu qep shpatit si një dhi e egër.

Kur arriti në taracën e parë, u përqafua me Gencin, një maturant, të cilit i qenë bërë duart me kallo nga kazma. Pastaj, gati me të gjithë ç'qenë atje. Edhe me katër mësuesit. Edhe me gjeometrin, të cilin s'e njihte fare.

— Sa mirë bëre që erdhe! — i thoshin.

— Ç'kemi andej?

Midis shokësh, Fatmiri e ndjente veten të qetë, në vendin që i përkiste. Jepte përgjigje majtas e djathjas, i sigurtë, me fjalë të pakta, edhe kur thoshte gënjeshtër përtë shpëtuar. Vera, komandantja e brigadës, pasi kaloi tërë entuziazmi i parë dhe të tjerët u shpërndanë përsëri në punë, e pyeti:

— Përse erdhe, Fatmir?

— Erdha të punoj me ju, ta thashë një herë.

— Vërtet e thua?

— Vërtet. Përse?

— Po a e di njeri që ti ke ardhur këtu?

Nga kjo pyetje e vështirë e shpëtoi Genci, i cili foli me të madhe:

— Vera, — tha, — fute në punë që tani. Të na bjerë ujë!

— Jo, — u hodh Caja, një nxënëse e klasës së dhjetë, që punonte një taracë më

lart. — Fatmiri të mbledhë sherbelen e asaj faqeje atje, para se ta shkulim ne. Është gjynah të vejë dëm!

— Mirë thotë Caja, Vera!

Vera iu kthye Fatmirit.

— Mirë, — i tha, — po sot do të punosh poshtë.

Fatmiri u hodh:

— Sherbele nuk mbledh!

— Nuk do të mbledhësh sherbele. Do të shkosh në Halilaj. E di rrugën?

— E gjej.

— Atje do të shkosh te Maja. Është dezhurne bashkë me një tre të tjerë. Do të zëvëndësosh Shpëtimin, që është sëmurë. Kuptove?

— Kúptova. Po ç'punë do të bëj?

— Ta cakton Maja.

Në fshatin Halilaj, njëzet minuta larg vendit të punës, vullnetarët kishin mensën dhe fjetoren. Fatmiri arriti lehtë. Në oborrin e shkollës kishin ndërtuar një tendë me fier dhe atje hanin vullnetarët. As në shkollë, as në tendë s'kish njeri, por nga pas ca gëmushave dëgjoheshin tringëllima enësh. Djali bëri më tutje dhe atëhere, pranë një çezmeje me dy fyta, nën hijen e një rrapi

me trup tē përcëlluar nga rrufeja, pa Maja  
jën që po lante enët.

— Maja! — i foli.

Maja ngriti kokën dhe i buzëqeshi. Kur ndenji pranë saj, ajo i spiegoi se ku hanin shokët, ku flinin (në një kasolle tē gjatë, që andej nuk dukej) dhe se dezhurnët e tjerë kishin vajtur, bashkë me kuzhinierin, tē merrnin ushqimin e ditës.

Fatmiri dëgjonte. Në tē vërtetë, nuk ua kishte vënë shumë veshin fjalëve tē saj. Shikonte ato pjata e tasa prej alumini — plot njëqind e pesëdhjetë copë, siç i tha Maja, dhe habitej se si ajo, që kish qenë maturante e shkëlqyer, e kishte ulur veten sa tē lante enët...

— E kështu, Fatmir, — i tha Maja, — erdhe tē punosh me nel!

— Po, — u gjegj djali. — Dhe, për sot, Vera më dërgoi te ty.

— Ashtu? Shumë mirë ka bërë. Do tē punojmë bashkë.

Fatmiri u hodh:

— Ç'punë do tē bëj? — pyeti.

Maja tregoi enët.

Ç'punë do tē bësh? — i tha. — Ja, do tē më ndihmosh që tē mbarojmë shpejt!

Fatmiri brofi në këmbë, sikur të qe rrezik se mos Maja e detyronte.

— Të laj enët? — tha dhe vrënji ballin.

— E përse jo?

— Sepse unë po habitem edhe mëty!... Kam ardhur këtu të bëj punë e jo të merrem më... më... çikërrima!

Maja vuri buzën në gaz.

— Puna është punë kurdoherë, — i tha. — S'ka punë të madhe e punë të vogël, ka vetëm punë. Këtu kështu punojnë të gjithë.

Fatmiri heshti. Këto fjalë nuk dinte si t'i kundërshtonte. Mendoi një çast t'i thoshte se ai kishte ardhur atje të bënte punë burrash e jo punë grash, por e bëri gjuhën zap, sepse e para, nuk ishte i sigurtë në mund ta quante veten burrë që tani, dhe, e dyta, të tilla fjalë i kish dëgjuar shpesh nga Dulla Dembeli, që sorollatej pazarit. Sidoqoftë, një gjë ishte e sigurtë: atje lart, në taraca, do ta caktonin të barte ujë ose të mblidhë sherbele, kurse këtu poshtë, Maja po e vinte të lante enët!

— Ulu aty, Fatmir, — i tha Maja me një zë të qetë, sikur të ishte plotësisht e sigurtë që djali do të bindej. — Ulu aty dhe spastro enët. Mbeturinat, ki kujdes, mblidhi në një

tas, që të mos përhapen djathtas e majtas, se gjejmë belanë nga mizat.

Fatmiri dëgjonte dhe s'dinte ç'të b"nte.

— Në fillim, — vazhdoi Maja, — dy ditët e para kishim shumë miza, por erdhën e spërkatën vendin me ilaç — tendën, muret e shkollës, fjetoren tonë; po ulu, ulu, Fatmir, tani mizat janë zhdukur. Mjafton të mbësh-tetet miza në murin e spërkatur, që të bjerë në çast e ngordhur për tokë! Kaq ilaç i fortë është!

Kur erdhën dezhurnët që kishin ndih-muar kuzhinierin për të marrë ushqimet Fat-mirin e gjetën duke shplarë pjatat e fundit.

Pasi hëngrën drekën, ranë të flinin.

Fatmiri u shtri në vendin që i kishin caktuar, pranë Gencit. Nuk flinte. Mendime të ndryshme i vërshonin në kokë. Tani që po e shikonte me sy tjetër atë që kish bërë, vinte re se punët nuk qëndronin aspak ashtu siç i kish menduar këtu e ca orë më parë, kur ish larguar nga Kruja. Aty ku kish ardhur, në brigadën «Skënderbeg», ishte mirë; ai e dintë që, duke punuar e duke jetuar së bashku me shokët e tij më të ngushtë, do të kënaqeji. Por, kur kërkonte të gjente shka-kun e vërtetë të ikjes së tij nga shokët, që kishin mbetur në Krujë për të mbledhur

kamomil, hithra dhe sherbele, atëhere ndjente në zemër një darë të ftohtë, që nuk e linte të qetë. Si nuk i kish rënë në mend më parë që puna është punë kudo, se, ashtu siç thoshte Maja, nuk ka punë të mëdha e punë të vogla, por ka vetëm punë? Po gënjeshtrat? Po gënjeshtrat që kish thënë? Kushedi sa do të jenë shqetësuar në shtëpi! Ja, nga këto gjëra ai duket se është ende çilimi, megjithëse e heq veten burrë! Ikën nga Kruja fshehu-razi, nuk i thotë asnjeriu në shtëpi apo në shkollë se ç'ka ndër mend të bëjë, gënjen shokët në aksion se ka ardhur me dijeninë e të gjithëve dhe tani është shtrirë aty si guak, si t'i kishte të gjitha në rregull! Pse, kështu bëjnë burrat?

I nxehur me veten, u ngrit ndënjur.

— Ç'ke? — e pyeti Genci që hapi sytë pranë tij.

— Asgjë! — ja ktheu Fatmiri dhe u shtri prapë.

Por, pas pak, si pa që të gjithë po flinin qark tij dhe se Genci po gërhinte, u ngrit ngadalë, mori kapelen prej kashte dhe doli jashtë.

Në sheshin e madh përparrë fjetoreve, në majë të shtyllës, valavitej flamuri. Fatmiri hodhi vështrimin rrrotull, sikur të donte ta

mbërthente në kujtesë atë pamje. U drejtua më të djathtë, nga flinin vajzat. Donte të bisedonte me Verën. Nëqoftëse nga Kruja kish ikur pa i thënë njeriu, këtu nuk donte ta përsëriste këtë gjë.

— Kam bërë një marrëzi, — i tha asaj me zë të ulët dhe zbrazi tërë brengën e zemrës.

— Do të ikësh që tani? — e pyeti Vera.

— Që tani. Më vjen turp të rri ende këtu. Me shokët rregulloje vetë: u thuaj se nuk kish ardhur për të ndënjur, por vetëm për të na parë, ose si ta mendosh vetë. Ose u thuaj të vërtetë. — Heshti një hop e pastaj vazhdoi: — Më mirë thuaju të vërtetën.

Vera u ngrit dhe zbriti me të kodrën. Kaluan mensën, kaluan nëpër shtegun e mbushur me manaferra, që nxinin nga të dy anët, kaluan midis shtëpive të fshatit dhe, kur dolën në breg, panë së largu kamionin e Bardhit që vinte nga Fushë-Kruja.

— Ika, — tha Fatmiri dhe ja dha vraptit ta zinte kamionin te Kroj i Fakës.

Komandantja e brigadës e pa që hipi në kamion.

Kur u nis maqina, ai hoqi kapelen dhe u ngrit në këmbë. Vera ishte ende atje. Ai tundi kapelen për ta përshëndetur dhe ashtu vazhdoi, gjersa kamioni mori kthesën...

## DHITË

### E

## SKENDERBEUT

*Sipas një legjende kruatane*

Kur arrinë në Tumenisht, dielli po perrëndonte. Të përpjetën e kishin marrë me një frymë, ndaj tani dihatnin thellë, të djerisitur, të munduar nga vapa e gushtit. Por atje, në majë të malit, frynte erë.

Ishte e gjashta ditë që po u dilnin turqve po nga ato shtigje e s'i linin të merrnin frymë: u binin, korrnin e grinin me shpata, mbillnin rrëmujën midis shatorreve dhe pastaj çanin tutje. Vëershimi i tyre i ngjante atij të një lumi të vrullshëm, që zbret me buçimë e vërtik nga malet dhe përmbyt e përmbyt ç'gjen përpara: njerëz, kafshë, pemë, mure, shtëpi...

Duke fshirë fytyrën e duke e shkuar shaminë e madhe në zverk e në krahërorin

e bëshëm, Skënderbeu u thoshte trimave që të bënин gati për të ngrënë, se dhe atë ditë e kishin fituar kafshatën me djersë e gjak.

Hamzait, pranë tij, po i lidhnin një plagë që kish marrë në krah.

Skënderbegasit u përhapën në atë malsheshe dhe u ulën skerkave e shpellave. Shplodheshin e flisnin më të rrallë. U që bërë zakon që, sa herë të ktheheshin, të sot disnin një valëherë malin e Krujës përballë.

Kruja po bënte tre muaj e rrethuar. Kishte ardhur vetë sultani Murati, bashkë me të birin, me qindra mijë njerëz, me kalarës e këmbësorë. Për herë të parë ai sillte në Krujë edhe metal për të derdhur topa...

Kur gjëmuani topat e parë të padishahut dhe ushtima e përçolli gjëminin e tyre mal më mal — e zmadhoi, e copëtoi, e shpeshtoi, duke e përhapur nga të gjitha skutat, sikur të donte të tmeronte me këtë vendasit tri-ma, Skënderbeut, në Tumenisht, iu vrenjt balli, por nuk iu drodhën qepallat.

— Kanë burgosur bubullimat e ferrit, — tha, — dhe i kanë lëshuar këtu, në trojet tonë, për t'u kallur tmerin në zemër grave e fëmijve!

Të nesërmen, me një grusht trimash

nga më të zgjedhurit, u var poshtë nga malet dhe si rrufe zharritëse ra mbi jeniçerët, vau topçijtë, përmbysi grykën e topit dhe e rrokullisi gjer te bajgat e kuajve, përmbysi sëndyqet me barot, mbolli tmerin e llahtarën rreth e qark, duke e vringëlluar pallën e hatashme mbi kokë e duke grirë sa i dolën përpara...

Sulltan Murati shkuli mjekrën e thinjur nga inati. Kishte tridhjetë vjet në krye të sulltanatit, emri i tij u kish shtënë tmerin popujve, kurse një malok arnaut, mu nën hundë të tij, guxonë të përbyste dhe të tallej me armën më të fuqishme të kohës.

Kruja nuk jepej. Arma e re ishte e zonja të mbillte tërmete në tokë e bubullima në shtëpi, që tani nuk i dueshin me si ulërima kanosëse, por si çfryjtë deshpërimi të padishahut!

Kur prunë për të ngrënë, Skënderbeu, në këmbë me Hamzanë, po vërente nga Kepi i Rodonit. Deti skuqte gjak nga rrezet e diellit. Një avull i kuq kish pështjellë edhe Durrësin, nën sundimin venetikas. E, për Venetikun e dhëlpërítë e tij, ato ditë, fletë shpesh e më shpesh.

— Nëqoftëse njerëzit e Shën Markut do të guxojnë t'u sjellin ushqime turqve, — i thoshte Skënderbeu Hamzait, — ne do t'u biem karvanëve të kumerqarëve e nuk do t'i lemë të sjellin as edhe patkojtë e mushkave! Tregëtinë le të venë ta bëjnë gjetkë, jo këtu me gjakun e burrave e të grave arbër, që po vriten për të drejtën e tyre!

Kishin pjekur në hell dy dhi të egra e tani ata burra hanin duke e prerë me kama e shpata mishin e ngrohtë e të shijshëm.

Ulur në mes të tridhjetë trimave, Gjergj Kastrioti hante dhe bisedonte, duke trazuar me fjalë herë këtë, herë atë. Pranë kish një ushtar që, megjithse i madh me trup, dukej se ish çunak: E quanin Petrush dhe kish lënë dhentë e dhitë për t'u bashkuar *me fuqitë e Skënderbeut*. Ishte nga malësitë e veriut. Kur i qe sulur Skënderbeu Shkodrës për ta çliruar nga sundimi i tregëtarëve venetikas, fshatarët që vuanin nën zotérinjtë e huaj, kishin ngritur krye. Pikërisht atëhere Petrushi i kish braktisur dhentë dhe kish këmbyer kërrabën me kordhën.

— Petrushi sot, — tha Skënderbeu, — na e ka kaluar të gjithëve!

Petrushit, i turpshëm siç ish, iu skuqën faqet.

— Të mos ish Petrushi, — u hodh e foli Hamzai, — unë nuk do të kisha shpëtuar vetëm me një plagë në krah.

Ishte e dyta herë që, në përleshje, Petrushi binte në sy për të qëlluarit me topuz. Kur e shihte pisk, ja vërviste kundërshtarit mazdraken që së largu dhe e linte top në vend.

— E ka mësuar krahun me dhen e dhi, zot! — ja priti Mark Pleshi, një vigan kru tan, — bari e bir bariu!

— Vetëm një të keqe ka, — u hodh e bëri shaka një tjetër, — kështu si e ka nisur, do të na lërë të gjithëve pa topuz!

Dhe vërtet, Petrushi kish humbur kësisoj në përleshje plot tre. Skënderbeu zgjidhi topuzin e vet nga brezi dhe ja vuri përpara trimit të ri.

— Për një krah të tillë, — tha me zë të lartë, — që ua përplas në shesh çallmat dhe ua përshesh trutë të pabesëve njëzet hostenë larg, nuk do të na mungojnë kurrë mazdraket!...

Uruhx agai ishte i sigurtë se do t'ja dil te mbanë kësaj here. Ishte radha e dytë që vi

nte në Arbëri. Herën e parë kish arritur deri në Torvjoll e kish qenë nga të paktit që e shpëtuan lëkurën në atë përleshje dhe, faqenxirë që kthyer pas Ali Pashait, kish rënë përmbyss e i kish puthur këmbën padishahut. Që prej asaj dite e kish ndjerë veten me njo llë në ballë. Por tani, nëqoftëse arrinte ta qëronte nga faqja e dheut Iskanderin e arnatutëve, ai, jo vetëm do të vinte në vend nderin e humbur, por do të fitonte aq, sa as në ëndër nuk kish guxuar të lakmonte.

Përveç çetës së Iskanderit, qenë dhe plot të tjera. Veçan e rrezikëshme ishte ajo e Moisi Golemit, që kish guxuar të arrinte njëzet hapa larg shatorres së padishahut, duke rrezikuar kësisoj jetën e Sulltan Muratit dhe të të birit; të papërbajtura çetat e Tanush Topisë e të Zaharia Gropës, që kishin kordhëtarë e shigjetarë të rrallë e të shpejtë si era; djaj të vërtetë kalorësit e Muzakës së Angjelinës, që të dilnin kur s'i prisje e nga s'i prisje, dhe vetëm me britmat e poteren e madhe, të bënин ta humbisje toruan; përkundrazi, burrat e Gjergj Stres Balshës qenë të heshtur, ustallarë të hanxharit e të topuzit — u kishin rënë në qafë kuajve dhe qerreve e, po të vazhdonin kësh-

tu, kishin për ta lënë edhe padishahun të bridhte në këmbë. Të gjitha këto çeta e të tjera (qenë lart nga katërmijë vetë të shpërndarë maleve), ua kishin nxirë jetën asqerëve, ishin bërë makthi i tyre, po i brenin ca nga ca taborret, si ato sëmundjet vdekjeprurëse që të futen në trup pa u ndjerë fare. Megjithatë, mendonte Uruhx agai, të qëroje Iskanderin, ishte njësoj sikur t'u pritje kokën të gjithë atyre burrave, ndaj vrasja e tij ishte shpëtimi i vërtetë për padishahun dhe fundi i Krujës.

Të pesëqind burrat që kish zgjedhur vëtë me dorë të tij, në mes të ajkës së jeniçerëve, qenë shpërndarë sic e kish porositur. Tani, nuk prisnin veçse urdhërin e tij. Dinak si kurdoherë, Iskander arnauti nuk qëndronte gjatë në një vend, dhe, ku flinte sonte, nuk flinte të nesërmen. Por ka dinak mbi dinak dhe Uruhx agai mendonte se një nga ata ish ai vetë! Të dhënat që kish mundur të mbledhë nga njerëz të dërguar posaçërisht, tregonin se atë natë, krutani rebel ishte vetëm me tridhjetë vetë.

Kur nisën t'i qepen malit, nata kish kohë që ndehej mbi Tumenisht. Për të mos u ndjerë, Uruxhi i kish urdhëruar jeniçerët

të zbatoshin. Ai vetë qe në mes të vargut të gjatë. Krep pas krepi, do të arrinin kësi-soj gjer në majë, duke i rrethuar Skënderbegasit si në vathë. Do t'i gjenin në gjumë, do të vrishnin rojet — për këtë kish caktuar njëzet nga burrat e tij — e pastaj do të sulleshin mbi arnautët e fjetur. Iskanderin, kish dhënë urdhër, ta ruanin për atë. Me kokën e tij në dorë, duke e mbajtur nga leshrat e përgjakura, ai do të kthehej vrap e t'ja shpinte padishahut në shatorre...

Ktheu kokën e pa më të majtë. Jenicerët kacavireshin duke lëvizur lehtë dhe pa u ngutur. Disa kishin hequr edhe rrabet e trupit e kishin dalë gjokszbuluar, për të qenë më të lirë në lëvizje. Sa për çallmat, kish dhënë urdhër vetë Uruhx agai t'i hiqnin se, si të bardha mund të binin në sy lehtë.

— Nuk i shoh të gjithë, — i tha Uruhx agai Adilit, krahut të tij të djathët, që kacavirej dy çape pas. — Fërshëlle!

Adili vuri dorën në gojë dhe nxori një fërshëllimë të ëmbël si cicërimë bilbili. Nuk shkoi shumë dhe fërshëllima të njëllojta iu përgjigjen më të majtë e më të djathët.

— Po shkasim si bolla dhe s'ka zot të na dëgjojë, — u mburr Adili.

Duart u ishin gjakosur. Tani e përpjeta, shkëmbore dhe krejt pa udhë, i mundonte keq.

— Edhe në xhehnem, — shau Uruhx agai, — nuk ka skërka më të liga!

— Të duket sikur shkel me tehe jata-ganësh!

Përpara tyre diç lëvizi.

Të dy burrat qëndruan dhe vunë veshin.

Pas tyre, qëndruan edhe të tjerët.

— Ç'është? — pyeti Uruhx agai.

Adili s'u ndje një copë herë, pastaj pëshpëriti:

— Njeri nuk ish!

Zhurma u përsërit.

Uruhx agai mori frymë dhe bëri përpara.

— Bisha mali, — tha. — Ecë!

Nuk mbeteshin më shumë se dyqind pash që të dilnin në majë. Uruhx agai i tha Adilit që të férshëllente e dha urdhër të qëndronin në vend një copë kohë. Duhej të shplodheshin që, kur të sulmonin, të ishin të freskët e të fortë.

— Tani, — tha Uruhx agai, — nuk na shpëtojnë dot! — dhe sytë i shkëlqyen nga kënaqësia.

Në mal, skënderbegasit i kish zënë gju-

mi. Vetëm roja vigjillonte, ulur majë një shkëmbi nga ku rrokte me sy tërë hapësirën qark.

Petrushin një kohë nuk e zuri gjumi. Skënderbeu kish dashur ta kish pranë edhe kur flinte. Para se ta zinte gjumi, e kish pyetur malësorin shkodran për njerëzit e shtëpisë dhe kish kërkuar që ai t'i fliste përtë gjithë me radhë e me hollësi. Petrushit, në fillim, i kish ardhur zor të rrëfente tërë hallet e brengat e familjes së tij fatkeqe, por Gjergj Kastrioti dinte të ta fitonte zemrën, dinte të të bënte për vete me ato që thosh, me fjalët që zgjidhte, me vështrimin e syve dhe shprehjen e fytyrës. Petrushi i kish folur hapur, me zemër në dorë, si i thonë fjalës, ashtu si nuk i qe rrëfyer askujt. I foli bile edhe për Ruginën, për pshëritimën e zemrës së tij, të cilën, venetikasit ja kishin vrarë. Kujtimet, ndjenjat, brengat i qenë ringjallur në krahëror e, me këtë shqetësim e trazim në zemër, e kish pasur të vështirë ta zinte gjumi. Sillte ndër mend Ruginën, sillte ndër mend fjalët e Gjergjit...

«Njeriu, Petrush, — i kish thënë ai, — është si pemët: i ka rrënjet në tokë! Më kupton ç'dua të them?»

«Po, zot.»

«Nëqoftëse toka varfërohet, thahet e çahet për një pikë ujë, edhe pema që është mbjellur në të, do të vyshket, do të thahet. . .»

«Po, zot.»

«E si kjo pemë është dhe lumturia jonë. Sa kohë vendi vuani, sa kohë Arbëria kullen gjak e lot, as edhe njeri prej nesh nuk mund të jetë i lumtur.»

Me këto fjalë në mendje, Petrushi ndënnji kohë pa fjetur. Hera herës kthente kokën dhe shikonte Gjergjin. Kish shtruar në shesh pelerinën e kish rënë dhe ai, ashtu veshur siç ish me tirget e bardha dhe mëngoren e qëndisur. Kishte hequr vetëm këmishën e hekurt dhe brezin e armëve.

Nata ish e qetë. Në qìell yjet e panumërt dukeshin, që nga maja e malit, të qartë e plot dritë. Kashta e Kumtrit ngjante si një lumë dritash të pafund, që i binte qìllit mes për mes.

Petrushit i rëndojnë qepallat. Por pikërisht tani që gjumi i është qepur në qepalla, ai dëgjon si nëpër èndër një zhurmë, në fillim të lehtë e, më pas, më të fortë, të vazhdueshme. . . Sikur teshtitet njeri, sikur rënkon dikush. . .

Petrushi hap sytë dhe vë veshin.

Në errësirë dëgjohen turfullima dhe një baritje e lehtë.

«Dhitë e egra!», thotë me vete djaloshi.  
«Dhitë e egra!»

Ngrihet e rri ndënjur. Atëhere vë re se dikush, jo shumë larg tij, është ngritur në këmbë. Në çast, e kuhton si qëndron puna.

Ngrihet dhe i afrohet Gjergj Kastriotit.

— Zot, — i flet, — zot! Zgjohu, zot!

Skënderbeu hap sytë. Kur sheh Petrušin mbi kokë, kërkon të dijë se ç'ka.

— Dhitë e egra, zot, — i përgjigjet trimi i ri, — po çfytyrin të trëmbura! Jemi në rrezik!

Në errësirë dëgjohen turfullimat e kafshëve të malit dhe thundrat e tyre që rrabin shkëmbijve me shpejtësi.

Skënderbeu brof në këmbë.

— Të zgjohen të gjithë! — jep urdhër.

Sa çel e mbyll synë tërë çeta është në këmbë. Zgjojnë edhe rojen. Skënderbeu nxehet kur i thonë që rojen e kishin gj tur në gjumë.

— Shpérndahuni qark e vëreni ç'ndodh!  
— u thotë burrave.

Vetë, me Petrušin pas, vjen me çap të lehtë buzë shkëmbit. Hedh sytë në të tatëpjeten që nxin si grykë gremine.

Poshtë tyre dëgjohen turfullimat e dhi-ve. Janë kope e tërë.

— Na kanë diktuar, — thotë Skënderbeu. — Varu poshtë e shih nga ikin!

Petrushi, shtyn nga pas shpatën dhe zbret poshtë. Ecën dhe mbahet skërkave, i ngul këmbët të mos i shkasin e mos bëjë zhurmë. Pastaj qëndron.

Dhitë çfytirijnë ende. Ai i shikon që nxijnë dhe, si hije të zeza, hidhen krep më krep, njera pas tjetrës, duke u larguar më të djathtë të tyre. Të kishte hënë, do të mund të shikonte qartë edhe ç'i kish trëmbur.

— Këndeje ikin, zot, — i thotë pastaj Skënderbeut. — Ikin varg.

— Nuk dukej gjë tjetër?

— Jo, nuk dukej.

Erdhën dhe të tjerët.

— Na kanë rrethuar, — tha Hamzai.

— Nga të gjitha anët, dhitë janë ngritur e po ikin.

Dy nga trimat kishin mundur të shqu-anin poshtë hijet e turqve.

— Duhet të jenë shumë.

— Sado që të jenë, — vendosi Gjergj Kastrioti, — kur të arrijnë këtu, nuk do të gjejnë asnjerin prej nesh.

Të tjerët heshtën.

— Nga do të ikim? — pyeti Hamzai, që s'po kuptonte se ç'shteg kish mbetur i paruajtur nga jeniçerët. — Ata, me sa duket, na i kanë zënë të gjitha shtigjet!

— Po dhitë, — ja ktheu Skënderbeu, — po dhitë nga ç'anë ikin atëhere?

Atyre burrave u qeshën sytë.

— Ç'thua ti, Petrush?

— Për quell e për dhë, — iu përgjegj ish bariu, — i ke rënë në të, zot! Dhitë janë të mënçura, ato e dinë se nga duhet kaluar!

Skënderbeu u spiegoi trimave se ç'duhej të bënин dhe dha urdhër:

— Gojëkyçur gjithë udhës! Shpatat zgjeshur!

Pastaj iu drejtua Petrushit, që e kish marrë përsipër këtë punë:

— Na prij, Petrush!

Petrushi çau përpara. Pas tij vinte kryetimi i Arbërisë. Në gjurmët e dy të parëve, shkelnin gjithë të tjerët.

Zbritën poshtë.

Përpara tyre, dhitë turfullonin, por tanë qenë larg e nuk dukeshin më.

— Nga e djathta, — i pëshpëriti Skënderbeu Petrushit.

Duke shkuar të kërrusur, duke u fshe-

hur pas skërkave dhe kaçubishteve, ata burra u bënë varg i gjatë. Për një çast Petrushi e humbi, meqë dhitë nuk po i shikonte kund. Po sikur të qenë gabuar e të ndesheshin tani ballë për ballë me jeniçerët?

— Zot, — tha me zë të ulët e qëndroi,  
— të vemë veshin e të përgjojmë.

— Përpara janë, — ja ktheu Skënderbeu.

I shpejtuan këmbët.

Nuk kaloi shumë e ja tek u dukën dhitë. «Shpëtuam», mendoi Petrushi. Ktheu kokën nga pas dhe pa shokët që e ndiqnin të kërrusur. Trupi i madh i Gjergj Kastriotit dukej në errësirë si një shkëmb vigan që lëviz.

— Ecë, Petrush!

Petrushi u afrohet dhive, por jo shumë, se ka frikë mos i trëmbë.

Udha tani është e vështirë, e rrezikshme. Këmba duhet të shkelë buzë humnerash, që janë gati të të thëthijnë në errësirë.

Po Petrushi nuk heq shumë për të zgjedhur vendin, dhe e zgjedh edhe për gjithë të tjerët që ka pas. Tani nuk mund të ecin më varg, pranë njeri tjetrit. Duhet të hidhen si dhitë nga një krep në tjetrin.

Petrushi pëshpërit në errësirë:

— Poshtë është humnerë, zot.

Me radhë, ata trima kapërcejnë humnerë pás humnere.

Tani janë larguar shumë prej malsheshes ku po flinin. Mund edhe ta ngrenë shtatin.

— Të qëndrojmë një çast, o burra, — thotë Gjergj Kastrioti.

U mblodhën të gjithë qark. I futën shpatat në mill dhe kthyen kryet pas, përtë parë udhën që kishin bërë.

— Padishahu, — tha Gjergj Kastrioti, — që i ka nisur e po i pret tani në shatorre, kur t'i kthehen duarbosh e kokë-varur, do të na quajë lugetër! — dhe qeshi me të madhe.

Qeshën dhe të tjerët.

— Kurse ne, — vazhdoi kryetrimi, — nuk jemi veçse barinj dhish! Apo jo, Petrush?

Petrushi qeshte i kënaqur dhe, me dorë, si pa dashje, përgëzonte mazdraken që i kishin dhuruar një natë më parë.

— Këto dhi, — tha Skënderbeu, — janë dhitë tonë! Sonte na zgjuan, na shpëtuan nga rreziku e na mësuan nga duhet të kallonim, na mësuan se si duhet ecur krep më krep, buzë greminash! Le t'i duam e të nde-

rojmë ç'mbajnë ato në gji të tyre: lulet, pemët, kafshët dhe shkëmbijtë e thepisur!

Historia e dhive të egra që shpëtuan Skënderbenë, mori dhenë. Ajo zbriti nga malet, u përhap ndër fusha, e rrëfyen brez pas brezi njerëzit dhe dhitë e egra u bënë më të shtrënja për ta. Sepse ato u kujtonin kurdoherë Skënderbenë e madh, që, si trim i dashur për malësorët e fshatarët, nuk kish dashur ta stoliste përkrenaren me asgjë tjetër, veçse me një kokë dhie të egër.

## SHKAMBI

### I


### VAJES

*Sipas një legjende krutane*

**A**rritën në mal. E dinin që turkun e kishin në thëmbër, por, sa për një çast, mund të merrnin frymë lirisht.

— Mos u ligshton, burrëresha! — tha Zanfina.

Në mal, ato gra e vajza i ndjenë faqet e tyre të nxehtha e të djersitura t'u flladiten një grimë nga puhiza mëngjezore. Poshtë, Kruja ishte e mbuluar ende nga tymi i zjarrave që kishin llamburitur gjithë natën. Ato kthyen sytë, panë pullazet e kullave në varosh, panë rrugët me kalldrëm, panë ullinjtë dhe sytë iu përlotën. Poshtë në fushë, në Zidoll, kish kuaj e çadëre. Sa të ngrihej mjegulla e atëhere syri i tyre do të kish mundësi t'i shikonte turqit që venin e vinin si zotër në atë kështjellë fatosash, duke shkatë-



IOMAIIA

rruar e djegur, duke vrarë e përdhunuar ç'u binte në dorë.

— Hiqni sytë andej! — tha prapë Zanfina. — Sot kështjellat tonë janë majat e shpellat e maleve! — dhe me jataganin që mbante në dorë, tregoi nga lindja.

— Mirë thotë Zanfina! — ja priti Bora. Ishte një vajzë e re, e bukur si një këngë e pastër malësore dhe kish lënë në Krujë në-nën dhe vëllanë e njomë — me nga një plagë të kuqe në krahëror.

Gratë u larguan prej bregut nga ku shikonin sypërlotura për të fundit herë atë copë vend që ish aq i dashur për to.

Bora ecte në ballë, kokën lart. Pas saj, turma e grave dhe e vajzave që u kishin shpëtuar duarve të përgjakura të jeniçerëve, çapitej e lodhur.

— Nuk eci dot më, o motra! — thotë një grua me sy të zgurdulluar nga vuajtja. Në kala ajo kish qenë me kryezonjën Donikë, shërbente në dhomat e saj; kur zonja që larguar me të birin, Gjonin e vogël, dhe me një karavele ish hedhur në Itali, ajo kish mbetur në Krujë, nuk kish dashur të largohej nga prindët. Dhe aty, në Krujë, ajo kish luftuar si të tjerët, për t'i bërë ballë rrethimit të sultani Mehmetit.

— Qëndro, Mari. Do të shpëtojmë.  
— M'u prenë gjunjët, zonja Lenë.  
— Flladite fytyrën me vesën e malit! —  
dhe zonja Lenë, më e madhe në moshë nga  
Maria, shkon pëllëmbët e saj në barin e njo-  
mur nga vesa. Maria, ulet dhe ajo, njom  
duart, i shkon në fytyrë, ndjen erën e barit  
të njomë dhe zjarri sikur i paket në shtat.  
Zonja Lenë e zë nga krahu. Çapitin për të  
arritur shoqet.

Zafina, në fund fare, me dhjetë vasha,  
të gjitha me jataganë në duar, kush edhe me  
hark a heshtë, ruan shoqet dhe mbulon kësh-  
tu ikjen.

— Zafinë, — pyet Dranda, njera nga  
vashat, — ku do të shkojmë?

Vetëm Zafina e Bora e dinë se ku po  
shkojnë. Sido që të vijë puna, në dorë të  
jenicerëve mund të bien vetëm të vdekura.

— Mos u tutni, — burrëreshat e mia! —  
thotë Zanfina. — Vdekja është faqe bardhë!

Dhjetë vjet pas vdekjes së Gjergj Kas-  
triotit, Kruja e fatosave luftonte ende me  
turkun. Krutanët qenë mbyllur në kështje-  
llë dhe qëndronin si burrat. Akinxhijtë,  
cuba të ndyrë e vrasës të egër, erdhën si  
murtajë e zezë në kohë të lëmejve vite me

radhë. Arbët thyen bejlerbenë e Rumelisë, që u tërhoq me partallet e taborreve, duke blatuar në këmbët e Fatihut, në Stamboll, turpin dhe marazin. Por s'kaloi shumë dhe Mehmeti II nisi përsëri taborret. Në krye prinin bajraqet e Ahmet bej Evrenozit. Lart nga tre vjet i ngulën ato çadëret qark Krujës, që e mbante kokën lart e nuk falej. Në kala mungonte buka, mungonte uji, mungonin armët; gjylet e havanëve ranë si breshër mbi ledhet e pullazet e qytezës; dashi i jenicerëve përplasi me tërbim kryet në portën e madhe; pirgje dhe bedena u shembën; shkallët e çengelat e hâlldupëve u mbërthyen shkëmbijve e mureve; të ftohtit i ngriu të rrëthuarit, ua buhaviti dhe ua nxiu mishrat; vapa e zagushia i sëmuri; vdekja u erdhi rrotull ditë e natë me qefin në dorë e, megjithatë, Kruja qëndroi.

Nga bjeshkët e veriut, me lulen e trimave, Lekë Dukagjini rendi në ndihmë të vëllezërve. Kur panë nga bedenat e sharopollët e mureve flamurin e bardhë të Dukagjinasve me shqiponjën e zezë, krutanët nxorën jashtë sokolat dhe, dorë për dore me dukagjinosit, u përleshën me armiqtë. I thyer, Ahmet bej Evrenozit i shkuli shatorret

dhe ja mbathi. Krutanët morën frysme një çast, megjithëse humbjet qenë të dhimbëshme. Këtu qe vrarë dhe trimi i Zanfinës.

Sullan Mehmeti II, i tërbuar nga një qëndresë kaq e fortë e këmbëngulëse, i mblo-dhi nga i kish e nga s'i kish hordhitë e tij aziatike dhe në krye të tyre u shkul e u rrokullis në Arbëri. Shtrirë në letigë, midis jastëkësh të mëndafshët, i mbajtur nga skle-vër zezakë, i zbavitur nga kadënat e haremit, i ruajtur nga jeniçerët gjakatarë, ai hera herës ngrinte perdet e qëndisura dhe u hidhte një sy maleve të Arbërisë. Dielli i verës digjte. Midis një sherbeti të ftohur me borë e një rehat-llokumeje, Fatihu jepte urdhërat e vdekjes.

Kur qëndroi në Kruijë ushtria e osman-lijve, fusha e Zgërdheshit dukej si një det çallmash e sarëqesh, të bardhë, të kuq a të gjelbër; shatorret mbinë si kërpudha, togjetogje; metalet e topave u derdhën me shpejtësi; zjarri dhe hekuri e mbuluan kalanë duke mbjellë vdekjen...

Krutanët panë nga muret taborret e panumërtë. Nga zemërata u erdhi të hanë veten me dhëmbë. Burrat ngrinin sytë në qìll, vështronin diillin e ndritur dhe qanin me lot.

«Të vdesësh me një diell kaq të bukur,  
është mëkatë, o zot!»

Megjithatë qëndruan. Por sëmundja bëri  
kërdinë: ç'po kursente uria dhe arma e Fati-  
hut, e korrte ajo.

Atëhere kapedanët u mblozhën.

Në bedene, në sharapolle, në frengjité e  
pirgjeve, majë pullazeve, majë kampanares,  
krutanët ua kishin ngulur sytë dy kalorësve  
që kishin dalë nga porta e madhe e po shko-  
nin te sultani Mehmeti II. Që lart, kuajt  
qimebardhë dukeshin të vegjël por ishin kuajt  
më të bukur që kishin mbetur; ata i panë si  
humbën mes shatorreve, dolën midis ushta-  
rëve turq, që u bënë udhë, dhe u drejtuani  
për në shatorren e madhe prej mëndafshi  
të gjelbër, ku sultani qe shtrirë i kredhur  
në jastëkë me pupla.

— Nuk vimë të kërkojmë lëmoshë, —  
tha më i shkuari nga kapedanët krutanë,  
veshur me tirq e xhoke të re, — por të drejt-  
tën tonë, në emër të zotit. Ajo kala sot është  
tbana jonë, por nëqoftëse do të guxojë kush  
të na e marrë nëpër këmbë të drejtën, ajo  
mund të bëhet varri ynë e i vrasësve tanë  
dhe padishahu, kur do të hyjë, nuk do të  
gjejë veçse një grumbull gërmadhash!

Sulltani picérroi sytë nga gëzimi i egër, nga tèrbimi i gjakmarrjes dhe, dinak si pérherë, tundi kokën sapak në shënje miratimi.

Kështu, një ditë qershori, dhjetë vjet pas vdekjes së Skënderbeut, Kruja, krenaria e Arbërisë, u hapi portat turqve. Sipas marrëveshjes, banorët do të largoheshin dhe nuk do të prekeshin nga otomanët.

Nisi të dalë rreshti i gjatë i mbrojtësve trima. Largoheshin me qerre e kuaj, me fëmijë e gra, duke marrë me vete ç'të mundnin. Jenicerët ishin aty. Një pjesë hyri edhe në kala. Për një copë kohe çdo gjë shkoi në rregull, por, befas, ra daullja dhe jenicerët, si të çmendur nga tingulli i saj, u sulën mbi burrat e gratë, mbi fëmijtë e pafajshëm dhe të sëmurët e pambrojtur, për t'i grirë në jatagan e hanxhar. Sulltani më i madhi Turqisë kish gënjer si rrugaçi më i fundit.

Krutanët hodhën dorë në shpata. Përleshja u ndez e furishme, e tèrbuar, me zemërati dhe dëshpërim nga njera anë, me etje për gjak dhe vollë për plaçkë, nga ana tjetër.

Pas jenicerëve, në kala vërshuan ushtarët e tjerë turq. Qyteza gjëmonte, dridhej dheu sikur binte tërmet; ulërinin njerëz e

kafshë, shëmbeshin mure dhe pullaze, të vdekurit mbushnin rrugët, sheshet, binin nga dritatret...

Për një farë kohe, krutanët e morën vreten dhe i zembrapsën armiqjtë nga pjesa jugore e qytezës, duke i ngjeshur pas portës së madhe. Por sultani nuk kursente ushtarë. Dërgoi të tjerë. Megjithatë, gjer në drekë, jeniçerët nuk bënë më hap përkëndei. Befas, pasdite, shpërtheu zjarri. Turqit hodhën lëmsha të zjarrtë me përdredhore në anën jugore të qytezës. Një pjesë e ndërtimeve brenda në kështjellë qenë prej druri, ndaj flaka u përhap lehtë. Mjaftoi kjo që jeniçerët të turren përpara.

Qëndresa kishte marrë fund.

C'la zjarri, mbaroi thika.

Zanfinën me një turmë grash e vajzash e mbyllën në kishën e madhe. Që andej do t'i çonin, këmbë e duar ngarkuar me zinxhirë, t'i shisnin si skllave apo t'i ndanin si plaçkë lufte.

Natën, nga jashtë, vazhdonin të vinin rënkimet e të plagosurve dhe zhurma që bënin jeniçerët duke u endur nëpër shtigjet e rrugicat e kështjellës.

— Borë, — i tha Zanfina vashës, duke e

térhequr mënjanë. — Më mirë vdekur, se sa skllave të turpit në dhé të huaj.

— Ç'të bëjmë, Zanfinë?

— Të mos rrimë duarkryq.

Pas Borës, Zanfina zgjodhi dhe nja pesëmbëdhjetë vasha të tjera të forta. Nuk kaloi shumë dhe, jo vetëm burrëreshat e zgjedhura nga Zanfina, por të gjitha ato gra qenë gati t'u hidheshin jeniçerëve në grykë. I fshinë lotët, u armatosën me ç'mundën — kush me copa stolash, kush me plloça nga të dyshemësë, dhe pritën sa të hapej porta. Sa të rrëmbenin ca armë donin, se pastaj do të dinin të çanin rrugë, sikur dhe vetë djalli të dilte nga ferri e t'u priste udhën.

Kur u hap porta, qe ende natë. I lanë jeniçerët të hynin brenda dhe ata, krejt të çkujdesur, me kamzhikë nëpër duar, u shpërndanë nëpër kishë.

— Mbi ta! — thirri Zanfina. — Mbi ta, o burrëreshat e mia!

Jeniçerët e parë, të cilëve ende nuk u qenë mësuar sytë në errësirën e kishës, ranë shpejt në lak. Me jatagan në dorë, Zanfina u turr në portë. Pas saj vërshuan të gjitha gratë. Ndeshja u ndez në oborr.

Në qìell, yjet kishin nisur të zbehen.

Kur arritën në malin e Krujës, kishin mbetur vetëm gjysma, të tjerat qenë vrarë a i kishin zënë robe përsëri. Zanfina dhe Bora kishin dashur t'i ngjiteshin malit, t'u vidheshin syve të jeniçerëve, që nuk u ndaheshin, duke kapërcyer në drejtim të lindjes. Por turqit u dolën përpara dhe i detyruan të ndërronin udhë.

Përballë tyre, në malin tjetër, u dukën kullat e fshatit Shen Nou. Aty gratë qëndruan: të shkoje më lart, donte të thoshte të arrije majë shkëmbit e që andej, përvëç greminës e vdekjes, nuk kishte gjë tjetër.

— Varuni poshtë, nga kjo anë! — urdhëroi Zanfina e u turr vetë e para.

Gratë u lëshuan pas saj, por çallmat e bardha të jeniçerëve zbardhën midis shkëmbive. Ato mbajtën hapin. Pas pak, një batare dyfqesh me fitil, i bënë të ikurat të tërhiqen pas.

— Kanë zënë të gjitha shtigjet!

— Mbaruam, motra!

— Në dorë të tyre — kurrë!

— Kurrë!

Bora ngriti zërin:

— Në është se duhet vdekur, — tha, — le të zgjedhim vdekjen më të bukur, se jemi nuset e motrat e sokolave të Krujës!

Dielli nisi të agojë. Lëshoi rrezet e arta mbi shkëmb, kur ato *gra* iu afrohan buzës së humnerës. Këndonin e qanin. Këndonin një këngë të bukur për atdhenë, një këngë për qiellin e kaltër të Arbërisë, një këngë për zemrat e tyre të reja... Jeta pa liri, thoshte kënga, nuk vlen të jetohet.

Zanfina qëndroi poshtë me burrëreshat e saja, për t'u bërë ballë jeniçerëve, që kru-tanet trime, të cilat nuk kishin qenë të lira të jetonin, të ishin të lira të vdisnin. Tur-qit s'guxonin të afroheshin, se shtegu i ngushtë qe i rrezikshëm, edhe me gurë ato *gra* mund t'i bënин zap.

Në krye të vargut, Bora nisi vallen. E vargu sa shkonte e i afrohej majës së shkëmbit. Qark tyre qenë majat e maleve, dëshmitare të heshtura e të përjetëshme; nga krepat e thepisur, shqiponjat i panë bijat e Skënderbeut dhe u ngritën fluturim t'i bë-nin hie me krahët e tyre valles së vdekjes majë humnerës...

Dielli e kishte larë me ar shkëmbin, kur vargu arriti atje. Bora ish në majë, e bukur si një këngë kreshnikësh... Dhe ra ajo e para!

Kënga ushtonte mal më mal, vallja dri-

dhej krenare... Këngë, valle dhe lot... Mbi humnerë ngrihej një çast një rrrobë e bardhë. Era e gufonte. Më pas, nuk dukej më... Kënga e shoqeve mbulonte ulërimën rrënqethëse, si mbulon flamuri trupin, e heroit...

Vargu shkurtohej. Ato që mbetën, u hodhën të zëna për dore. Vetëm Zanfina qëndroi e fundit. Me vrap, u largua nga shtegu dhe erdhi në majë të shkëmbit. Jenicerët nxorën kryet, por, kur majë shkëmbit nuk panë vecse Zanfinën, stepën një çast në vend.

Si një vegim legjendar, Zanfina qëndroi një grimë në majë të krepit. Leshrat e shpleksura ja merrte era. Poshtë, në fund të greminës, midis skërkave të Drosë britmat e shoqeve... Mbi krye të saj, shqiponjat me krahë të shpalosura...

Zanfina ngre krahët lart. Në një dorë ka jataganin. Rrezet e diellit llamburitin, në tehun e çeliktë, e atëhere duket sikur ajo mban në dorë një pishtar të ndezur.

— O Arbëri! — thërret e malet gjëmojnë nga zëri i saj i fortë. — O mëma jonë! O trimëresha jonë! Hakmerru dhe për ne!

Mbi humnerën e zezë, ajo nuk e lëshoi  
armën nga dora: Kënga dhe thirrja e Zan-  
finës gjëmuan në atë shkëmb për ditë me  
radhë... .

Gjëmuan për shekuj... .

... .

## PASQYRA E LËNDËS

	faqe
Autobuzi i Skënderbeut .....	3
Konviktorët .....	9
Gurorja .....	20
Kreshniku .....	39
Parku .....	55
Konkursi .....	76
Shkolla e natës .....	91
Këneta .....	108
Burri i vogël .....	130
Dhitë e Skënderbeut .....	144
Shkambbi i Vajes .....	161